



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr.8, datë 21.04.2022

PËR
“MIRATIMIN E RAPORTIT TË VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP) PËR VITIN 2021 ”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi Frashëri	Kryetar
Znj.	Ketrin Topçiu	Anëtar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Znj.	Xhoana Lilaj	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 21. 04. 2022, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr.9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, me propozim të Drejtorit të Kabinetit të Kryetarit të KD, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2021”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 9, pika 1 e nenit 114, dhe pika 1 e nenit 115, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Neni 8 i ligjit 46/2015 “Për shërbimet Postare ne RSH” (**ligji nr. 46/2015**);
3. Vendim i Kuvendit të RSH nr.134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik” (**Vendimi i Kuvendit nr.134/2018**);
4. Rregullore e Brendshme “Për Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar (**Rregullore nr.7/2017**);

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Projekt-raporti i Veprimtarisë së AKEP për vitin 2021;
2. Relacioni shpjegues mbi projekt-vendimin (Relacioni);
3. Projektvendimi i Këshillit Drejtues për miratimin e “Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2021”.

V Ë R E N:

1. Projekt-raporti i paraqitur pasqyron në mënyrë të plotë dhe korrekte veprimtarinë e AKEP për vitin 2021 dhe është hartuar bazuar në raportimet e bëra nga secila prej drejtorive të AKEP mbi veprimtarinë e kryer përgjatë vitit.
Gjithashtu dokumenti përmban edhe çështjet e detyrueshme për raportim të përcaktuara nga Kuvendi i RSH bazuar në Vendimin e Kuvendit të RSH nr.134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”.
2. Përmbajtja e Projekt-raportit përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në:
 - i. Nenin 9, të ligjit nr.9918/2008;
 - ii. Nenin 8, të ligjit nr.46/2015;
 - iii. Vendimin e Kuvendit të RSH nr.134/2018;
 - iv. Rregulloren e Brendshme të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues pasi e gjen projekt-raportin në përputhje me kërkesat ligjore, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, të pikës 1 të nenit 115, të ligjit nr.9918/2008 si dhe Rregullores së Brendshme,

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2021”, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të dërgojë “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2021”, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, dhe një kopje e tij, t’i dërgohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
3. Ky vendim publikohet në faqen e internetit të AKEP, së bashku me “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2021” ;
4. Ngarkohet Kabineti i Kryetarit të KD për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Tomi Frashëri	Edlira Dvorani	Ketrin Topçiu	Xhoana Lilaj	Lorenc Bako

AKEP

RAPORTI VJETOR 2021






AKEP

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Raport i Veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin **2021**

TIRANË 2022



PREAMBUL/PREMISA

Fjala e Kryetarit të AKEP

Raporti vjetor i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare vjen edhe këtë vit përpara Kuvendit



Tomi Frashëri - Kryetar i AKEP

të Shqipërisë, me qëllimin e dyfishtë për t'i parashtruar përfaqësuesve të zgjedhur të kombit llogaridhënie për veprimtarinë dhe detyrimet e tij si autoritet i pavarur dhe për t'i paraqitur qytetarëve, aktorëve sektorialë, qarqeve rregullatore ndërkombëtare dhe mbarë opinionit publik, faktet dhe analizat në lidhje me zhvillimet në tregjet e komunikimeve elektronike dhe në shërbimet postare në vendin tonë.

Ndonëse Raporti vjetor 2021 nuk përmban, për nga formati i jashtëm, veçori të spikatura krahasimisht me pararendësit, brendia e tij dëshmon për dinamika strukturore që po impaktojnë fuqishëm sektorin veteran të telekomunikacioneve duke përshpejtuar me ritme shtangëse shkrirjen e tij në një sistem gjithmonë e më të integruar të ndërfaqeve digjitale, aplikacioneve dhe OTT-ve (*Over*

the Top Services). Prej këtij sistemi shkëmbimet tregtare dhe inovacionet teknologjike po konvergojnë gjithmonë e më shumë në forma kapilare të shpërqëndruara dhe të derregulluara, drejt një megatregu të ekosistemeve digjitale¹ që pulson në ritmin e gigabite-ve të rrjeteve broadband dhe të potencialeve të pafund që ofron Open Ran në epokën e 5G-së². Vetëm më 24 mars të këtij viti dhe pas raundesh të gjata negociatash, Bashkimi Evropian (BE) mundi t'u imponojë gjigandëve të Big-Tech-ut³ detyrimin për ndërveprueshmëri të të gjithë platformave të mesazherive dhe fundin e monopoleve të prodhuesve të aparateve celularë në tregjet virtuale të aplikacioneve në kuadër të *Digital Markets Act (DMA)*.⁴ Ky realitet i ri, si në mbulim rrjetesh ashtu edhe në gamë shërbimesh, përveçse po shpërbën dallimet e telekomunikacioneve sipas përkufizimeve të medimeve klasike (fiks, mobile), pritet të shndërrojë në mënyrë rrënjësore edhe fizionominë e shërbimeve postare, sjelljet e përdoruesve dhe shfrytëzimin e të dhënave vetjake që gjeneron çdo ndërveprim i tyri me rrjetin e pakufizuar të aplikimeve dhe shërbimeve fitimprurëse online.

Revolucion i lavdishëm digjital apo trysni e parezistueshme e një cikli tregtar gjithëpërfshirës dhe të ardhur në pjekuri në nivel global? Në çdo rast, shfaqja e tregut të madh të ekosistemeve digjitale është një realitet, impakti i të cilit po ndihet gjithmonë e më shumë në të gjithë vendet e rruzullit ndonëse dinamikat e tij janë të një intensiteti variabël sipas konteksteve lokale. Një rast i mirë për t'u observuar është edhe Shqipëria. Maksimalisht e promovuar nga Qeveria, e mbështetur nga industria dhe e moderuar në aspektin rregullator kryesisht nga AKEP, "shoqëria digjitale" ka njohur një hov të panjohur

1 Shih edhe A. SPIKES, Interview: ACM's Sipkes takes over as Berec chair in 2022, <https://www.telecompaper.com/background/interview-acms-sipkes-takes-over-as-berec-chair-in-2022--1409786>

2 Open RAN to Strengthen its Position in 2022, COMARCH, 2022 Telco Trends Alert: Predictions for the telecom industry in 2022 and beyond, 10.

3 Të njohur edhe si GAFAM: Google (Alphabet), Apple, Facebook (Meta), Amazon dhe Microsoft.

4 A. DUCARRE, Digital Markets Act : Les Smartphones libérés des GAFAM ?, 01NET, nr. 971, 6-19 avril 2022, f. 10.

më parë për sa i përket zhvillimit të rrjeteve dhe shumëfishimit të aksesit publik në internet, aq sa të dhënat statistikore çudisin. Qëndrueshmëria mjaft e madhe e rrjeteve fiks dhe mobile gjatë sprovës dyvjeçare të pandemisë nxiti sipërmarrësit e ekosistemeve digjitale në vend të investonin edhe më shumë në modernizimin e tyre⁵.

Nga 75% që ishte mbulimi i territorit me rrjete LTE 4G në vitin 2019, ai shkoi drejt kompletimit tërësor me 95.90% vitin e kaluar. Me rëndësi është të vërehen përpjesëtimet gjithmonë e më të mëdha që po merr investimi në fibrën optike për sa i përket cilësisë së rrjeteve për ofrimin e aksesit broadband në rrjetet fikse. Teknologjia kryesore për ofrimin e aksesit broadband në rrjete fikse për vitin 2021 rezultoi të jetë fibra (FTTH/FTTB) me më shumë se 56% të totalit të lidhjeve duke u rritur ndjeshëm krahasuar me vitin 2020, gjatë të cilit fibra ishte prezente vetëm në 46% të lidhjeve. Vlen të theksohet se gjithnjë e më shumë sipërmarrësit që ofrojnë shërbimet broadband nga rrjetet fikse po i zhvendosin linjat e tyre nga lidhjet me DSL – dhe kombinimet me të – drejt ofrimit të këtij shërbimi nëpërmjet fibrave optike FTTH/FTTB, të cilat mundësojnë transmetim me shpejtësi dhe cilësi shumë herë më të lartë se më parë.⁶

Qëndrueshmëria e rrjeteve e testuar nga nevoja e shumëfishuar për internet cilësor dhe të shpejtë gjatë pandemisë krijoi gjithashtu një besueshmëri në rritje ndaj mediumeve digjitale tek përdoruesi fundor, përditshmëria e të cilit nuk mund të konceptohet dot sot e shkëputur nga telendërveprimet. Fraktura digjitale (Digital Divide) ka ardhur për pasojë duke u tkurrur gjithmonë e më shumë edhe në Shqipëri. Kështu, vetëm gjatë vitit 2021, volumi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet mobile arriti në rreth 155 milionë GB, çka përbën një rritje rreth 74.9% krahasuar me vitin 2020. Si rrjedhojë, konsumi mesatar mujor i internetit për pajtimtarë është rritur me rreth 64% duke arritur në rreth 6.39 GB në muaj.

Në të njëjtën linjë me rritjen eksponenciale të volumit të përdorimit të internetit nëpërmjet rrjetit celular edhe trafiku i internetit broadband nga rrjete fikse u rrit në rreth 952 milionë GB ose rreth 56% më shumë se viti 2020. Pajtimtarët e pajisur me akses broadband fiks ishin 10% më shumë në tremujorin e katërt të vitit 2021 krahasuar me vitin pararendës. Më 2021 norma e penetrimit të aksesit broadband në rrjete fikse u përllogarit në mbi 77% për familje dhe rreth 20% në nivel popullsie duke shënuar një rritje të ndjeshme përkatësisht me 7% dhe 2% brenda një periudhe dymbëdhjetëmuajore. Pjesa e pajtimtarëve që përdorin internet nga rrjeti fiks me shpejtësi më shumë se 10 Mbps ka arritur në 83%, krahasuar me rreth 67% që ishte në vitin 2020. Me rëndësi të posaçme është edhe rritja e konsiderueshme e evidentuar në lidhjet me shpejtësi më të madhe se 100 Mbps, ku nga rreth 15,406 në vitin 2020, pajtimtarë në vitin 2021 ishin 55,065, ndërkohë që numri i pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi 1Gbps ose më të madhe, është pesëfishuar krahasuar me vitin 2020. Rritja e ndjeshme e numrit të pajtimtarëve që kanë akses në lidhje fikse me shpejtësi më shumë se 100 Mbps është një tregues mjaft pozitiv në funksion të arritjes së objektivave të parashikuara në Planin Kombëtar Broadband për infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në të gjithë vendin, duke konsoliduar kështu themelet e një shoqërie të qëndrueshme Gigabit.

Të gjithë këto zhvillime që detajohen më tej në Raport kanë qenë objekt i parashikimeve të AKEP dhe shtysë për një prospektivë afatgjatë që duhet të rrokë një dhjetëvjeçar reformimi dhe projektimi drejt së ardhmes. Teksa Shqipëria po përparon, falë një politike të qartë zhvillimore dhe një kompleksi industrial

5 Shih për rrjetet e qëndrueshme gjatë pandemisë COVID-19, AKEP, Raporti vjetor 2020, Tiranë, 2021, ff. 5-8; 27-33.

6 Shih edhe E. BEGU, B. NEZHA, Rrjetet Broadband dhe planifikimi i tyre, Bota shqiptare, Tiranë, 2017, ff. 155-156; 213.

privat telekomunikacioni mjaft robust, drejt kushteve gjithmonë e më optimale për implementimin e një ekosistemi digjital të qëndrueshëm, AKEP ka ndërmarrë një sërë procesesh për ripërtëritjen e instrumentave funksionalë dhe rregullatorë.

Prej disa vitesh tashmë, në urtësinë e tij dhe në përputhje me rekomandimet e Komisionit European (KE), Kuvendi i Shqipërisë ka shprehur një interes legjitim përmes rezolutave të njëpasnjëshme, për rishikimin e ligjit material të komunikimeve elektronike me fokus të veçantë përforcimin e pavarësisë funksionale të autoritetit rregullator. Shtegun për këtë rishikim e ka çelur puna e nisur për transpozimin e Kodit të Komunikimeve Elektronike të Bashkimit European, një direktivë që do të shenjojë ndjeshëm kuadrin ligjor aktual dhe do të krijojë kushtet për një reflektim të thelluar mbi nevojën dhe përmasat e reformës strukturore të autoritetit rregullator. Falë koordinimit proaktiv të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, konsulentit ndërkombëtar të përzgjedhur për të asistuar në këtë proces si dhe kontributit të AKEP, transpozimi i direktivës së sipërpërmendur po përfiton nga ekspertiza më e mirë në vend për t'u kryer në një mënyrë sa më të suksesshme.

Sinkron me procesin e reformës legjislative, AKEP ka ndërmarrë nga pikëpamja e funksionimit të brendshëm nisma strategjike për t'iu përshtatur kushteve të ekosistemeve digjitale në mënyrë të qëndrueshme. Përveç përfutimit të një modeli bashkëkohor të kostove për analizat e ardhshme të tregut, gjatë vitit 2021 u implementua një paketë e tërë sistemesh për telendërveprimet e brendshme dhe digjitalizimin e proceseve. Në këtë aspekt, vitin e kaluar vijoi të zhvillohet infrastruktura e teknologjisë së informacionit dhe u sollën përmirësime në aplikacionet ekzistuese. AKEP ka aplikuar metodat më bashkëkohore në ndërtimin e sistemeve të informacionit, mbështetur edhe në detyrat e caktuara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë dhe aktet nënligjore në fuqi. Risitë kryesore të vitit të kaluar përfshijnë kryesisht investime të rëndësishme të cilat detajohen në faqet në vijim, si për shembull ndërtimi i sistemit të monitorimit të cilësisë së shërbimit «Nett test for QOS»; automatizimi tërësor i proceseve të AKEP; implementimi i infrastrukturës IT Redundant të sistemeve dhe përditësim (upgrade) i rrjetit, etj. Kryerja me profesionalizëm i të gjithë investimeve të programuara për vitin 2021, mirëmenaxhimi i fondeve dhe zbatimi me rigorozitet i buxhetit ndikoi në uljen, për të dytin vit radhazi, të tepricës së derdhur në buxhetin e Shtetit. Nga rreth 61 milionë lekë në vitin 2019, teprica në vitin 2021 ra në nivelet e saj më të ulëta prej disa vitesh, në rreth 34 milionë lekë.

Krahas këtyre zhvillimeve, gjithmonë me synimin për të pararendur procese jetike të ekosistemeve digjitale në jetësim e sipër në vend, mes të cilave spikat marrja nën administrim dhe vënia në efikasitet e brezit 700Mhz për shfrytëzimin e teknologjive 5G, AKEP kreu me sukses gjatë vitit 2021, vlerësimin e parë në nivel kombëtar të kapaciteteve kombëtare për zhvillimin e rrjeteve të brezit të ri. Vlerësimi u krye në partneritet të ngushtë me shoqërinë amerikane JohnsInternational, e cila në janar të vitit 2022 u bë partneri kryesor i Qeverisë shqiptare për implementimin e një pakete të sigurisë kibernetike në rrjetet dhe sistemet publike të informacionit. Këshillimi publik përfshiu sipërmarrësit kryesorë të komunikimeve elektronike të pajisur me autorizime individuale për shfrytëzimin e brezave relevantë të frekuencave, potencialisht të interesuar për shfrytëzimin e brezave 700Mhz dhe 3.5 Ghz dhe implementimin e teknologjive 5G.

Do të ishte e tepërt që në këtë hyrje të shpaloseshin konstatimet e prura nga ky vlerësim si dhe risitë që propozohen, pasi këto elementë gjenden të shtjelluar në pjesën e dedikuar të raportit. Vlen të theksohet megjithatë se ky vlerësim i domosdoshëm vjen në një moment kur

edukimi digjital (digital literacy) është kthyer në emergjencë në të gjithë rruzullin, pasi numri i operatorëve që ofrojnë 5G në botë është rritur me 40% vitin e kaluar dhe kur në katërmujorin e parë të vitit aktual mbi 200 operatorë pritet që të lançojnë shërbime 5G në nivel global.⁷ Çfarë nënkuptohet me rrjete dhe teknologji 5G dhe si ndërlidhen ato me fuqizimin e individit në suazën e shoqërisë digjitale? Vlerësimi kombëtar i kryer vitin e kaluar sjell përgjigje duke mos neglizhuar adresimin e një sfide shprehur qysh prej viteve 1970 përmes idesë-forcë të Efrem Lipkin:

“Publiku duhet të pajiset me mjetet për të fituar avantazhe që do të kundërvepronin ndaj tendencave për fragmentim dhe izolim aq të pranishme në shoqërinë e sotme. Individët duhet të fitojnë kuptueshmëri dhe kontroll mbi sistemin si një mjet. Inteligjenca kompjuterike duhet të orientohet drejt formimit të përdoruesit duke demistifikuar dhe shfaqur natyrën e saj të vërtetë për t’i dhënë njeriut kontrollin dhe udhëheqjen aktive.”⁸

Në aspektin e bashkëveprimeve dhe realizimeve multilaterale, viti 2021 ka qenë për AKEP një vit i mbarë dhe ogurmirë. Më 1 korrik 2021 u përmbyll me sukses procesi i zerimit të tarifave roaming në të 6 vendet e Ballkanit Perëndimor (BP), proces që AKEP vijoi dhe vijon ta monitorojë në mënyrë sistematike, në bashkëpunim me rregullatorët e rajonit dhe me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (Regional Cooperation Council – RCC). Përvoja frytdhënëse e këtij bashkëpunimi ka hapur tashmë rrugën e një ambicijeje më të madhe, realizimi i së cilës do të integronte në mënyrë radikale, përmes ndërlidhjes elektronike, popullsitë e Ballkanit Perëndimor (BP) me ato të Bashkimit European (BE). Është fjala këtu për zhdukjen afatgjatë të tarifave roaming mes BP dhe BE, një proces që sapo ka nisur një rrugëtim të gjatë nën patronazhin e RCC, KE, BEREC, Qeverive, industrisë dhe sigurisht, rregullatorëve kombëtarë. Në vetvete ky proces përforcon mes të tjerash edhe dialogun mes rregullatorëve dhe industrisë dhe nxit bashkërendimin rajonal mes vetë rregullatorëve. Në këtë aspekt, AKEP është angazhuar në përditësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet rregullatore të Maqedonisë së Veriut dhe të Republikës së Kosovës.

Së fundmi, është e udhës të përmendet veprimtaria e AKEP në dimensionet e tij monitoruese dhe inspektuese, gama e gjerë e të cilëve është shtjelluar në kapitullin përkatës të raportit. Lufta ndaj informalitetit në sektorin postar dhe mbrojtja e vazhdueshme e përdoruesit në sektorin e komunikimeve elektronike e kanë detyruar AKEP të jetë i patrajtueshëm në zbatimin e ligjit, përfshirë këtu përmes marrjes së masave administrative të qenësishme dhe proporcionale kundrejt një sërë sipërmarrësve.

Në përfundim të kësaj pasqyre të përmbledhur, por asfare shteruese, vlen të theksohet se AKEP është i nderuar që Raportin për vitin 2021 e paraqet pasi ka realizuar pothuajse tërësinë e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për vitin e kaluar, e cila është për institucionin përparësia e përparësive.

Për të gjithë punën dhe përpjekjet, si dhe për hartimin e Raportit Vjetor 2021, qofshin të falënderuar të gjithë punonjësit e AKEP, bashkërisht dhe secili prej tyre në veçanti.

7 K. MASSELOS, 5G Fixed Wireless Access, Green Issues and Real Economy related KPIs, European 5G Conference, Panel session: Delivering digital equality – Meeting the target of 5G connectivity for all by 2030, 26 janar 2022, fl. 1.

8 Shih F. TURNER, From Counterculture to Cyberculture. Stewart Brand, the Whole Earth Network, and the Rise of Digital Utopianism, The University of Chicago Press, Chicago & London, 2006, f. 115.

PËRMBAJTJA

FJALA E KRYETARIT TË AKEP.....	5
PANORAMË E PËRGJITHSHME.....	13
1. Parimet themelore ligjore dhe rregullatore të sektorit të komunikimeve elektronike dhe postare.....	13
2. Ecuria e implementimit të Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike	14
3. Statusi i Shërbimit Universal	16
4. Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë.....	21
SHTYLLA TË VEPRIMIT STRATEGJIK PËR VITIN 2022	26

I.

2021, një vit premtues për më shumë ndërlidhje dhe integrim: nga roaming rajonal drejt reduktimit progresiv të tarifave roaming me vendet e Bashkimit Evropian

1. Shpërbërja e barrierave tarifore për shërbimet roaming në Ballkanin Perëndimor	29
2. Monitorimi i zbatimit të angazhimeve për shërbimet roaming, të njësuara dhe të balancuara prej 1 korrikut 2021	32
3. Roadmap-i rajonal dhe bashkëpunimi në perspektivën e heqjes së tarifave roaming mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe atyre të Bashkimit Evropian	37

II.

Tregjet e komunikimeve elektronike dhe postare nën peshën e globalizimit digjital: një vlerësim në nivel kombëtar për vitin 2021

1. Zhvillimet në tregjet relevante dhe mbikëqyrja rregullatore.....	44
1.1 Pasojat e përpjesëtimin gjithmonë e më të zhdrejtë mes telefonisë dhe shërbimeve broadband	44
1.2 Përfitim i modelit të avancuar kombëtar të kostos për analizat e tregjeve sipas standardeve të shek. XXI.	55
1.3 Përpunimi i informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike (ATLAS)	56
1.4 Rritja eksponenciale e sipërmarrjes në tregun postar dhe impakti i saj në shërbimin universal postar	58
1.5 Veprimtaria monitoruese dhe inspektuese në tregjet e mbikëqyrura dhe në përdorimin e frekuencave	62
2. Perspektiva strategjike e rrjeteve dhe teknologjive të brezit të ri: vlerësimi kombëtar për ardhmërinë e 5G në Shqipëri	78
2.1 Procesi i konsultimit ndërkombëtar dhe këshillimi me sipërmarrësit e sektorit	78
2.2 4 Fokuset e reflektimit strategjik për një politikë zhvillimore koherente të sektorit	80
2.3 Rekomandimet për vënienë në eficientë të plotë të brezave relevantë të frekuencave	81
2.4 Pasqyrë e përmbledhur e rezultateve të vlerësimit kombëtar për ardhmërinë e rrjeteve dhe teknologjive 5G në Shqipëri.....	81

III.

Bashkëpunimi institucional në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian

1. Bashkëpunimi institucional në nivel kombëtar;	86
1.1 Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Autoritetin e Mediave Audiovizive.....	86
1.2 Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës	87
2. Perspektivat e bashkëpunimit me autoritetet rregullatore të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Maqedonisë së Veriut;.....	89
3. Pjesëmarrja e AKEP në përpunimin e instrumenteve rregullatorë në instancat evropiane (BEREC) dhe ndërkombëtare (ITU).....	91

IV.

Performanca e brendshme dhe miradministrimi financiar përgjatë vitit 2021

1. Automatizimi dhe digjitalizimi tërësor i proceseve në AKEP	97
2. Performanca në mbledhjen e të ardhurave nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare	99
3. Përgatitja dhe zbatimi i buxhetit të institucionit	101
4. Procesi i mbledhjes së të ardhurave të prapambetura dhe procedurat gjyqësore	104

V.

V. Shtojca

1. Struktura dhe organigrama e AKEP	107
2. Raport lidhur me nivelin e zbatimit të rezolutës dhe rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2021	108
3. Statistika të zhvillimeve në tregjet e komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare	127
4. Statistika të zhvillimeve në sektorin e autorizimeve dhe të drejtave të tjera të përdorimit, licencat, certifikatat ajrore, detare, etj., si dhe përdorimi i domain.al	131
5. Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP për vitin 2021	138



PANORAMË E PËRGJITHSHME

1.

Parimet themelore ligjore
dhe rregullatore të sektorit
të komunikimeve elektronike
dhe postare

AKEP, si autoriteti i vetëm rregullator për tregjet e telekomunikacioneve dhe postare, bazuar në një kuadër ligjor dhe rregullator të plotë dhe të konsoliduar, kërkon të nxisë gjithnjë e më shumë një mjedis të favorshëm për sipërmarrësit dhe shërbime me çmim dhe cilësi më të mirë për të gjithë përdoruesit e shërbimeve të telekomunikacioneve dhe postare në Shqipëri.

Për kryerjen sa më mirë të rolit dhe funksioneve të tij rregullatore në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, ushtrimi i veprimtarisë është udhëhequr nga parimi i zbatimit rigoroz i ligjshmërisë duke ushtruar kompetencat në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, si dhe duke i zbatuar të drejtat dhe detyrimet institucionale të parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullator të fushës, për realizimin me sukses të objektivave dhe detyrave të përcaktuara në legjislacionin që rregullon fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, por dhe në orientim me parimet e Kodit të ri Evropian të Komunikimeve Elektronike.

Zbatimi i parimeve themelore sikurse konsiderohen, parimi i ligjshmërisë, objektivitetit, transparencës, drejtësisë dhe paanësisë, determinojnë veprimtarinë e AKEP, duke vënë në dukje vlerat thelbësore të tij, sikurse janë Integriteti, Paanësia, Transparenca, Profesionalizmi dhe Efikasiteti, shprehur më së miri nëpërmjet:

Rregullimit të tregut të komunikimeve elektronike, mbikëqyrjes dhe monitorimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përcaktimit të sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg, administrimit dhe monitorimit të përdorimit të brezave të frekuencave, ndërkohë që i udhëhequr nga parimi i drejtësisë dhe paanësisë

zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike, si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve.

Veprimtaria e AKEP normohet nga tërësia e akteve nënligjore që përcaktojnë politikat e zhvillimit të sektorit si dhe aktet rregullatore të miratuara nga Këshilli Drejtues i AKEP, si organi drejtues i Institucionit, rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Direktivat e Komisionit dhe Parlamentit Evropian, aktet e BEREC, ITU, ERPG etj.

Gjatë vitit 2021, kuadri ligjor i AKEP nuk ka pësuar ndryshime.

.....

2. Ecuria e implementimit të Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike

Ndryshimet në teknologjinë e informacionit dhe zhvillimi radikal i tregut të komunikimeve elektronike ofrojnë një mundësi për të marrë në konsideratë mjedisin aktual rregullator dhe për të parashtruar reforma që mund ta bëjnë rregullimin më të përshtatshëm për epokën e re të internetit. Duke mbajtur në konsideratë pikërisht dinamikën dhe ndryshimet e mëdha në këtë sektor, si dhe duke nënvizuar faktin se ky i fundit duhet të kontribuojë në plotësimin e kërkesës gjithnjë e në rritje të përdoruesve dhe nevojave të zhvillimit socio-ekonomik që vijnë nga shpeshtimi i komunikimit të të dhënave online, Bashkimi Evropian ndërmori nismën për ndryshimin e kuadrit ligjor evropian në këtë sektor, duke miratuar në muajin dhjetor të vitit 2018 “Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike”.

Kuadri i ri rregullator në nivel evropian ka për qëllim përballimin e sfidave të reja të sektorit, për shkak të rëndësisë gjithmonë e më të madhe që ka ky sektor në fushën e ekonomisë digjitale, duke qenë pikërisht promotori i kësaj ekonomie, pasi të gjitha aktivitetet tregtare që kryhen sot online mbështeten pikërisht në rrjetet e komunikimeve elektronike.

Kodi i ri i komunikimeve elektronike synon normimin e të gjithë veprimtarisë së sektorit, me qëllim shtimin e një shtylle të re në kuadër të rregullimit të tij (new connectivity objective), mundësinë e provomimit të rrjeteve të shpejtësisë së lartë, duke siguruar një shtrirje dhe akses maksimal të rrjeteve dhe infrastruktues së shpejtësisë së lartë, ku një ndër qëllimet kryesore është dhe implementimi i gjeneratës 5G (rrjet i shpejtësisë së lartë, i cili shtrihet dhe përhapet kudo), përforcimi i rolit dhe i pavarësisë së autoriteteve rregullatore kombëtare dhe trupit rregullator evropian BEREC.

Aktualisht, Shqipëria është duke u asistuar nga Komisioni Evropian, sa i përket implementimit të Kodit

të Komunikimeve Elektronike në legjislacioni vendas, çfarë dhe do të vendosë këtë të fundit në sintoni të plotë me politikat e Bashkimit Evropian.

Ky projekt po realizohet nga Bashkimi Evropian, i cili po zbaton projektin përmes menaxhimit të drejtpërdrejtë, si programi i parë në mbështetje të sektorit të Telekomunikacionit.

Konkretisht, konsulenti i përzgjedhur po asiston Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përfshirë organet rregullatore, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), si dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) në implementimin e Kodit të ri Evropian të Komunikimeve Elektronike (EECC) dhe në migrimin e brezit të frekuencave 700 MHz, në përputhje me acquis të BE-së.

Raporti fillestar i hartuar nga konsulenti paraqet gjetjet e fazës fillestare dhe ofron informacion të detajuar mbi zbatimin e këtij projekti, duke përfshirë një përshkrim se si do të arrihen objektivat e tij dhe detyrat e tij të ekzekutuara dhe çështjet kryesore me të cilat ai mund të përballët. Është përshkruar gjithashtu qasja e propozuar e zbatimit gjithëpërfshirës dhe e koordinuar e Projektit.

Ligji nr.9918/2008 "Për Komunikimet Elektronike në RSH", përfshin të gjitha kushtet e BE-së për të krijuar një kuadër rregullator efektiv për zhvillimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të telekomunikacionit. Gjithsesi, dhe sikurse parashtruam më lart, Ligji duhej të rishikohet me iniciativën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në mënyrë që të përafrohet me Kodin e ri Evropian të Komunikimeve Elektronike të vitit 2018 (EECC), një mision që aktualisht është në pritje të përfundimit.

Pra, në thelb, mbetet mjaft e rëndësishme përmbushja e objektivit të këtij projekti, sikurse është përafrimi i legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së në fushat e Komunikimeve Elektronike dhe lirimi i brezit 700 MHz, si pjesë e agjendës së anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

3. | Statusi i Shërbimit Universal

Statusi i Shërbimit Universal për komunikimet elektronike

Bazuar në ligjin nr. 9918/2008, shërbimet e përfshira në shërbimin universal për komunikimet elektronike duhet të jenë të disponueshme për përdoruesit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht vendndodhjes gjeografike, të tyre dhe këto shërbime duhet të kenë cilësinë dhe kushtet e përcaktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP, çmim të përballueshëm, në përputhje me kushtet specifike kombëtare.

Një element tepër i rëndësishëm i shërbimit universal është dhe sigurimi i kushteve për akses të barasvlershëm dhe përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike nga përdoruesit fundorë me aftësi të kufizuara.

Elementi kryesor i shërbimit universal është sigurimi i aksesit në rrjet të komunikimit elektronik publik nga vendndodhje fikse si dhe mundësimi i përdoruesve pavarësisht vendndodhjes gjeografike të tyre për kryerjen dhe marrjen e thirrjeve telefonike, përdorim të të dhënave me shpejtësi të kënaqshme për të lejuar akses funksional në internet, duke marrë parasysh teknologjitë mbizotëruese të përdorura nga shumica e pajtimtarëve dhe mundësitë e realizimit teknologjik.

Ligji 9918/2008 për aksesin në internet si pjesë e shërbimit universal përmban konceptin e aksesit funksional në internet me shpejtësi të kënaqshme.⁹ Ndërsa Kodi i ri i komunikimeve elektronike ka synuar normimin e të gjithë veprimtarisë së sektorit me qëllim mundësinë e promovimit të rrjeteve të shpejtësisë së lartë, duke siguruar një shtrirje dhe akses maksimal të rrjeteve dhe infrastrukturës së shpejtësisë së lartë, ku një ndër qëllimet kryesore është implementimi i gjeneratës 5G.

Kodi i komunikimeve elektronike gjithashtu thekson se koncepti i shërbimit universal duhet të evoluojë për të reflektuar përparimet në teknologji, zhvillimet e tregut dhe ndryshimet në kërkesën e përdoruesve. Bazuar në këta faktorë, BE ka miratuar një sërë ndryshimesh të rëndësishme në lidhje me shërbimin universal në krahasim me kuadrin e mëparshëm rregullator. Ndër këto ndryshime është dhe përfshirja në objektin e shërbimit universal të aksesit broadband në internet me shpejtësi adekuate.

Në lidhje me shpejtësinë adekuate të aksesit broadband në Internet, EECC përcakton se ajo mund të caktohet nga çdo vend anëtar sipas kushteve kombëtare dhe shpejtësisë minimale që përdoret nga shumica e konsumatorëve, duke marrë në konsideratë dhe raportet e BEREC për praktikat më të mira, me synimin që të sigurohet niveli i shpejtësisë së nevojshme për pjesëmarrje sociale dhe ekonomike në shoqëri.

9 Këto përcaktime janë në përputhje me Direktivën 2002/22/EC, e ndryshuar me Direktivën 2009/136/EC.

Adresimi i çështjes nëse aksesit broadband në internet duhet të përfshihet në Shërbimin Universal, sipas përcaktimeve të EECC, është pjesë e objektivave të përfshira në “Plani Kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës digjitale Broadband 2020-2025”, të miratuar me VKM nr.434, datë 3.06.2021.

AKEP gjatë vitit 2021 ka bashkëpunuar me MIE për realizimin e një projekti të asistencës teknike për shërbimin universal dhe skemën të financimit/ndihmës shtetërore në lidhje me aksesin Broadband në Shqipëri.

Nga analiza e kryer vihet re se numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse në fund të vitit 2021 arriti në rreth 560 mijë, që përbën një rritje të ndjeshme me vitin 2020 dhe vitet e mëparshme. Numri i përdoruesve me akses broadband celular në 2021 ishte rreth 2.8 milionë, apo rreth 13% më i lartë se në vitin 2020.

Mbulimi me rrjet celular GSM që mundëson akses në rrjet publik telefonik dhe përdorim interneti funksional, në fund të vitit 2021 rezultoi në 99.86% të popullsisë dhe në 96.7% të territorit. Ndërsa mbulimi me rrjet 3G/4G që mundëson akses broadband në internet arriti 99.2% të popullsisë dhe në 95.9% të territorit.

Rritja e madhe përdorimit të internetit në rrjete fikse dhe celulare konfirmohet edhe nga të dhënat e publikuara nga Instat. Bazuar në Anketën e Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) të publikuar nga Instat për vitin 2021¹⁰ rezultoi se:

- 79,3 % e popullsisë (grup-mosha 16-74 vjeç) përdorin internet, nga të cilët 91,7 % e tyre e përdorin çdo ditë;
- 88,3 % e familjeve shqiptare kanë akses në internet, krahasuar me 83,3 % të një viti më parë.
- 78,3 % e familjeve shqiptare kanë akses në internet me rrjet fiks broadband (rrjet optik, kabllor, ADSL, etj.), tregues i cili ka shënuar rritje prej rreth 9,6 % nga një vit më parë.
- 99,1 %, e familjeve shqiptare kanë akses në internet nëpërmjet lidhjes “Mobile broadband” (3G/4G, tablet, etj.), krahasuar me 90,7 % që kanë patur një vit më parë.

Këto të dhëna të përpunuara nga Instat si dhe nga të dhënat e raportuara nga operatorët e komunikimeve elektronike në AKEP, tregojnë se si nga mbulimi i territorit dhe popullsisë me rrjete celulare dhe fikse, mundësohet akses broadband në internet për pothuajse të gjitha familjet dhe popullsinë e Shqipërisë, pavarësisht vendndodhjes gjeografike të përdoruesit.

Megjithëse mbulimi me rrjete fikse është i përqendruar kryesisht në zona urbane, rrjetet celulare mundësojnë akses broadband në internet pothuajse në të gjithë territorin dhe për të gjithë banorët e Shqipërisë.

10 <http://www.instat.gov.al/temat/kushtet-sociale/teknologjise%20AB-s%20AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%20AB-familje-dhe-nga-individ%20AB/>

Sipas të dhënave më të fundit të ITU¹¹ mbi përballueshmërinë e çmimeve të ICT 2021, Shqipëria renditet në pozicione të mira për sa i përket përballueshmërisë së tarifave të shërbimit të aksesit broadband fiks dhe shërbimeve celulare, sidomos për aksesin broadband nga rrjete fikse.

Për vitin 2021 shpenzimet e matura në përqindje ndaj të ardhurave kombëtare për frymë (GNI p.c) rezultojnë:

- për shportën broadband fiks (5GB internet) ishin 1.51% e GNI/për frymë ;
- për shportën celulare me konsum të ulët minuta, sms dhe internet (70 min + 20 SMS + 500 MB) ishin 1.72% ;
- për shportën me përmbajtje të lartë të konsumit të minutave dhe internetit (140 min + 70 SMS + 2 GB) ky tregues për vitin 2021 rezulton përkatësisht 2.16 dhe 3.45% e GNI/për frymë.

Komisioni Broadband për Zhvillim të Qëndrueshëm i ITU/UNESCO (*Broadband Commission for Sustainable Development*), ka përcaktuar si objektiv të përballueshmërisë së aksesit broadband që, deri në vitin 2025, çmimet për akses në shërbimet bazë broadband (për të arritur konektivitet universal) në vendet në zhvillim (me të ardhura të ulëta dhe të mesme) duhet të jenë më pak se 2% të GNI mujore për frymë.

Për Shqipërinë, shporta e aksesit broadband fiks dhe shporta celulare me konsum të ulët minuta, sms dhe internet, kanë vlera më të ulëta se objektivi 2% i përballueshmërisë së aksesit broadband. Ndërsa për shportën broadband celulare (data 2GB internet) ky tregues për vitin 2021 ishte 2.16%, apo 0.16 pikë përqindje më i lartë se objektivi i përballueshmërisë.

Shërbimet nga rrjetet fikse dhe celulare vijojnë të ofrohen nga operatorët me tarifa të arsyeshme për shërbime të telefonisë dhe të aksesit broadband në internet.

Të tre operatorët celularë ofrojnë një sërë paketash për pajtimtarët që përfshijnë dhe zgjedhje për mënyrat e pagesës si parapagim (PAYG apo oferta/paketa ditore, javore dhe 30 ditore), paspagim apo hibrid (kombinim parapagim dhe paspagim). Edhe përgjatë vitit 2021, operatorët celularë kanë vijuar të ofrojnë paketa të përballueshme, të tilla si paketa me parapagim me vlefshmëri 30 ditore me çmim 500-600 lekë (me TVSH), dhe që përfshijnë minuta/sms/internet.

11 <https://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Pages/ICTprices/default.aspx>

Statusi i shërbimit universal postar

Një fokus i veçantë në ligjin nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë" i kushtohet sigurimit të shërbimit universal postar në gjithë territorin e RSH sipas kërkesave specifike të përcaktuara në ligj, aktet nënligjore si dhe rregullat për ofrimin e shërbimit postar dhe shërbimit universal postar. AKEP si organ rregullator në fushën e shërbimeve postare, ndër të tjera, ka detyrimin për të përcaktuar ofruesin e shërbimit universal postar, si dhe të mbikëqyrë përmbushjen e detyrimeve të këtij shërbimi.

Nga analizat e kryera përgjatë vitit 2020, ofruesi i shërbimit postar Posta Shqiptare sh.a., rezultoi operatori i vetëm që plotëson të gjitha kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Me qëllim garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të këtij shërbimi, AKEP ka lëshuar autorizimin e ri individual, të vlefshëm deri në muajin korrik 2025.

Ofruesi i shërbimit postar Posta Shqiptare sh.a, me qëllim sigurimin e shërbimit universal postar ka të organizuar rrjetin postar në zyra të hapura për publikun në të cilat ofrohet shërbim universal postar dhe shërbime jo universale/ekspres, si dhe në zyra që kryejnë funksionin dhe si qendra përpunimi.

Gjatë vitit 2021 Posta Shqiptare ka vënë në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit universal:

- 536 zyra postare të hapura për publikun :
- 704 sportele, nga të cilët 525 të automatizuar/kompjuterizuar ;
- 579 kuti postare për pranimin e objekteve postare, në dispozicion të përdoruesve;
- 667 kuti postare për dorëzimin e objekteve postare, në dispozicion të përdoruesve.


Bazuar në të dhënat e raportuara rezulton se Posta Shqiptare sh.a., i ka realizuar treguesit e mbulimit me shërbim universal sipas kërkesave të përcaktuara në Urdhrin e Ministrit të Energjisë dhe Infrastrukturës, me nr. 6174, datë 16.12.2019.

Për sa i përket infrastrukturës së automjeteve postare, Posta Shqiptare ka në përdorim 474 mjete transporti. Në mjetet e transportit përfshihen kamiona, furgona, vetura, motoçikleta dhe biçikleta.

Numri total i objekteve postare të shërbimit universal u rrit me 13.5% gjatë vitit 2021, duke arritur në rreth 20.8 milionë objekte.

Objektet e SHU postar në vitin 2021 përbëjnë 95% të totalit të objekteve postare të ofruesit të shërbimit postar Posta Shqiptare sh.a., dhe 77% të totalit të gjithë objekteve postare në Shqipëri.

Numri i objekteve postare brenda vendit shënoi rritje me 15.6%, ku rritja me e madhe ishte në numrin e objekteve të regjistruara.¹²



Burimi: Të dhëna nga "Posta Shqiptare" sh.a.

Sipas të dhënave rezultojnë se Posta Shqiptare i ka realizuar plotësisht treguesit për kohën e shpërndarjes së objekteve postare brenda vendit në të tre destinacionet dhe për të gjitha kohëzgjatjet.

Në vitin 2021 treguesit kanë pasur përmirësime, dhe proporcioni i objekteve të shpërndara në D+1 (1 ditë pas pranimit) ka shënuar rritje me 2 pikë përqindje në krahasim me vitin 2020.

Posta Shqiptare realizon në ditën 1 - D+1 dorëzimin e 97% të objekteve postare brenda qytetit dhe 96% të objekteve midis qyteteve.

Në vitin 2021 ka vijuar përmirësimi i shpërndarjes së objekteve postare në fshatra duke arritur në shpërndarje në ditën 2 - D+2 të 84%, krahasuar me 80% në vitin 2020.

¹² Për më shumë detaje referoju tabelës tek statistikë

4. Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Rezolutën e datës 1.7.2021 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2020", AKEP është udhëhequr nga angazhimi maksimal për përmbushjen e tyre, duke punuar me përkushtim dhe profesionalizëm.

Prej 16 rekomandimeve të dhëna për vitin 2021 në Rezolutën e Kuvendit:

- a) 14 rekomandime janë realizuar plotësisht.
- b) 2 rekomandime janë në proces realizimi.



Figura 1: Kryetari i AKEP, Z. Tomi Frashëri, në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë në korrik 2021, gjatë së cilës u miratua Rezoluta e Kuvendit për vitin 2022 (fotografi kortezi e zyrës së shtypit të Kuvendit)

Burimi: Kuvendi i Shqipërisë 2021

Përmbushja e rekomandimeve është konkretizuar në këto masa dhe veprime:

1. Posta Shqiptare sh.a., pas datës 1 janar 2021 nuk e aplikon vjeljen e tarifës së dorëzimit për objektet postare, pakot e vogla apo kolipostat që vijnë nga jashtë vendit, kjo në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit dhe pas inspektimit të kryer si dhe rekomandimeve të lëna nga AKEP. Lidhur me rekomandimin për ndarjen e llogarive, ka filluar aplikimi në disa zyra postare dhe pritet aplikimi në të gjithë sistemin postar.
2. Pas inspektimit të kryer nga AKEP për tre sipërmarrësit e rrjeteve celulare, ka vijuar monitorimi për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna dhe korrigjimin e shkeljeve të konstatuara në funksion të zbatimit të rregullores së portabilitetit të numrit, duke bërë të mundur që pajtimtarët të ushtrojnë të drejtën e tyre të portimit të numrit celular sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në aktet rregullatore. Strukturat e AKEP kanë iniciuar përgjatë vitit 2021, dy procese inspektimi tek të tre sipërmarrësit e rrjeteve celulare, duke dhënë masat dhe rekomandimet përkatëse.
3. AKEP ka bashkëpunuar me Autoritetin e Konkurrencës për të shmangur praktikatat tregtare çorientuese dhe agresive, si dhe ofertat nën kosto të operatorëve që çojnë në deformim të tregut. Gjatë vitit 2021, AKEP ka përcjellë informacione të plota mbi paketat dhe tarifat e shërbimeve celulare të njoftuara nga operatorët celularë. Gjithashtu, ka informuar Autoritetin e Konkurrencës edhe mbi masat e ndërmarra për zgjidhjen e problematikave teknike në procedurën e portabilitetit të numrave, me qëllim sigurimin e konkurrencës efektive mes operatorëve në treg.
4. Pas miratimit të rregullores për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Përdoruesve të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike dhe Publike, AKEP ka bashkëpunuar dhe ka organizuar takime me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMC), me shoqatat e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, dhe operatorët, lidhur me hartimin e kontratave specifike për këta kategori. Janë organizuar takime të vazhdueshme me operatorët celularë për të kryer zhvillime teknologjike në sistemet e tyre për bërjen të mundur përfitime për këtë grup të caktuar. Në vijim dhe të inputeve të marra nga diskutimet me shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara si dhe me sipërmarrësit e rrjeteve/shërbimeve celulare, AKEP do të vijojë të bashkëpunojë me MSHMS dhe të gjithë palët e tjera të interesuara, për gjetjen e zgjidhjeve sa më të mira operacionale, teknike dhe financiare për të garantuar ofrimin e shërbimeve sa më të dobishme për akses të barabartë për këtë kategori përdoruesish të komunikimeve elektronike publike, si dhe për informimin dhe ndërgjegjësimin e përdoruesve me aftësi të kufizuara për masat e marra për të garantuar përfshirjen e plotë sociale të tyre dhe akses të barabartë në rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike publike
5. AKEP së bashku me konsulentin e përzgjedhur nga procedura e prokurimit publik ka kryer studimin "Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri".

AKEP ka iniciuar zhvillimin e këtij studimi, duke përfshirë një vlerësim të gjithanshëm ku u morën parasysh aspektet e teknologjisë, sigurisë, përballueshmërisë dhe aftësive implementuese vendase. Një rëndësi të veçantë gjatë hartimit të dokumentit patën edhe takimet me operatorët celularë si edhe shqyrtimi i pikëpamjeve të tyre mbi masat që duhen marrë për të inkurajuar investimet në rrjetin 5G për të ardhmen. Operatorët e sektorit të telekomunikacioneve në Shqipëri kanë dhënë

kontribut të rëndësishëm në këtë studim dhe do të jenë aktorë kryesorë në zbatimin e 5G në Shqipëri. Ky studim përfshin ndër të tjera edhe procesin për dhënien e të drejtave të përdorimit sa më objektiv dhe sa më transparent me qëllim përfitimin e konsumatorëve dhe ekonomisë shqiptare, si edhe zhvillimin e qëndrueshëm të një tregu konkurrues.

6. Përgjatë vitit 2021, AKEP ka bashkëpunuar me operatorët celularë për rritjen e mbulimit dhe cilësisë së shërbimeve në brezat e frekuencave GSM, UMTS dhe LTE në qytetet kryesore të vendit, rrugët kryesore kombëtare, zonat urbane dhe rurale dhe veçanërisht në pikat turistike, ku konstatohen probleme mbulimi me shërbim.

Gjatë vitit 2021 është konstatuar përmirësim i shërbimit përkatësisht:

- Për teknologjinë LTE, e cila ka rritur ndjeshëm shpejtësinë e transmetimit të të dhënave në zonat me densitet të lartë të përdoruesve si në qytetet Durrës, Shijak, Elbasan, Peqin, Cërrik, Peshkopi, Klos, Burrel.
 - Përmirësim me mbulim dhe cilësi shërbimi në zonën turistike të Gërmenjit dhe zonat rurale rreth tij, si dhe në plazhet e vendit. Gjithashtu u është kërkuar operatorëve marrja e masave për përmirësimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në zonën turistike të Butrintit, si një prej zonave më të frekuentuara gjatë vitit 2021.
 - Në akset e reja rrugore, të cilat janë përfunduar ose janë në proces përfundimi, është arritur të bëhet mbulimi dhe përmirësimi i shërbimit të telefonisë së lëvizshme në koordinim me operatorët e telefonisë së lëvizshme, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar. Në aksin rrugor By-Pass i Vlorës, i cili është në përfundim të punimeve, janë marrë masat gjatë sezonit turistik të vitit 2021, për përmirësimin e mbulimit dhe ofrimin e një shërbimi në kushte teknike të pranueshme. Operatorëve u është kërkuar nga AKEP, mbulim dhe shërbim me cilësi maksimale, i këtij aksi të ri rrugor me shërbime përpara fillimit të sezonit të ri veror për vitin 2022. Gjithashtu në aksin rrugor Rruga e Arbrit, janë kryer monitorime duke evidentuar problematikat në zona të caktuara, për të cilat u është kërkuar operatorëve të planifikojnë masat që do të ndërmarrin për ofrimin e shërbimit në momentin e vendosjes në funksionim të këtij aksi rrugor.
7. Lidhur me spektrin e paalokuar të brezit 800 MHz (1x10 MHz, i çiftuar), edhe pas përfundimit të konsulencës përkatëse në fund të vitit 2020, AKEP ka pritur shprehjen e interesit nga operatorët celularë për këtë spektër. Në vijim edhe të bashkëpunimit për lirimin e 700 MHz Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare nënshkruan në datën 03.11.2021, Memorandumin e Bashkëpunimit me qëllim garantimin dhe mbështetjen operacionale, teknike dhe ligjore në fushat me interes të përbashkët për të dyja palët. Të dy institucionet do të bashkëpunojnë ndër të tjera për lirimin e brezit 700 MHz (të ashtuquajtur DD2), nga AMA dhe marrjen në administrim të këtij brezi nga AKEP, duke shkuar drejt respektimit të afateve të vendosura nga BE dhe ITU.

AKEP ka shfaqur gadishmërinë e tij, për marrjen në administrim të këtij spektri pas lirimit të tij nga AMA.

8. AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me MIE për harmonizimin e legjislacionit të fushës së komunikimeve elektronike në përputhje me Kodin e ri Evropian të Komunikimeve Elektronike, kërkesë e cila theksohet edhe në progres raportin e KE-së.

AKEP është pjesë e grupit të punës të ngritur nga MIE, të cilët po punojnë ngushtësisht me konsulentin e përzgjedhur nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në kuadër të asistencës teknike IPA, për traspozimin në legjislacionin kombëtar të direktivës 2018/1972/EU Kodi i Komunikimeve Elektronike, përgjatë vitit 2022.

9. AKEP ka bashkëpunuar me MIE dhe konsulentin e përzgjedhur, lidhur me projektin për “Zhvillimin e Atlasit të Broadband të Shqipërisë dhe përdorimin e tij në sektorin publik dhe privat”, projekt të cilin Shqipëria e ka përfituar në kuadër të thirrjes së 23-të, të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF). Ky projekt ka për qëllim zhvillimin e sistemit Atlas, përditësimin e këtij sistemi me informacionin deri në përdoruesin fundor, informacionin mbi përdorimin e internetit me brez të gjerë në Shqipëri, ofruesit e rrjetit në një zonë të caktuar, informacionin mbi zonat e bardha si edhe mbulimin e shërbimeve celulare, bazuar në praktikat dhe modelet më të mira ndërkombëtare.
10. Në përmbushje të plotësimit të detyrimeve të ngarkuar nga Rezoluta e Kuvendit të RSH, AKEP dhe AMA, kanë koordinuar jetësimin e një inventari të unifikuar të frekuencave, bazuar në dispozitat e Politikës Spektrale i cili shërben për:

Identifikimin e brezave të frekuencave ku ka hapësirë për përmirësimin e efikasitetit të përdorimit aktual të spektrit radio, duke konsideruar edhe mundësinë e caktimit/ricaktimit të frekuencave.

Identifikimin e brezave të lirë të frekuencave që do të garantojnë një përdorim më efikas, për të promovuar inovacionin dhe për të rritur konkurrencën e tregut brenda vendit.

Identifikimin e brezave të frekuencave ku ka mundësi për përdorim të përbashkët të spektrit radio dhe duke mbajtur parasysh në të njëjtën kohë dhe kërkesën për shërbime të reja.

Analizimin e llojeve të ndryshme të përdorimit të spektrit radio nga ana e përdoruesve si nga sektori publik dhe privat.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) kanë realizuar disa takime dypalëshe, përgjatë të cilave është vlerësuar bashkëpunimi ndër vite dhe është vënë theksi në intensifikimin e marrëdhënieve të dy institucioneve dhe rritjen e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët.

Në vijim të takimeve, autoritetet në datën 03.11.2021 nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit me qëllim garantimin dhe mbështetjen operacionale, teknike dhe ligjore në fushat me interes të përbashkët për të dyja palët.

Përmes këtij memorandumi, institucionet angazhohen të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e tij, në një mënyrë sa më të shpejtë dhe efikase, por edhe për realizimin sa më cilësor të qëllimit të tij.

AKEP, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në “Planin Kombëtar për Zhvillimin Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025”, ka siguruar për qytetarët mundësinë e kryerjes së ankesave në lidhje me shërbimin e Internetit, p.sh., cilësinë e tij, duke zhvilluar një platformë (Measuring tool).

Platforma është e aksesueshme në faqen e AKEP <https://nettest.akep.al/sq/test>, dhe çdo përdorues fundor mund ta përdorë për matjen e shpejtësisë aktuale të Internetit, duke bërë krahasimin me shpejtësinë e rënë dakord në kontratë. Pas kësaj, rezultatet mund të dorëzohen automatikisht në AKEP dhe mund të përdoren për të adresuar ankesat e përdoruesve fundorë.

Këshilli Drejtues i AKEP me Vendim nr. 10, datë 22.07.2021, miratoi dokumentin përfundimtar mbi “Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare”. Ky dokument përshkruan dhe shpjegon parimet kryesore të modelimit dhe parametrat kryesorë mbi të cilët janë llogaritur kostot e shërbimeve celulare, duke marrë parasysh maksimalisht rekomandimet e Komisionit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Ai adreson gjithashtu rezultatet e kostove të shërbimeve me shumicë të ofruara nga operatorët celularë në Shqipëri sipas metodologjisë LRIC+ dhe Pure LRIC.


AKEP ka vijuar punën për zbatimin e Marrëveshjes Rajonale të Roamingut për të bërë të mundur «Roaming like at home» nga data 1 korrik 2021, në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Gjatë vitit 2021, operatorët kanë raportuar të dhëna mbi numrin e pajtimtarëve dhe volumet e trafikut të shërbimeve celulare (voice, sms dhe data). Të dhënat e dërguara nga operatorët janë mbledhur dhe agreguar nga rregullatorët e vendeve të BP dhe më pas janë dërguar pranë strukturave të BEREC të cilët kanë përgatitur raporte periodike mbi ecurinë e treguesve të shërbimeve roaming në vendet e BP6, si edhe pjesës së vendeve të tjera EEA dhe ‘Rest of the World’.

Nga të dhënat e raportuara nga operatorët e Shqipërisë gjatë këtyre periudhave rezulton se efektet e zbatimit të politikës së reduktimit të shërbimeve roaming në BP, dhe fillimi i regjimit RLAH kanë pasur ecuri mjaft pozitive për përdoruesit fundorë.

**SHTYLLA
TË VEPRIMIT
STRATEGJIK
PËR VITIN 2022**

1. *Zbatimi i angazhimeve strategjike kundrejt Bashkimit Evropian, përmes marrjes nga AKEP nën administrim efektiv dhe tërësor të brezit 700Mhz nga AMA brenda vitit 2022;*
.....
2. *Nënshkrimi i marrëveshjes ndërkufitare me Republikën e Maqedonisë së Veriut për përcaktimin e rregullave administrative dhe procedurat teknike për planifikimin dhe koordinimin e frekuencave, me qëllim parandalimin e interferencave reciproke në rrjetet e shërbimit fiks radio dhe të lëvizshëm telefonik tokësor, si dhe përdorimin sa më optimal të spektrit radio;*
.....
3. *Realizimi i një vlerësimi të hollësishëm dhe me impakt afatgjatë i parametrave, kapaciteteve dhe instrumenteve tekniko-ligjorë për sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve kritike në AKEP, me qëllim parandalimin dhe asgjësimin e sulmeve kibernetike;*
.....
4. *Fokusimi mbi çeljen e procesit të analizës së tregjeve me shumicë të aksesit broadband në internet, bazuar në rekomandimet, metodologjitë dhe standardet më të fundit të Bashkimit Evropian në funksion të arritjes së objektivave rregullatore dhe nxitjes së përparimit të shoqërisë digjitale;*
.....
5. *Konceptimi, nën udhëheqjen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të qasjeve proaktive mbi zhvillimin e infrastrukturës broadband dhe aksesin sa më të gjerë në shërbimet broadband, mbështetur në Planin Kombëtar për Zhvillim e Qëndrueshmëri të Infrastrukturës Broadband 2020-2025;*
.....
6. *Përditësimi i rregullave për regjistrimin, përdorimin dhe administrimin e emrave të domain cc.TLD.al dhe nëndomain-et e tij, si dhe rishikimi i Rregullores nr. 2, datë 21 shkurt 2008, për “Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al”;*
.....
7. *Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së shërbimeve postare, universale dhe jo-universale, përmes një sondazhi kombëtar të aksesueshëm nga të gjithë përdoruesit fundorë me synim përpunimin e një sërë rekomandimesh për të ardhmen e një shërbimi postar sa më të përgjegjshëm dhe eficient.*



I

2021, NJË VIT PREMTUES PËR
MË SHUMË NDËRLIDHJE DHE
INTEGRIM:

NGA ROAMING RAJONAL, DREJT
REDUKTIMIT PROGRESIV TË
TARIFAVE ROAMING ME VENDET E
BASHKIMIT EVROPIAN

1. Shpërbërja e barrierave tarifore për shërbimet roaming në Ballkanin Perëndimor

Siç është vënë në dukje në raportet e mëparshme vjetore përgjatë viteve 2018-2020, AKEP ka kontribuar në mbështetjen e iniciativave të Qeverisë për reduktimin, deri në heqjen e tarifave roaming me Republikën e Kosovës dhe vendet e Ballkanit Perëndimor (në vijim BP).

Agjenda digjitale për Ballkanin Perëndimor është një angazhim i përbashkët i vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Komisionit Evropian, duke e cilësuar atë si një nga gjashtë shtyllat kryesore në kuadër të perspektivës së zgjerimit dhe pranimit të këtyre vendeve në Bashkimin Evropian.

Qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor në takimin e organizuar në Sofje, më 17 maj 2018, nënshkruan një marrëveshje për eliminimin e tarifave të shërbimeve roaming në rajon si dhe shprehën mbështetjen për uljen e kostove të këtyre tarifave midis vendeve të BP dhe BE.

Ndër të tjera, qëllimi i marrëveshjes përfshin edhe përmirësimin e klimës së biznesit në fushën e digjitalizimit përmes garantimit të qëndrueshmërisë, parashikueshmërisë dhe nxitjes së konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike.

Në kuadër të këtij procesi ministritë përgjegjëse për komunikimet elektronike të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, kanë nënshkruar në Beograd me datë 4 prill 2019, marrëveshjen rajonale për reduktimin e tarifave të roaming-ut në BP, në përputhje me parimet e modelit të zbatuar në vendet e BE-së *Roam Like At Home* (RLAH).

Pas nënshkrimit të *"Marrëveshjes mbi reduktimin e çmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimit celular në rajonin e Ballkanit Perëndimor"* (në vijim RRA), AKEP, bazuar në përcaktimet e ligjit 9918/2008 me Vendimet e Këshillit Drejtues me nr. 21-24, datë 24.6.2019, miratoi dokumentin *"Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri – Ballkani Perëndimor"*.

Përgjatë viteve 2019-2020, AKEP mori masat e duhura për miratimin e vendimeve për fillimin dhe zbatimin e marrëveshjes rajonale të roaming-ut me vendet e BP. Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming me vendet e BP u realizua me faza duke filluar nga data 1 korrik 2019, ku fillimisht, përgjatë periudhës 1.6.2019 - 30.6.2021 rregullimi i tarifave roaming me pakicë me vendet e BP u krye në përputhje me parimet e modelit RLAH+ (tarifim njësoj si brenda vendit, duke aplikuar një shtesë mbi këto tarifa, por me tavane maksimale çmimesh të parashikuara në marrëveshje dhe të miratuara nga AKEP).

Përgjatë vitit 2021 AKEP u fokusua në miratimin e akteve nënligjore përkatëse për të mundësuar fillimin

e heqjes së tarifave roaming RLAH, duke filluar nga data 1.7.2021 për qytetarët dhe të gjithë pajtimtarët e Shqipërisë, gjatë udhëtimeve të tyre në vendet e BP.

Në kuadër të këtij procesi, pas kryerjes së procedurave të këshillimit publik dhe administrimit të komenteve të palëve të interesuara, Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr.9, datë 9.6.2021, ka miratuar për zbatim nga operatorët dokumentet¹³ për zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë (FUP), si edhe Udhëzuesin për zbatimin e RLAH dhe FUP, si vijon:

- *“Rregullore mbi zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së Heqjes së Tarifave Roaming me Pakicë (RLAH) me Ballkanin Perëndimor”;*
- *“Udhëzime për zbatimin e RLAH dhe FUP për roaming-un me Ballkanin Perëndimor”.*

Dokumentet e mësipërme të miratuara nga AKEP përmbajnë:

- rregulla për të siguruar zbatimin e qëndrueshëm të politikave të përdorimit të drejtë (Fair Use Policy – FUP), që operatorët celularë të Shqipërisë mund të aplikojnë për konsumin e shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë, ofruar pajtimtarëve me tarifën e aplikueshme me pakicë brenda vendit sipas modelit RLAH, me qëllim që të parandalojnë përdorimin abuziv ose anormal të shërbimeve të roaming;
- rregulla për procedurën dhe dokumentet që operatorët celularë duhet të depozitojnë në AKEP për t’u pajisur me autorizim për të zbatuar një tarifë shtesë roaming (surcharge), me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së modeleve të tyre të tarifimit brenda vendit, si dhe metodologjinë për t’u zbatuar nga AKEP për vlerësimin e këtyre kërkesave/aplikimeve.

Miratimi i këtyre akteve nga AKEP plotëson gjithashtu të gjitha angazhimet e Shqipërisë për zbatimin e marrëveshjes së roaming-ut RRA të nënshkruar nga Qeveria në kuadër të procesit të Berlinit, si dhe rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë për institucionin e AKEP gjatë viteve të fundit, për zbatimin dhe heqjen e tarifave roaming me Republikën e Kosovës dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Procesi për reduktimin e tarifave të roaming në BP, ka qenë një proces dinamik dhe ka zgjatur për një periudhë më shumë se dy vjeçare. Gjatë këtij procesi ka pasur takime dhe diskutimeve të vazhdueshme me strukturat e Këshillit të Kooperimit Rajonal (Regional Cooperation Council RCC) në cilësinë e koordinatorit të procesit të reduktimit të tarifave të roaming në BP, BE, organet rregullatore të rajonit, si edhe operatorët vendas dhe të rajonit.

Implementimi me sukses i RLAH me BP në Shqipëri nga data 1.7.2021, përbën një nga arritjet më të rëndësishme jo vetëm në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe me KE, por sidomos për përfitimet e

¹³ Këto dokumente janë hartuar në përputhje me përcaktimet e ligjit 9918/2018 (neni 7, pika 1 dhe neni 55, pika 2/c) dhe marrëveshjes RRA, duke u mbështetur në Rregulloren Implementuese të Komisionit Evropian 2016/2286 të datës 15 Dhjetor 2016 ku paraqiten rregullat e detajuara për vlerësimin e qëndrueshmërisë dhe reduktimit të tarifave roaming në vendet e BE-së, si edhe Udhëzimet përkatëse të BEREC.

qytetarëve dhe bizneseve të RSH në përdorimin e shërbimeve celulare.

Ky model tarifimi për pajtimtarët e rrjeteve celulare që përdorin shërbimin roaming (RLAH), është i aplikueshëm prej datës 1.7.2021 për të gjithë përdoruesit:

- me parapagesë dhe paspagesë (apo kombinim të mënyrës së pagesës);
- që përdorin apo jo oferta të operatorëve;
- me paketa aktive ose jo,
- që kanë njësi të mbetura të shërbimeve ose jo.

Në përputhje me modelin RLAH, të gjithë pajtimtarët celularë prej datës 1.7.2021 tarifohen për të gjitha shërbimet celulare të konsumuara në roaming në BP sipas tarifave/mekanizmit të tarifimit përkatës të aplikuar në Shqipëri me paketa aktive për shërbimet celulare, të tilla si:

- Thirrje dalëse, thirrje hyrëse (0 lekë);
- SMS dalëse, SMS hyrëse (0 lekë);
- Data/Internet (sipas politikës së përdorimit të drejtë - FUP).

Pajtimtarët që përdorin paketa/oferta me paspagim apo parapagim do të kenë mundësinë që gjatë roaming në BP të përdorin njësine e shërbimeve të përfshira në pagesën fikse periodike (muajore) apo të ofertave me parapagim (ditore, javore, 30 ditore etj.), sikundër të ishin në Shqipëri, pra, pa tarifa shtesë apo nevojën për të blerë oferta shtesë roaming në BP.

2. Monitorimi i zbatimit të angazhimeve për shërbime roaming të njësuar dhe të balancuara prej 1 korrikut 2021

Pas miratimit të akteve të cituara më sipër, AKEP bashkëpunoi ngushtësisht me tre operatorët celularë, duke kryer takime dhe duke dhënë sqarimet përkatëse, përfshirë ndihmesën dhe këshillimin për përmirësim të informacionit të publikuar në faqet web të operatorëve celularë për RLAH me BP.

Implementimi i RLAH ishte një sfidë për shkak të afateve të shkurtra kohore të realizimit të plotë të saj, si dhe numrit të madh të planeve tarifore dhe ofertave të operatorëve celularë që kishin nevojë për përfshirjen e tarifimit sipas modelit të RLAH në sistemet e faturimit.

Në përputhje me sa më sipër, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të AKEP, duke filluar nga data 1 korrik 2021, të tre operatorët celularë të Shqipërisë kanë njoftuar aplikimin e tarifave të shërbimit roaming në vendet e BP njësoj si brenda vendit, dhe në përputhje me politikat e përdorimit të drejtë (FUP).


Gjatë gjithë kësaj periudhe operatorët periodikisht kanë raportuar të dhëna mbi numrin e pajtimtarëve dhe volumet e trafikut të shërbimeve celulare (voice, sms dhe data). Të dhënat e dërguara nga operatorët janë mbledhur dhe ndërthurur së bashku me të dhënat e sjella nga rregullatorët e vendeve të BP, dhe më pas janë dërguar pranë strukturave të BEREC, të cilët kanë përgatitur raporte periodike mbi ecurinë e treguesve të shërbimeve roaming në vendet e BP.

Gjithashtu, në funksion të hartimit të raporteve periodike, AKEP ka përcjellë në datë 24.12.2021 pranë strukturave të RCC-së informacionet në lidhje me ecurinë e tarifave dhe volumeve të njësive të konsumuara në roaming nga qytetarët shqiptarë gjatë qëndrimit të tyre në vendet e BP.

Nga të dhënat e raportuara prej operatorëve celularë të Shqipërisë gjatë këtyre periudhave rezulton se efektet e zbatimit të politikës së reduktimit të shërbimeve roaming në BP, dhe fillimi i regjimit RLAH, ka pasur ecuri mjaft pozitive për përdoruesit e këtyre shërbimeve.

Në vijim paraqiten disa të dhëna krahasuese për volumet e shërbimeve celulare dhe pajtimtarët që kanë përdorur roaming në BP.

Numri i pajtimtarëve që kanë përdorur roaming të paktën një herë gjatë periudhës tremujore në BP.




Burimi: Të dhëna nga operatorët celularë. Përpunimi AKEP.

Siç vërehet nga të dhënat e grafikut, rritja ka qenë më e theksuar gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2021, periudha të cilat përkojnë me hyrjen në fuqi të shërbimit RLAH e plotë.

Shtimi më i ndjeshëm i pajtimtarëve që kanë përdorur shërbimet roaming në BP shihet gjatë tremujorit të tretë 2021, i cili është rritur me pesë herë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tabela: Volumi i thirrjeve të dërguara dhe të marra gjatë roaming në BP



Burimi: Të dhëna nga operatorët celularë. Përpunimi AKEP.

Volumi i thirrjeve dalëse në roaming në BP gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021 arriti në rreth 2.4 milionë minuta, nga rreth 266 mijë minuta që raportohen një tremujor më përpara.

Edhe nga krahasimi i të dhënave të tremujorit të katër 2021 me periudhat para fillimit të RLAH, vërehet një rritje e konsiderueshme e volumit të thirrjeve dalëse.


E njëjta ecure pozitive ka qenë edhe për thirrjet e marra nga pajtimtarët shqiptarë gjatë qëndrimit në roaming në vendet e BP veçanërisht gjatë tremujorëve të tretë dhe të katërt të vitit 2021 (vlen të theksohet se të gjitha thirrjet hyrëse gjatë aplikimit të RLAH janë falas, njësoj si brenda vendit).

Efektet pozitive të reduktimit të tarifave të shërbimeve roaming janë pasqyruar edhe në rritjen e përdorimit të shërbimit të internetit gjatë qëndrimit në roaming në vendet e BP.

Konkretisht, gjatë tremujorit të tretë 2021, volumi i internetit të përdorur në roaming e ka kaluar shifrën prej 103 mijë GB internet, që përbën një rritje me 11 herë krahasuar me periudhën T3-2019 dhe një rritje me rreth 14 herë krahasuar me periudhën T3 të vitit 2020.

Edhe gjatë tremujorit T4 të vitit 2021 volumi i konsumit të internetit ka qenë ndjeshëm më i lartë se tremujorët e katërt të viteve pararendëse.


Tabela: Volumi i internetit të përdorur gjatë qëndrimit në roaming në BP



Burimi: Të dhëna nga operatorët celularë. Përpunimi AKEP.

Rritje ka shënuar edhe numri i mesazheve të dërguara dhe të marra gjatë qëndrimit të pajtimtarëve të operatorëve të Shqipërisë në roaming. Megjithatë, kjo rritje nuk është në të njëjtat nivele me atë të volumit të minutave dhe të internetit (data), kjo edhe si shkak i përdorimit më të pakët të shkëmbimit të sms, si pasojë e rritjes së përdorimit të gjerë të aplikacioneve OTT.

Tabela: Volumi i SMS-ve të dërguara gjatë qëndrimit në roaming në BP



Burimi: Të dhëna nga operatorët celularë. Përpunimi AKEP.

Bazuar në sa më sipër, vërehet se qytetarët e Republikës së Shqipërisë kanë përfituar dukshëm nga reduktimi i tarifave të shërbimeve roaming në BP, veçanërisht gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt të vitit 2021 ku ka hyrë në fuqi RLAH (në përputhje me politikën e përdorimit të drejtë).

Rritje ka pasur edhe për periudhat e aplikimit të RLAH+, por kjo rritje ka qenë më e moderuar, rrjedhojë kjo edhe e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Monitorimi në terren i zbatimit të Marrëveshjes nga operatorët

AKEP ka kryer monitorime në terren gjatë muajve nëntor dhe dhjetor lidhur me zbatimin e marrëveshjes nga operatorët shqiptarë, mbi reduktimin e çmimeve të shërbimeve roaming në Ballkanin Perëndimor.

Verifikimet janë realizuar përkatësisht në territorin dhe kufirin me vendet fqinje si Republika e Malit të Zi, Republika e Kosovës dhe Republika e Maqedonisë së Veriut, në përdorimin e teknologjive GSM, UMTS, LTE. Verifikimi i shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimit celular në Ballkanin Perëndimor të operatorëve shqiptarë u orientua në tre drejtime:

Figura 2: Stacioni i lëvizshëm i monitorimit të cilësisë (QOS)
Burimi: AKEP



- 1. Ofrimi i shërbimeve roaming bazuar në tarifat e shërbimit.**
- 2. Ofrimi i shërbimeve roaming bazuar në paketat aktive të përdoruesve.**
- 3. Ofrimi i shërbimit të thirrjeve dhe SMS hyrëse pa tarifa nga operatorët.**

Pas këtyre verifikimeve, grupi i punës i ngritur në AKEP për kontrollin e zbatimit të Marrëveshjes mbi Reduktimin e Çmimeve të Shërbimeve Roaming në Rrjetet Publike të Komunikimit Celular në Ballkanin Perëndimor, konstatoi se:

1. Ofrimi i shërbimeve roaming kryhet bazuar në tarifat e shërbimit sipas deklarimeve të operatorëve në faqet e tyre web.
2. Ofrimi i shërbimeve roaming kryhet bazuar në paketat aktive të përdoruesve sipas njësive të paketave të deklaruara nga operatorët në faqet e tyre web.
3. Ofrimi i shërbimit të thirrjeve dhe SMS-ve kryhet pa tarifa nga të tre operatorët celularë shqiptar.

3. Roadmap-i rajonal dhe bashkëpunimi në perspektivën e heqjes së tarifave roaming mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe atyre të Bashkimit Evropian

Nënshkrim i marrëveshjes RRA nga qeveritë e vendeve të BP dhe zbatimi i saj nga rregullatorët dhe operatorët celular u arritën falë bashkëpunimit rajonal të organeve politikbërëse dhe autoriteteve rregullatore të BP me KE dhe Këshillin e Kooperimit Rajonal (RCC). Fillimi i heqjes së tarifave roaming në BP përbën një gur të rëndësishëm në integrimin në BE dhe, sidomos, në përfitimet e qytetarëve të BP nga shërbimet celulare.

Reduktimi i tarifave të roaming-ut midis BE dhe vendeve të BP, është hapi tjetër që vjen pas zbatimit me sukses të Marrëveshjes Rajonale të Roaming-ut, për roaming si në shtëpi (RLAH) nga data 1 korrik 2021, si rezultat i bashkëpunimit me rregullatorët dhe operatorët e BP.

Në funksion të këtij procesi, RCC bazuar në angazhimet për Agjendën Digjitale të udhëheqësve të Ballkanit Perëndimor si dhe në Planin për Tregun e Përbashkët Rajonal (CRM 2021-2024) të miratuar në Samitin e Sofjes në nëntor 2020, pas konsultimeve të vazhdueshme me palët e interesit (organet rregullatore, ministritë e linjës, strukturat e KE) ka përgatitur një udhëzues (Roadmap) për reduktimin e tarifave të roaming-ut midis BE dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.



Figura 3: Takim i nivelit të lartë mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, AKEP dhe sipërmarrësve kryesorë të komunikimeve elektronike për jetësimin e Roadmap-it rajonal, në shtator 2021

Burimi: Fotografia kortezi e zyrës së shtypit të MIE

Strukturat e AKEP kanë qenë pjesëmarrës aktivë në këtë proces dhe vazhdimisht kanë inkurajuar përfshirjen e operatorëve të vendeve të BE dhe BP, si edhe strukturave të BEREC, duke vënë theksin se pikëpamjet dhe njohuritë teknike të tyre janë shumë të rëndësishme në gjithë procesin, dhe sugjerimet e bëra prej tyre duhet të merren parasysh dhe të reflektohen në Roadmap.

Falë këmbënguljes së vazhdueshme të AKEP¹⁴ dhe koordinimit të suksesshëm të RCC me instancat vendimmarrëse europiane, Komisioni European kërkoi nga BEREC gjatë seancës plenare të rregullatorëve evropianë, mbajtur në Stokholm më 8 dhjetor 2021, një përfshirje më aktive në këtë proces:

.....
*“Të mbahet shënim se, samiti BE-BP i mbajtur në Brdo më 6 tetor e mirëpriti udhërrëfyesin për uljen e tarifave roaming midis BE dhe BP, çka do të krijojë kushte dhe synime të qarta për uljen e kostove midis BE dhe BP. Gjatë muajit tetor, ministrat e miratuan globalisht qasjen e udhërrëfyesit me rastin e samitit digjital të BP, duke theksuar nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të mjedisit të biznesit për operatorët e telefonisë së lëvizhme anembanë rajonit. Mbështetja dhe ekspertiza e BEREC-ut do të jetë e vyer për mbarëvajtjen e procesit.”*¹⁵
.....

Roadmap i përgatitur nga RCC evidenton se reduktimi i tarifave të shërbimeve roaming midis vendeve të BP dhe BE, parashikohet jo mbi bazën e marrëveshjeve ndërmjet vendeve, por nëpërmjet zbatimit vullnetar nga ana e operatorëve celularë të secilit vend.



Figura 4: Seanca plenare e BEREC e 10 dhjetorit 2021 në Stokholm gjatë së cilës Komisioni European udhëzoi trupën europiane të rregullatorëve për një angazhim të shtuar në jetësimin e Roaming-ut mes BE dhe BP
Burimi: Fotografitë AKEP 2021

14 Shih fjalën e Kryetarit të AKEP në takimin e mbajtur me datë 23.11.2021 në takimin e mbajtur në Sarajevë, BH.

15 “Note that the EU-Western Balkans summit in Brdo on 6 October welcomed the roadmap for lowering roaming charges between the EU and Western Balkans, which should create the conditions and set clear targets for lowering roaming costs between the EU and the Western Balkans. Later on in October, ministers endorsed the overall vision of the roadmap at the WB Digital Summit, while stressing the necessity for continuous improvement of business environment for mobile operators across the region. BEREC’s support and expertise will be valuable for the onward process”. (EC Info Update – 7 December 2021, f. 3)

Dokumenti i prezantuar për reduktimin e tarifave të roamingut midis vendeve të BP dhe BE, është hartuar duke u mbështetur në 4 shtylla kryesore të cilat synojnë të krijojnë kushtet e nevojshme edhe për reduktimin e tarifave të shërbimeve roaming BP-BE, të tilla si:

1. Zbatimi i vazhdueshëm efikas i Marrëveshjes Rajonale Roaming (RRA);
2. Rritja e transparencës dhe e monitorimit;
3. Përafrim me acquis të BE për komunikimet elektronike;
4. Përmirësim të mjedisit të investimeve.

Disa nga masat dhe reformat politikbërëse të propozuara nga udhërrëfyesi, pjesë e katër shtyllave të mësipërme, parashikohen të realizohen në një afat kohor përgjatë 2022-2024.

Në këto masa përfshihen:

- Transpozimi i Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike në legjislacionin kombëtar të vendeve të Ballkanit Perëndimor brenda vitit 2023;
- Hartimi dhe zbatimi i Planeve Kombëtare të Broadband nga ana e vendeve të BP brenda vitit 2023;
- Ngritja e Zyrave Kompetente Broadband (BCO) për investimet në broadband dhe 5G nga secili vend i BP brenda vitit 2022;
- Thjeshtimi i procedurave të dhënies së lejeve nga autoritetet kompetente vendase për rrjetet brenda vitit 2023;
- Tarifa të përshtatshme për lejet dhe të drejtat e kalimit brenda vitit 2023;
- Sigurim i aksesit në infrastrukturën fizike në pronësi të institucioneve publike;
- Sigurim i aksesit në kohë për spektrin 5G;
- Sigurim i një qasje miqësore për investime në spektrin 5G;
- Sigurimi i fondeve financiare për vendet e BP si një ndihmë shtesë për të nxitur investimet.

Realizimi i reformave të mësipërme në funksion edhe të reduktimit të tarifave të shërbimeve roaming kërkon marrjen e masave dhe angazhimin e qeverive dhe rregullatorëve të telekomunikacionit të vendeve të Ballkanit Perëndimor, strukturave të Komisionit Evropian (përfshirë edhe BEREC), operatorëve celularë, si dhe aktorëve të tjerë pjesë e këtij procesi.

Rolet dhe detyrat kryesore sipas strukturave përkatëse paraqiten si vijon:

Qeveritë e vendeve të BP kanë detyra për:

- Angazhim të drejtpërdrejtë dhe mbështetje për këtë proces;
- Transpozim të Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike në legjislacionin kombëtar të vendeve të Ballkanit Perëndimor brenda vitit 2023;
- Heqjen e barrierave ligjore dhe administrative në funksion të nxitjes së investimeve të ardhshme.

Autoritetet Rregullatore përgjegjëse për komunikimet elektronike në BP do të kryejnë :

- Koordinim të mbledhjes dhe të dërgimit të të dhënave nga operatorët;
- Ndjekjen dhe rishikimin e zbatimit të 'glide-path' dhe plotësimit të detyrimeve që janë nën përgjegjësinë e tyre;
- Ofrim të ekspertizës dhe mbështetjes në funksion të implementimit të masave të tjera dhe reformave politike të nevojshme.

Strukturat e Komisionit Evropian (RCC, DG CONNECT, BEREC) :

- RCC do të koordinojë dialogun midis palëve të përfshira në këtë proces me mbështetjen e ekspertizës së DG CONNECT dhe BEREC sipas nevojave;
- Organizimin e takimeve të rregullta për të rishikuar ecurinë e procesit të zbatimit të 'Roadmap' dhe propozimet e nevojshme;
- Konsultim periodik me operatorët e vendeve të BE dhe BP.

Operatorët e ofrimit të shërbimeve celulare të vendeve të BP dhe BE duhet të :

- negociojnë marrëveshje tregtare efektive për vitin pasardhës kalendarik, duke synuar dakordësinë për kushtet, në përputhje me parashikimet e 'Roadmap'.
- angazhohen se në vijim do të reduktojnë tarifën me pakicë të këtyre shërbimeve në nivele jo më të larta se ato të propozuara në 'glide-path'.

Gjatë gjithë kësaj periudhe AKEP është angazhuar maksimalisht si në krijimin e kushteve të përshtatshme për implementimin me sukses të zbatimit të marrëveshjes për heqjen e tarifave të shërbimeve roaming midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, ashtu edhe në bashkëpunimin me strukturat e lartpërmendura për zgjerimin e kësaj iniciative edhe me vendet e Bashkimit Evropian.

Nëpërmjet këtyre iniciativave synohet ulja e kostove që qytetarët shqiptarë duhet të paguajnë kur udhëtojnë në këto vende, e shoqëruar kjo me rritje të cilësisë së marrjes së shërbimeve roaming gjatë qëndrimit të tyre në këto vende.

Aktualisht, AKEP po punon ngushtësisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektivave të parashikuara në roadmap, duke nxitur angazhimin dhe pjesëmarrjen e operatorëve celularë në Shqipëri në këtë proces të rëndësishëm.

Gjatë vitit 2021, shërbimet e komunikimeve elektronike kanë vijuar të jenë mbështetës të rëndësishëm të lehtësimit të komunikimit ndërmjet kategorive të ndryshme të konsumatorit fundor me Qeverinë, bizneset, si dhe aktorëve të tjerë ndërlidhës të sferës ekonomiko-shoqërore. Përshtatja e aktorëve të tregut të komunikimeve elektronike ndaj nevojës për të qenë mbështetës të rëndësishëm në rrethanat e reja që u krijuan pas situatës pandemike e shkaktuar nga COVID-19, në një masë të konsiderueshme ka bërë të mundur vijimin e praktikës së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike me të njëjtat standarde profesionale si gjatë vitit 2020.

Zhvillimet periodike të tregut të komunikimeve elektronike kushtëzohen jo vetëm nga tendenca e tij për të zhdërvjelltësuar konkurrencën efçente, pavarësisht sfidave të krijuara në situatën pandemike dhe shtysave të brendshme të vetë tregut, por edhe si nevojë e brendshme për të qenë në koherencë me kërkesat gjithnjë në rritje që sjell zhvillimi i novacionit dhe teknologjisë në fushën përkatëse, gjë e cila impakton nevojën e operatorëve celularë dhe të rrjeteve fikse për të investuar në përmirësimin e kapaciteteve të tyre për ofrimin e shërbimeve kryesisht të internetit.

II

TREGJET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE NËN PESHËN E GLOBALIZIMIT DIGJITAL:

NJË VLERËSIM NË NIVEL
KOMBËTAR PËR VITIN 2021





1. Zhvillimet në tregjet relevante dhe mbikëqyrja rregullatore

1.1 Pasojat e përpjesëtimit gjithmonë e më të zhdrejtë mes telefonisë dhe shërbimeve broadband

Treguesit kryesorë të shërbimeve të rrjeteve celulare dhe fikse

Pajtimtarët

Numri i pajtimtarëve aktivë që kanë përdorur shërbimin internet celular nëpërmjet kartave SIM në fund të vitit 2021 arriti në rreth 2 milionë, i cili përbën një rritje me rreth 3% krahasuar me vitin pararendës. Pra rreth 78% e pajtimtarëve aktivë të shërbimeve celulare përdorin internetin nëpërmjet telefonave smart.

Gjatë vitit 2021 ka vijuar tendenca e ndryshimit të strukturës së pajtimtarëve, ku vihet re ulje e numrit të pajtimtarëve me parapagim (72% nga 77% që ishte në vitin 2020), gjë që tregon tendencën e shkuarjes drejt shërbimeve me kontratë (paspagim).

Të dhënat e evidentuara nga AKEP tregojnë se numri total i kartave SIM arriti në rreth 3.4 milionë gjatë vitit 2021, e thënë ndryshe çdo banor në Shqipëri posedon rreth 1.23 karta SIM, shifër kjo më e lartë se masatarja e rajonit të Evropës dhe ajo globale përkatësisht 1.18 dhe 1.11 karta SIM për banorë.¹⁶

Ndërkohë, numri i kartave SIM aktive (numri i kartave të përdorura për të kryer komunikime elektronike gjatë tre muajve të fundit) arriti në rreth 2.6 milionë, me një rritje të lehtë rreth 0.63% krahasuar me vitin 2020.

Ofrimi i shërbimit të internetit nga rrjetet fikse ka pasur një rritje të konsiderueshme për sa i përket numrit të pajtimtarëve të rinj, por edhe rritje të kapacitetit dhe shpejtësisë për ofrimin e këtij shërbimi.

Numri pajtimtarëve me akses broadband fiks në fund të vitit 2021 për herë të parë iu afrua shifrës së 560 mijë pajtimtarëve, duke u rritur me rreth 10% në krahasim me vitin 2020.¹⁷

¹⁶ <https://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Documents/facts/FactsFigures2021.pdf>

¹⁷ Të dhënat e ITU për vitin 2021 mund të gjenden në këtë link <https://www.statista.com/statistics/370681/fixed-broadband-internet-penetration-region/>

Në vitin 2021 norma e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse ishte mbi 77% për familje dhe rreth 20% në krahasim me numrin e popullsisë, duke shënuar një rritje të ndjeshme përkatësisht me 7 pikë përqindje dhe 2 pikë përqindje nga normat e vitit 2020.

Bazuar në të dhënat rajonale vërehet se qarket me normat më të larta të penetrimit urban edhe për vitin 2021 janë Tirana dhe Korça, përkatësisht me nga 43.55% dhe 30.42%.

Ndërsa Durrësi është qarku që ka normën më të lartë të penetrimit rural rreth 23%, i ndjekur nga Tirana, Shkodra dhe Lezha me nga 10%. Mesatarja e normës së penetrimit urban për vitin 2021 rezulton rreth 30%, ndërsa mesatarja e për rajonet rurale është rreth 8%.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në Shqipëri në vitin 2021 ka pësuar një rënie rreth 12%, konkretisht nga 223,496 në fund të vitit 2020 rezulton në 197,690 në fund të vitit 2021.

Volumi i njësive të përdorura

Gjatë vitit 2021, situata e krijuar nga vazhdimi i pandemisë, puna online, dhe mësimdhënia online, kanë nxjerrë në pah më shumë se kurrë nevojën jo vetëm për akses në shërbimet e internetit, por edhe qasjen në këto shërbime me shpejtësi më të lartë dhe më të qëndrueshme.

Volumi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet mobile, arriti në rreth 155 milionë GB. Kjo përbën një rritje rreth 74.9% krahasuar me vitin 2020.

Rritja e përdorimit të internetit nëpërmjet telefonave celularë evidenton faktin se tashmë telefonat celularë të pajisur me karta SIM e kanë ridimensionuar rolin e tyre duke kaluar nga përdorimi tradicional për kryerjen e thirrjeve zanore, drejt ofrimit të aksesit të gjerë në botën virtuale (shfletim informacionesh, transmetim të dhënash, kryerje e thirrjeve audio/video, sms, etj.).

Rritja e përdorimit të internetit u shoqërua me ulje të:

- numrit të SMS-ve;
- volumit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.

Ashtu siç është evidentuar edhe në raportet pararendëse të AKEP, rënia e përdorimit të këtyre treguesve është pasojë edhe e përdorimit në masë i aplikacioneve OTT (*whatsapp, Viber, Messenger, Skype etj.*) nëpërmjet të cilëve dërgohen mesazhe tekst dhe kryhen thirrje zanore dhe 'video calls'. Komunikimi nëpërmjet këtyre aplikacioneve ka ardhur gjithnjë në rritje edhe si rezultat i përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga operatorët e rrjeteve 4G dhe 4G+ të cilët mundësojnë transmetim me cilësi më të mirë si të mesazheve ashtu edhe të thirrjeve (video dhe audio) nëpërmjet këtyre aplikacioneve.

Vlen të theksohet se në ndryshim nga viti 2020, gjatë vitit 2021:

- *volumi mesatar mujor i thirrjeve për përdorues ka shënuar rritje me rreth 5% duke arritur në 360 minuta thirrje hyrëse dhe dalëse,*
- *volumi i konsumit mesatar mujor të internetit është rritur me përafërsisht 64% duke arritur në rreth 6.39 GB në muaj.*

Bazuar në masat e ndërmarra nga AKEP për mos-diskriminim të tarifave të thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, rezulton që gjatë vitit 2021, rreth 44% e thirrjeve të realizuara kanë qenë drejt operatorëve të tjerë celularë 'off-net' dhe rreth 55% brenda rrjetit 'on-net', duke shënuar një ndryshim të lehtë me rreth 1 pikë përqindje nga viti i kaluar për të dy treguesit.

Gjatë vitit 2021, trafiku i internetit broadband nga rrjete fikse arriti në rreth 952 milionë GB ose rreth 56% më shumë se viti 2020, çka tregon se pajtimtarët e këtij shërbimi e kanë shfrytëzuar këtë rrjet për të aksesuar shërbimet e tyre, financiare, informative, sociale, shëndetësore, në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme.

Për sa i përket përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse vihet re rritje e sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse. Sasia e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të Albtelecom si operatori me pjesën më të madhe në treg në vitin 2021 u rrit me 5% në krahasim me vitin 2020, ndërsa mesatarja e minutave të thirrjeve në muaj për përdorues të rrjetit fiks të Albtelecom, i cili është operatori me rrjetin fiks më të rëndësishëm në vend është rritur nga 33 minuta në vitin 2020 në 37 minuta në vitin 2021.

Teknologjitë e ofrimit të shërbimit dhe mbulimi me 3G dhe 4G

Rritja e numrit të pajtimtarëve të shërbimeve internet, si edhe zhvillimet teknologjike paralelisht sjellin edhe rritjen e kërkesës për cilësi në ofrimin e këtyre shërbimeve. Përdoruesit e internetit, si shkak edhe i tendencave dhe nevojës për të kryer punë online, kanë diktuar rritjen e kërkesës për të pasur lidhje me shpejtësi dhe qëndrueshmëri më të lartë, si edhe nevojën për mbulimin edhe të zonave rurale të pambuluara, kryesisht atyre me potencial për ofrimin e shërbimeve të turizmit.

Të tre operatorët që ofrojnë shërbime celulare, për vitin 2021 kanë raportuar mbulim të popullsisë me rrjet 3G në nivele rreth 90 – 99%.

Për sa i përket mbulimit të territorit dhe popullsisë me rrjet LTE (4G), bazuar në raportimet e kryera për vitin 2021 rezulton se :

- Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a, është operatori që ka mbulimin më të gjerë me këtë teknologji, duke arritur nivelin 95.9% të mbulimit të territorit me rrjet 4G, dhe 98.9% të mbulimit të popullsisë.

- Sipërmarrësi One Telecommunications sh.a ka raportuar mbulim të territorit 95.1% me rrjet 4G dhe 98.5% të popullsisë.
- Sipërmarrësi Albtelecom sh.a ka mbulimin më të ulët të territorit me rrjet 4G me 42% dhe mbulimi të popullsisë 81%, duke shënuar megjithatë një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me vitin 2020.

.....

Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të internetit konfirmohet edhe nga raporti i Opensignal (organizëm ndërkombëtar i pavarur) që synon të paraqesë gjendjen reale të rrjeteve celulare në mbarë botën bazuar në eksperiencën e përdorimit të shërbimit nga vetë përdoruesit e rrjeteve.¹⁸ Sipas këtij raporti, konstatohet se dy nga operatorët kanë arritur tregues mjaft të mirë për sa i përket mbulimit me rrjet 4G dhe shpejtësisë së këtij shërbimi, duke iu mundësuar përdoruesve navigim cilësor në rrjetin e internetit celular lidhur me thirrjet zanore nga aplikacionet OTT, shpejtësinë download/upload, cilësi të videove dhe shërbime të tjera digjitale.

Përmirësim i cilësisë së ofrimit të shërbimit të internetit vërehet edhe në tregun e ofrimit të shërbimeve *broadband* nga rrjetet fikse. Në vitin 2021 rritjen më të madhe e kishte pjesa e pajtimtarëve me lidhje *broadband* me shpejtësi 1Gbps ose më të madhe, duke rezultuar në rreth 5-fishim të pajtimtarëve krahasuar me vitin 2020.

Gjatë vitit 2021, pjesa e pajtimtarëve që përdorin shpejtësi më shumë se 10 Mbps ka arritur në 83%, krahasuar me rreth 67% që ishte në vitin 2020. Zhvendosja e pajtimtarëve drejt paketave që ofrojnë shpejtësi interneti më të lartë i mundëson përdoruesve të marrin shërbimet e kërkuara me cilësi më të lartë dhe pa ndërprerje.

Për sa i përket rritjes së niveleve të shpejtësisë së ofruar vlen të theksohet se gjatë vitit 2021 është evidentuar një rritje e konsiderueshme e pajtimtarëve që përdorin rrjet me shpejtësi më të madhe se 100 Mbps, ku nga rreth 15,406 në vitin 2020, ky numër ka arritur në 55,065 në vitin 2021.

Rritja e ndjeshme e numrit të pajtimtarëve që kanë akses në lidhje fikse me shpejtësi më shumë se 100 Mbps është një tregues mjaft pozitiv në funksion të arritjes së objektivave të parashikuara në planin kombëtar të *broadband* për infrastrukturë digjitale *broadband* të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në të gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit.

Teknologjia kryesore për ofrimin e aksesit *broadband* në rrjete fikse është FTTH/FTTB duke shënuar rritje me rreth 36% krahasuar me vitin 2020 e ndjekur nga lidhjet DSL.

Shumica e lidhjeve DSL janë me rrjete të kombinuar fibër optike dhe bakri (FTTN/FTTC). Vlen të theksohet se gjithnjë e më shumë sipërmarrësit që ofrojnë shërbimet *broadband* nga rrjetet fikse po i zhvendosin linjat e tyre nga lidhjet me DSL (dhe kombinimet me të) drejt ofrimit të këtij shërbimi nëpërmjet fibrave optike FTTH/FTTB të cilat mundësojnë transmetim me shpejtësi dhe cilësi shumë herë më të lartë se DSL.

Në fund të vitit 2021 numri i lidhjeve bazuar në teknologjinë DSL është ulur në rreth 85 mijë nga rreth 170 mijë që numëronte në vitin 2019, sikundër numri i lidhjeve me teknologji FTTH/FTTB në fund të vitit 2021 arriti në mbi 314 mijë nga rreth 142 mijë në vitin 2019.

Dinamika e pjesëve të tregut

Në vijimësi zhvillimi i tregjeve bazohet në ndërtimin e strategjive të reja tregtare dhe inovative me fokus teknologjinë. Këto strategji modelojnë jo vetëm zhvillimin e produktit apo shërbimit që ofrohet për konsumatorin, por edhe vetë përqasjen e konsumatorit ndaj risive që sjell tregu. Kompleksiteti i tregut në identifikimin e aftësive strategjike, në ruajtjen e mirë dhe përdorimin e efikasitetit të kostos, në përpjekjet e aktorëve të tregut për të arritur dhe mbajtur avantazhet konkurruese, në nevojën për diagnostikimin e duhur të aftësive strategjike dhe perfeksionimin e menaxhimit të tyre, janë ngushtësisht të lidhura me politikat sektoriale.

Në këtë këndvështrim duhen vlerësuar edhe investimet e operatorëve celularë dhe fiks të kryera gjatë viteve të fundit, të cilat kanë dhënë efekt edhe në nxitjen e konkurrencës midis operatorëve ku vërehen lëvizje për sa i përket pjesëve të tregut të secilit operator.

Edhe gjatë vitit 2021, sipërmarrësi Vodafone Albania vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për të gjithë treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile. Megjithatë, vlen të theksohet se ai ka shënuar rënie të lehtë për pjesën më të madhe të këtyre treguesve krahasuar me vitin 2020.

Konkretisht pjesët e tregut për vitin 2021 për sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a variojnë me:

- rreth 44% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card, nga rreth 47% në vitin 2020;
- rreth 45% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë, nga rreth 47% në vitin 2020;
- rreth 50% të tregut për thirrjet dalëse, nga rreth 53% në vitin 2020;
- rreth 56% të tregut për volumin e të dhënave (internetit), nga rreth 64% në vitin 2020;
- rreth 45% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband), nga rreth 49% në vitin 2020;
- **53% dhe 54% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe nga shërbimet me pakicë.**

Sipërmarrësi One Telecommunications, ka vijuar rritjen në treguesit kryesorë gjatë vitit 2021 duke i dhënë një nxitje konkurrencës në tregun e shërbimeve celulare, kjo gjë pasqyrohet edhe në rritjen e pjesëve të tregut për disa nga treguesit kryesorë:

- rreth 40% të pjesëve të tregut për përdoruesit e SIM card, nga rreth 37% në vitin 2020;
- rreth 39% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë, nga rreth 37% në vitin 2020;

- rreth 39% të tregut për thirrjet dalëse mobile, nga rreth 34% në vitin 2020;
- rreth 32% të tregut për volumin e të dhënave (internetit), nga rreth 23% në vitin 2020;
- rreth 40% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband), nga rreth 36% në vitin 2020;
- **rreth 34% dhe 33% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë, nga rreth 31% për të dy treguesit në vitin 2021.**

Sipërmarrësi Albtelecom sh.a., gjatë vitit 2021 nuk ka mundur të përmirësojë pozitat e tij në treg dhe ka shënuar rënie të lehtë të treguesve kryesorë krahasuar me vitin 2020. Rënien më të ndjeshme e ka shënuar për treguesin e thirrjeve dalëse:

- rreth 16% të pjesëve të tregut për përdoruesit e SIM card, në të njëjtin nivel me vitin 2021;
- rreth 15% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë, duke shënuar ulje me 1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021;
- rreth 11% të tregut për thirrjet dalëse mobile, nga rreth 13% në vitin 2020;
- rreth 12% të tregut për volumin e të dhënave (internetit), nga rreth 13% në vitin 2020;
- rreth 15% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband), në të njëjtin nivel me vitin 2020;
- **rreth 13% dhe 14% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë nga rreth 14% për të dy treguesit në vitin 2021.**

Tarifat e shërbimeve të rrjeteve celulare dhe fikse

AKEP, në përputhje me përcaktimet e nenit 54 të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, si edhe akteve rregullatore për këtë qëllim, monitoron në mënyrë periodike ecurinë e tarifave, si dhe kryen publikimin e tyre në mënyrë transparente në faqen zyrtare të AKEP dokumente për informacion për tarifën e shërbimeve nga rrjetet celulare, rrjetet fikse, si dhe për tarifën e shërbimeve të aksesit në internet broadband.

Gjatë vitit 2021 ofruesit e shërbimeve celulare kanë vijuar me njoftimin për lançimin e disa fushatave promovionale për planet ekzistuese, si edhe lançimin e paketave të reja për kategori të caktuara përdoruesish.

Pjesën kryesore e zënë paketat standarde 30 ditore, të cilat variojnë nga 500 lekë deri në 2,500 lekë me përmbajtje të ndryshme nga disa njësi deri minuta/SMS/internet pa limit. Elementi konkurrues vërehet tek çmimet promovionale që kanë ofruar sipërmarrësit për paketa të ndryshme, të cilat kanë qenë më të përqendruara gjatë fundvitit duke aplikuar ulje deri në 50% të paketave ekzistuese dhe shtim të njësive përbërëse të paketave. Të tre operatorët celularë ofrojnë një numër të madh paketash duke synuar përshtatjen me kërkesat dhe preferencat konsumatore, ku mund të evidentohen edhe dizajnimet e paketave për grupe të caktuara konsumatorësh, në përputhje me nevojat dhe karakteristikat e konsumatorëve. Në ofrimin e shërbimeve celulare me pakicë operatorët celularë janë të orientuar

kryesisht në ofrimin e paketave bundle me përmbajtje në minuta dhe sms, si edhe në kapacitet të ndryshëm interneti.

Tarifat e ofrimit të shërbimeve celulare standarde janë ndjeshëm më të larta se tarifat e ofruara në paketa të integruara (bundle), por përdorimi i këtyre tarifave është dukshëm më i vogël se paketat bundle, konkretisht thirrjet celulare si pjesë e paketave bundle zënë rreth 96.5 % të thirrjeve totale, nga 96.8% që ishte në vitin 2020.

Gjithashtu, për sa i përket volumit të SMS, vërehet se gjatë vitit 2021 përqindja e tyre si pjesë e paketave bundle arrin në 95.8% të SMS totale, nga 95.6% që ishte në vitin 2020. Pra, nga këto shifra duket qartë që pothuajse gjithë përdoruesit përdorin paketa bundle që përfshijnë sasi të mjaftueshme thirrjesh dhe SMS (deri pa limit), dhe kjo ka bërë që të reduktohet ndjeshëm masa e aplikimit të tarifimit standard. Në ndryshim nga tregu i ofrimit të shërbimeve celulare, numri i operatorëve që ofrojnë shërbime interneti dhe shërbime të integruara nga rrjetet fikse është ndjeshëm më i lartë, por shtrirja e tyre në pjesën më të madhe ka karakter lokal. Numri i lartë i ofruesve të këtyre shërbimeve shoqërohet edhe me llojshmëri të paketave që ofrohen në treg, kjo si në aspektin e çmimit, ashtu edhe të kombinimeve dhe njësive të përfshira. Praktikisht, krahasimi i çmimeve të paketave të shërbimeve nga rrjetet fikse është i vështirë për t'u realizuar, kjo për shkak se në pjesën më të madhe të tyre këto shërbime ofrohen të kombinuara.

Gjatë vitit 2021 sipërmarrësit që ofrojnë shërbime nga rrjetet fikse janë përqendruar në plane të reja tarifore në teknologjinë internet fibër broadband + IPTV, ku fokusi kryesor është vendosur tek rritja e nivelit të shpejtësisë së internetit të ofruar ku tashmë ofrohen edhe shpejtësi download të gjeneratës Gigabit.

Paketat e integruara (Bundles)

Strategjia e konsumit drejt paketave bundle me shërbime të integruara thirrje telefonike kombëtare, SMS dhe akses në Internet e shoqëruar me ndryshimet e cituara ka çuar në krahasim më të lehtë të paketave të një operatori dhe ato midis operatorëve të ndryshëm dhe kontroll më të lehtë të shpenzimeve nga përdoruesit celularë.

Tendenca e operatorëve celularë në ofrimin e paketave për përdoruesit me parapagim është ofrimi i tyre në bazë konsumi 1 ditor, javor dhe mujor (30 ditor), duke përfshirë në shumicën e tyre përveç thirrjeve telefonike dhe SMS edhe akses në Internet. Këto paketa krijojnë mundësinë e zgjedhjes për përdoruesit me parapagim dhe janë lehtësisht të krahasueshme në bazë të çmimit, njësive të konsumit të përfshira në paketa dhe kohëzgjatjes së tyre.

Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa të integruara të shërbimeve të aksesit në internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV), rezulton të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse.

Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/ TV) në fund të vitit 2021 arriti në rreth 302,596, rreth 3% më shumë se në vitin 2020.

Në publikimet periodike të informacionit mbi tarifat celulare që kryen AKEP në faqen elektronike, në një seksion të veçantë mund të bëhet krahasimi i paketave mes operatorëve, duke përdorur si bazë krahasimi periudhën e përdorimit të paketave dhe çmimet respektive të tyre.

Nga këto të dhëna rezulton se:

- Në rrjetet celulare dhe fikse, numri i paketava/promocioneve/ofertave është i konsiderueshëm dhe me mundësi të larmishme zgjedhjeje për konsumatorin fundor.
- Për të dy kategoritë e pajtimtarëve (familjare dhe biznes), operatorët kanë ngjashmëri në politikat e marketingut që ndjekin në llojshmërinë e shërbimeve të ofruara për tregun për paketat (para dhe paspagim).
- Në aspektin e transparencës, evidentohet se ofertat, shërbimet standarde dhe paketat janë të publikuara në faqet zyrtare të operatorëve, në seksione të veçantë për pajtimtarë familjare dhe biznes, me sqarime të hollësishme për secilën kategori mbi mënyrën e pagesës, çmimet e shërbimeve të ofruara sipas kategorive kryesore, biznes dhe familjare.

Konkurrueshmëria

Tregjet e telefonisë celulare

Gjatë vitit 2021 ka pasur një fushatë marketingu intensive nga ana e ofruesve të shërbimeve celulare, ku operatorët vazhdimisht kanë njoftuar lançimin e planeve tarifore të reja apo edhe ndryshimin e atyre ekzistuese. Fokusi kryesor është përqendruar në ofrimin e njësive të shërbimit të internetit që paketat përmbajnë, ku është rritur ndjeshëm volumi për shpejtësinë 4G, e cila kombinohet me përdorim interneti pa limit, por me shpejtësi të reduktuar.

Në përputhje me misionin e tij specifik, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) mbikëqyr tregjet e komunikimeve elektronike dhe postare për të shqyrtuar në mënyrë të rregullt dinamikat përkatëse në prizmin e konkurrencës së lirë dhe efçente, transparencës dhe objektivitetit, me një fokus të veçantë mbi impaktin e tyre në shërbimet që i ofrohen konsumatorëve.

Në këtë kuadër, AKEP ka ndjekur me interes të posaçëm zhvillimet në tregun e pakicës të telefonisë celulare, i cili ndonëse është jashtë rregullimit, mbetet në vëmendjen e institucionit për të parandaluar, nëpërmjet komunikimeve dhe dialogut të vazhdueshëm me sipërmarrësit, prirje të caktuara tregtare që mund të përshkallëzohen në praktika të dëmshme apo në situata artificiale ofertash dhe çmimesh në kundërshtim me interesin afatmesëm dhe afatgjatë të aktorëve të tregut dhe të konsumatorëve.

Përveç faktit se në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të akteve rregullatore përkatëse, sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohen një parimi të përgjithshëm përgjegjshmërie sociale përkundrejt konsumatorëve, ata janë të detyruar t'i përshtasin dinamikën e tyre tregtare parimeve normative të një konkurrence të lirë, të ndershme dhe efëcente, bazuar në politika dhe veprime objektive, proporcionale dhe transparente. Devijimi nga këto detyrime mund të sjellë për pasojë mëdyshje të përligjura në kapacitetet vetërregulluese të tregut të pakicës dhe marrje në konsideratë të ndërhyrjeve të njëanshme rregullatore.

Për këto arsye, AKEP i ka ftuar në mënyrë të rregullt sipërmarrësit të reflektojnë, përmes dialogut dhe veprimeve konkrete, përshtatjen e domosdoshme të praktikave dhe fushatave të tyre promocionale ndaj parimeve ligjore dhe rregullatore të sipërpërmendura, duke marrë masa për të ulur tryshninë ndaj konsumatorëve dhe krijimin e kushteve të favorshme për gjithsecilin për të krahasuar dhe zgjedhur lirshëm, në mënyrë transparente dhe në afate të arsyeshme, shërbimet dhe ofertat e parapëlqyera.

Tregjet e rrjeteve fikse

Në fund të vitit 2021 numri i sipërmarrësve që kanë njoftuar ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse në Shqipëri është rreth 240. Pjesa më e madhe e operatorëve alternativë janë te vegjël dhe me prani shumë të kufizuar rrjeti në zona urbane apo rurale afër qendrave urbane.

Tregu i ofrimit të shërbimeve broadband nga rrjetet fikse karakterizohet nga një numër i lartë pjesëmarrësish dhe si rezultat në këtë treg konkurrueshmëria është e lartë.

Vetëm disa nga subjektet pjesë e këtij tregu kanë shtrirje të gjerë në disa qarqe të vendit, pjesa tjetër konkurron në segmente më të vogla kryesisht janë ofrues lokalë.

Për vitin 2021 operatorët me pjesët më të madhe të tregut broadband fiks janë renditur si më poshtë:

.....

- Albtelecom zotëron rreth 21% pjesë tregu;
- Vodafone Albania zotëron 20% pjesë tregu;
- ASC zotëron 11% pjesë tregu;
- Abissnet me rreth 8% pjesë tregu;
- Digicom rreth 4% të pjesës totale të tregut;
- Nisatel me rreth 4% pjesë tregu;
- OA (operator të tjerë), me 33% të tregut.

.....


Gjatë viteve të fundit është vërejtur ofrimi i shërbimeve të kombinuara të rrjeteve fikse me ato mobile, duke promovuar paketa që sjellin përfitime në të dy tregjet nëse përdorin shërbime të kombinuara.

Të ardhurat dhe investimet në rrjetet e komunikimeve elektronike

Nga raportimet e kryera gjatë vitit 2021, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike raportuan **në total rreth 35.4 miliardë lekë të ardhura** nga komunikimet elektronike, shifër kjo më e lartë se ajo e vitit 2020, si edhe vitit 2019 periudha para pandemike.

Në rritjen e të ardhurave totale të tregut peshën kryesore e ka pasur rritja e të ardhurave të gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse.

Grafiku në vijim paraqet të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike totale dhe të ndara sipas tregjeve fikse dhe celulare.



Burimi: Të ardhura të raportuara nga operatorët. Përpunimi AKEP

Në tregun e ofrimit të shërbimeve celulare gjatë vitit 2021 operatorët kanë raportuar nje **xhiro prej 24.5 miliardë lekë**, e cila përbën një rritje me rreth 3% krahasuar me vitin 2020.

Megjithëse në vlerë më të ulët se në vitin 2020, edhe për gjatë vitit 2021 kanë vijuar *investimet në rrjetet e ofrimit të shërbimeve celulare*, ku vërehet se gjatë këtij viti janë investuar më shumë se **4.6 miliardë lekë**. Rreth 82% e vlerës së investimeve të raportuara kanë shkuar në funksion të përmirësimit të infrastrukturës së ofrimit broadband nga rrjetet celulare, gjë e cila reflektohet edhe në përmirësimin e mbulimit me rrjet 3G dhe 4G, si rezultat edhe të volumit të internetit të konsumuar.

Të ardhurat nga komunikimet elektronike të raportuara nga ofruesit e shërbimeve nga rrjetet fikse për vitin 2021 tejkaluan vlerën prej **10.9 miliardë lekë**. Kjo përbën një rritje me rreth 15% në krahasim me vitin 2020.

Më shumë se 80% e të ardhurave të këtij tregu gjenerohen nga 7 operatorët kryesorë, konkretisht:

- Albtelecom sh.a. (34%),
- Vodafone sh.a. (24%),
- ASC (7%),
- ATU, Abissnet, Nisatel dhe Digicom me nga rreth 4%,
- Operatorët e tjerë (OA), edhe pse në numër të konsiderueshëm përbëjnë rreth 20% të të ardhurave të këtij tregu.

Bazuar në raportimet e kryera, përgjatë vitit 2021, sipërmarrësit e rrjeteve fikse kanë kryer rreth 2.4 miliardë lekë investime të cilat kryesisht kanë si destinacion përmirësimin e aksesit të shërbimeve broadband, ku ndër investimet kryesore është fokusimi drejt zhvendosjes së rrjeteve të transmetimit nga teknologjia DSL drejt teknologjisë me fibër.

Në lidhje me nivelin e të ardhurave për disa nga sipërmarrësit kryesor në tregun e komunikimeve elektronike na informon figura në vijim.




Figura: Shpërndarja e të ardhurave të operatorëve të komunikimeve elektronike (në milionë Lekë)
Burimi: Të ardhura të raportuara nga operatorët. Përpunimi AKEP

Tregu i shërbimeve elektronike është një ndër sektorët që ka një kontribut mjaft të rëndësishëm edhe në punësim. Për vitin 2021 ky treg numëron më shumë se 3,280 të punësuar.

1.2 Përftimi i modelit të avancuar kombëtar të kostos për analizat e tregjeve sipas standardeve të shek. XXI

Përgjatë vitit 2020 dhe 2021 AKEP ka mundur vijimin e procesit deri në miratimin e dokumentit përfundimtar *“Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare”*.

Nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, është synuar paraqitja e kostove reale të shërbimeve të ofruara nga rrjetete celulare duke marrë në konsideratë edhe tiparet dhe karakteristikat e vendit ku operatorët ushtrojnë aktivitetin. Del e nevojshme të sqarojmë se duke filluar nga muaji prill 2014, AKEP ka përdorur metodën benchmark për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve celulare (MTR), ku si benchmark është përdorur vlera mesatare e tarifave të terminimit në vendet Evropiane që kanë aplikuar modelin e kostove LRIC të pastër, metodë kjo në përputhje edhe me rekomandimin e KE.

Evidentimi i kostove të shërbimeve celulare në përputhje me praktikën e vendeve të BE-së, aktualizuar edhe me rrethanat kombëtare ka qenë edhe një kërkesë nga ana e operatorëve celularë gjatë proceseve të mëparshme të analizave të tregut të shërbimeve celulare të ndërmarra nga AKEP.

Për të finalizuar një model kombëtar të kostove, AKEP ka kontraktuar shoqëritë konsulente “AIR Communications Shpk” dhe “Tera Consultants Sha”, të cilët kanë përcaktuar modelin e përdorur, së bashku me parimet e përgjithshme dhe metodologjinë për realizimin e modelit, si dhe mënyrën se si do të vlerësohen këto kosto.

Në dokumentin përfundimtar *“Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare”* janë evidentuar rezultatet e kostove të shërbimeve me shumicë të ofruara nga operatorët celularë në Shqipëri sipas metodologjisë LRIC+ dhe Pure LRIC.

Modeli i llogaritjes së kostove të shërbimeve celulare i prezantuar nga konsulentët, pas miratimit nga Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 24, datë 26.11.2020, iu nënshtrua procedurave të këshillimit publik gjatë periudhës 26.11.2020 – 26.12.2020. Në përfundim të kësaj procedure të Këshillimit Publik, AKEP administroi komentet e palëve të interesuara dhe ia përcolli konsulentëve për t’i sintetizuar në dokumentin final që do të përdoret si model për llogaritjen e kostove të shërbimeve celulare.

Në vijim të këtij procesi, AKEP, me vendimin e Këshillit Drejtues nr.3, datë 1.4.2021, miratoi dokumentin *“Modeli i referencës së dokumentit për ndërtimin e modelit të kostove për shërbimet mobile” - Dokument Përfundimtar*.

Në përputhje me detyrimet kontraktore, duke u mbështetur në Modelin final të Kostove të miratuar me VKD nr.3, datë 1.04.2021, dhe nga të dhënat e marra nga operatorët celularë në Shqipëri, bashkimi i shoqërive konsulentë pas analizimit dhe përpunimit të të dhënave, duke u bazuar edhe në praktikën e vendeve të BE, ka hartuar dokumentin *“Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare – Dokument për Këshillim Publik”*.

AKEP, me vendimin nr. 8, datë 27.5.2021, miratoi për Këshillim Publik dhe nxori në këshillim publik për një periudhë njëmuore dokumentin “Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare – Dokument për Këshillim Publik”.

Në vijim, Këshilli Drejtues i AKEP me Vendim nr.10, datë 22.07.2021, miratoi dokumentin përfundimtar mbi “Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare”.¹⁹

Në dokumentin e përgatitur nga konsulentët për rezultatet e prodhuara nga modeli i kostove, dhe të miratuar nga AKEP janë paraqitur në detaje të gjitha çështjet e modelimit, supozimet, parametrat, procedurat dhe metodologjitë e përdorura në zhvillimin e modelit të kostos së shërbimeve të telefonisë së lëvizshme (mobile). Dokumenti gjithashtu paraqet qasjen dhe llogaritjet e kryera si pjesë e vlerësimit të Kostove mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC) për aktivitetet e shërbimeve celulare.

Konsulentët kanë paraqitur në dokument edhe një propozim për reduktim të përshkallëzuar për tarifat e terminimit të thirrjeve kombëtare për të shkuar drejt kostove të evidentuara për këtë shërbim, ku mbi bazën edhe të praktikave të ndjekura nga vende të BE, kanë përlogaritur një periudhë 2 vjeçare për të arritur në MTR kombëtare prej 0.75Lekë. Orientimi i tarifave të terminimit të thirrjeve drejt kostove, nxit konkurrueshmërinë në tregun e ofrimit të shërbimeve të terminimit të thirrjeve celulare, dhe si rezultat rritjen e përfitimeve edhe për konsumatorët fundorë.

Rezultatet e gjeneruara nga modeli i kostove, veçanërisht tarifat e kostove të terminimit të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare do të përdoren në proceset e ardhshme të analizave të tregjeve të terminimit të thirrjeve, si edhe në procese të tjera sipas nevojave të autoritetit.

1.3 Përpunimi i informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike (ATLAS)

AKEP ka ngritur dhe menaxhon sistemin e përqendruar të informacionit ATLAS, ku të gjithë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike regjistrojnë rrjetin e tyre aktiv dhe pasiv, në zbatim të dispozitave të:

- Ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.

Puna mbi përditësimin e të dhënave në sistemin e përqendruar të informacionit të rrjeteve të komunikimeve elektronike (ATLAS) nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike ka vijuar përgjatë gjithë vitit 2021.

Janë informuar të gjithë operatorët mbi detyrimin për përditësimin e të dhënave në sistem dhe shumica e operatorëve kanë regjistruar të dhënat në sistemin online.

¹⁹ <https://akep.al/wp-content/uploads/2022/03/Vendim-Nr.10-date-22.07.2021.pdf>

Përditësimi i të dhënave është një proces i vazhdueshëm, konform rregullores nr. 26, datë 16.8.2012 për "Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Në fund të vitit 2021, prej 245 sipërmarrësve vihet re se:

- kanë kryer regjistrimin e rrjetit sipas përcaktimeve të rregullores rreth 150 sipërmarrës;
- kanë kryer regjistrimin e rrjetit, por u është kthyer për rishikim për plotësimin dhe saktësimin e fushave sipas përcaktimeve të rregullores, rreth 86 sipërmarrës;
- kanë deklaruar që nuk kanë rrjet në pronësi të tyre rreth 14 sipërmarrës;
- kanë akses në sistemin Atlas, por nuk kanë regjistruar rrjetin e tyre, 37 sipërmarrës;
- nuk kanë kthyer përgjigje për aksesimin dhe regjistrimin e të dhënave në sistemin Atlas 44 sipërmarrës, për të cilët janë marrë masat përkatëse.

Duhet theksuar se në këtë proces problematika kryesore për hedhjen e të dhënave të rrjeteve në sistemin ATLAS ka qenë me organet e pushtetit vendor, të cilët kanë hedhur pak informacion gjatë vitit 2021, megjithë kujtesën e herëpashershme nga AKEP.

Gjatë vitit 2021 janë përditësuar të dhënat në sistemin Atlas për treguesit e monitorimit të cilësisë së shërbimit QoS për telefoninë e lëvizshme për teknologjitë GSM, UMTS dhe LTE.

AKEP gjatë vitit 2021 ka vazhduar bashkëpunim me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) në lidhje me depozitimin e të dhënave për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike në formatin GIS (shapefile), në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 166, datë 1.3.2017 "Për përcaktimin e autoritetit përgjegjës që administron pikën e vetme të informacionit për ofrimin e informacionit minimal për rrjetet e infrastrukturës në nivel kombëtar".

Gjithashtu, AKEP në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është duke punuar ngushtësisht me konsulentin e përzgjedhur nga MIE në lidhje me projektin "Zhvillimi i ATLAS të Broadband të Shqipërisë", projekt në kuadër të investimeve të EU përmes programit të investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF).

Aktualisht ky projekt ndodhet në fazën e "Pre-feasibility" dhe parashikohet të mbyllet brenda një periudhe 3 vjeçare.

Projekti ka për qëllim:

- të rrisë transparencën në shkëmbimin e informacionit për komunikimet me brez të gjerë (broadband);
- të përmirësojë politikëbërjen dhe planifikimin në sektorin digjital;
- të rrisë efikasitetin e investimeve dhe përdorimin e rrjetit të investuar nga operatorët publikë dhe privatë.

Në terma konkretë projekti ka për qëllim vlerësimin dhe më pas zhvillimin e sistemit ATLAS, duke shtuar funksionalitete të reja ku mund të përmendim përditësimin e këtij sistemi me:

- informacion deri në përdoruesin fundor;
- informacion mbi përdorimin e internetit me bandë të gjerë në Shqipëri;
- ofruesit e rrjetit në një zonë të caktuar;
- informacion mbi zonat e bardha;
- mbulimin e shërbimeve celulare bazuar në praktikën dhe modelet më të mira ndërkombëtare.

Ky projekt, përveç zhvillimit të sektorit privat, uljes së kostove të implementimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike, do të ketë impakt edhe në shtrirjen e rrjeteve me shpejtësi të lartë (broadband) në institucione shtetërore, arsimore, shëndetësore, bujqësore, turizmin, transportin, mjedisore, kulturore, administrative etj.

Po kështu, gjatë vitit 2021 ka vijuar bashkërendimi i veprimeve me të gjithë aktorët e interesuar për shkëmbim informacioni për rrjetin e komunikimeve elektronike. Është bashkëpunuar me ministrinë përgjegjëse në kuadër të hartimit dhe zbatimit të akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 120/2016 "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit".

1.4 Rritja eksponenciale e sipërmarrjes në tregun postar dhe impakti i saj në shërbimin universal postar

Tregu i shërbimeve postare

Spektori postar në Shqipëri ka kaluar një proces ndryshimesh të shtrira në kohë duke ndjekur modelin e vendeve të BE dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Transformimi ka kaluar nga ofrimi i shërbimeve postare tradicionale në kushte monopolistike, drejt një tregu të hapur në mënyrë graduale për konkurrencë, ku ofrimi i këtyre shërbimeve ndihmohet dhe nga zhvillimet teknologjike dhe modernizimi i infrastrukturës.

Spektori postar është sektori i rëndësishëm i ekonomisë shqiptare dhe përbën një nga sektorët me numrin më të madh të punonjësve në vend me rreth 3.200 të punësuar. Aktiviteti i sektorit postar drejtohet bazuar në legjislacionin përkatës (Ligji 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore dhe rregullatore në zbatim të tij) dhe zhvillimi i tij nga udhëzimet dhe objektivat e përcaktuara në dokumentin e politikave postare të hartuara dhe miratuara nga Qeveria.

Tregu i shërbimeve postare ka ndryshuar ndjeshëm vitet e fundit. Një ndër ndryshimet kryesore është zhvendosja nga komunikimi tradicional i bazuar në letër drejt komunikimeve me mjete elektronike, gjë e cila ka çuar në rënie të konsiderueshme të vëllimeve të objekteve postare. Në të njëjtën kohë, digjitalizimi nxit rritjen eksponenciale të vëllimeve të pakove postare (kolive postare) për shkak të rritjes së tregtisë elektronike (e-commerce).

Gjatë vitit 2021 është vërejtur një rritje e vëllimit të pakove postare, tendenca rritëse e nxitur nga tregtia elektronike është bërë segmenti kryesor për hyrësit e rinj në treg, ofrues të shërbimeve të dorëzimit të pakove postare, **ku nga 26 operatorë që numëroheshin deri në fund të vitit 2020, tashmë ky numër ka arritur në 34 operatorë në fund të vitit 2021.**

AKEP në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të përmbushjes së angazhimeve në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit për shërbimet postare ka kontribuar për transpozimin e rregullores së BE-së 644/2018 për shërbimet e dërgesave ndërkufitare të pakove postare, e cila u miratua me Udhëzimin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5, datë 25.06.2021 “Për miratimin e rregullave mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare”.

Në zbatim të udhëzimit të sipërcituar AKEP ka njoftuar dhe udhëzuar të gjithë sipërmarrësit e ofrimit të shërbimeve postare për detyrimet që burojnë nga ky udhëzim.

Në vijim, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi dhe pas mbledhjes së informacionit nga ofruesit e shërbimeve postare, AKEP ka publikuar në faqen zyrtare informacion përmbledhës mbi tarifat postare ndërkufitare që këta operatorë ofrojnë.

Tregues të volumit të tregut postar

Shërbimet postare në Shqipëri përgjatë vitit 2021 u ofruan nga 34 subjekte të pajisur me ‘Autorizim të Përgjithshëm’, nga këto Posta Shqiptare sh.a., është ofruesi i vetëm i ofrimit të Shërbimit Universal Postar.

Numri total i objekteve postare të pranura gjatë vitit 2021 nga Posta Shqiptare sh.a., dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte rreth **27.1 milionë**, një rritje me 9.4% krahasuar me vitin 2020.

Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së volumit të shërbimeve postare të Postës Shqiptare sh.a.

E njëjta gjë ka ndodhur edhe me totalin volumeve të pranura nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postare. Rritjen më të madhe e ka shënuar shërbimi jo-universal postar për postën ndërkombëtare me rreth 72%, ndërkohë edhe shërbimi postar ekspres brenda vendit ka shënuar rritje me rreth 14% krahasuar me vitin 2020. Rënie kanë shënuar zërat postë brenda vendit dhe ekspres ndërkombëtar, përkatësisht me 10.2% dhe 1.6%.


Të ardhurat dhe investimet e tregut postar

Në zbatim të ligjit Nr.46/2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” AKEP mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore dhe financiare nga ofruesit e shërbimeve postare në përmbushje të detyrave rregullatore.

Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2021 nga ofruesi i shërbimit universal postar dhe ofruesit e shërbimeve postare, të ardhurat financiare në tregun postar rezultojnë të jenë rreth **2.65 miliardë lekë.**

Operatori me pjesën më të madhe të tregut të shërbimeve postare *Posta Shqiptare sh.a*, gjatë vitit 2021 ka gjeneruara **një total të ardhurash prej 1.43 miliardë lekë**, ndërkohë ofruesit e tjerë të shërbimeve postare kanë realizuar rreth **1.22 miliardë lekë të ardhura në total**.

Nga krahasimi i të ardhurave të raportuara në vitin 2021, vërehet një rënie me rreth 5% krahasuar me të ardhurat e raportuara në vitin 2020. Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar në të ardhurat për vitin 2021 për disa nga operatorët kryesorë.




Grafik: Pjesë tregu në të ardhurat e sektorit postar Viti 2021 Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta

Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Nga të dhënat e grafikut më sipër, për pjesët e tregut në të ardhura vihet re se :

- Posta Shqiptare sh.a gjeneron pjesën më të madhe të të ardhurave me rreth 54%,
- DHL me 21 %,
- United Transport me 7% ,
- Albanian Delivery Express me 6%,
- Operatorët e tjerë të gjithë së bashku kanë gjeneruar rreth 12% të totalit të të ardhurave nga sektori postar.

Për sa i përket të ardhurave të Postës Shqiptare, rreth 92% e të ardhurave janë gjeneruar nga shërbimi universal postar, ndjekur nga shërbimi postar ekspres me 8 %.



Grafik: Ecuria e të ardhurave dhe investimeve 2015-2021

Burimi: Të dhëna të dërguara nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë. Përpunimi AKEP

Siç vërehet në grafikun sa më sipër, pavarësisht uljes së lehtë të të ardhurave të gjeneruara nga sektori i shërbimeve postare, investimet në këtë sektor kanë shënuar një rritje të ndjeshme duke shënuar vlerën më të madhe të viteve të fundit, rreth 660 milionë lekë, shprehur ndryshe rreth 82% më shumë se në vitin 2020. Pjesën më të madhe e zënë investimet e kryera nga Posta Shqiptare me rreth 40% të totalit, e ndjekur nga United Transport me rreth 37% të totalit.

Inspektimi i shërbimit postar

Në planin vjetor të inspektimit ishin programuar të inspektohen të gjithë subjektet që ofrojnë shërbime postare të regjistruar në Regjistrin e Shërbimeve Postare dhe në përfundim të vitit 2021 u arrit të realizohej inspektimi në terren i të gjithë këtyre subjekteve.

Gjatë këtyre inspektimeve u konstatua se:

- 5 ofrues të shërbimeve postare janë çregjistruar nga Regjistri i Autorizimit të Përgjithshëm;
- Për 6 subjekte janë konstatuar shkelje ligjore dhe ndaj tyre është marrë masë administrative "gjobë";
- 13 subjekte të cilët ofrojnë shërbime postare kanë zbatuar pjesërisht kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm, ndaj tyre janë vendosur dënime plotësuese në formën e rekomandimeve me afate kohore respektive për plotësimin e tyre sipas ligjit Nr. 46/2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë";
- ofruesit të shërbimit universal (Posta Shqiptare sha.) i ka përfunduar inspektimi në muajin janar 2022 dhe i janë lënë rekomandime me afate kohore për plotësimin e tyre.

Në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimi të lidhur datë 04.10.2019 midis AKEP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku përcaktohet ndërveprim institucional dhe bashkëpunim për shkëmbim informacioni sistematik mbi veprimtaritë respektive institucionale me qëllim realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave për rritjen e efikasitetit dhe bashkërendimit të punës për forcimin e luftës kundër informalitetit, të subjekteve që kryejnë veprimtari në fushën e komunikimeve elektronik dhe postare, strukturat inspektuese të AKEP gjatë muajve prill-korrik 2021 realizuan inspektime në terren dhe në distancë për disa subjekte të cilët rezultojnë të kryenin shërbim postar pa u pajisur me autorizim nga AKEP dhe të paregjistruar në regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Postare.

Në përfundim të kësaj procedure, rezultoi se një pjesë e tyre ishin në fillimet e nisjes së biznesit dhe u orientuan për ndjekjen e procedurave për regjistrim në Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Postare, një pjesë e tyre nuk kryenin shërbim të mirëfilltë postar, por shërbim “delivery” dhe 3 raste janë referuar për ndjekje tek Seksioni për Krimin Ekonomik dhe Financiar dhe për dijeni organit të prokurorisë.

1.5 Veprimtaria monitoruese dhe inspektuese në tregjet e mbikëqyrura dhe në përdorimin e frekuencave.

Veprimtaria monitoruese

Në referim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP është përcaktuar si autoriteti kombëtar përgjegjës për monitorimin e përdorimit të spektrit të frekuencave, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave. Me qëllim ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me monitorimin e përdorimit të spektrit të frekuencave dhe monitorimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve publike, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor, veçanërisht lidhur me zbatimin e kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin Individual dhënë subjekteve ofrues të shërbimeve publike, AKEP kryen në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e spektrit të frekuencave radio.

Monitorimi i spektrit të frekuencave 20 - 8500 Mhz, nga Stacionet Fikse ka për qëllim:

Monitorimin periodik me anë të stacioneve fikse të monitorimit të spektrit të frekuencave RFMS dhe SRMF, me qëllim ofrimin e të dhënave të vlefshme për procesin e administrimit të spektrit lidhur me përdorimin aktual të kanaleve të frekuencave dhe brezave të frekuencave, verifikimin e karakteristikave teknike reale të sinjaleve të transmetuara, ofrimin e informacioneve të monitorimit për kërkesat për asistencë të veçantë të administratave të vendeve fqinje në eliminimin e interferencave të dëmshme, si dhe identifikimin e pastrimit të transmetimeve jashtë brezi.

Detyra më e rëndësishme e monitorimit me anë të stacioneve fikse është mbledhja e të dhënave

mbi përdorimin e spektrit radio të frekuencave radio. Kjo kryhet si me matje individuale, edhe nëpërmjet regjistrimeve. Përveç trajtimit të interferencave, që përgjithësisht identifikohet si detyra më e rëndësishme e monitorimit, mbledhja e të dhënave të Okupimit të Kanaleve të Frekuencave (FCO) dhe Okupimit të Brezave të Frekuencave (FBO), mund të identifikohen si detyrë tjetër tepër e rëndësishme e Qendrës Kombëtare dhe Zyrave Rajonale të Monitorimit pranë AKEP.

Monitorimi Periodik i Spektrit të Frekuencave ka për qëllim:

Monitorim të frekuencave të radiolidhjeve fikse në pikat kryesore transmetuese të Republikës së Shqipërisë, ku janë instaluar pajisjet transmetuese të sipërmarrësve me qëllim verifikimin e përdorimit të frekuencave të dhëna me autorizim, i cili duhet të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit.


Qëllimet kryesore të përdorimit të këtyre pajisjeve gjatë vitit 2021 kanë qenë verifikimi i përputhshmërisë ligjore dhe administrative i detyrimit të sipërmarrësve që operojnë nën regjimin e Autorizimit Individual të AKEP, si dhe që përdorimi i frekuencave të dhëna me autorizim të jetë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në zbatim të kushteve të autorizimit, kryesisht për përdorimin e brezit të frekuencave të caktuara për përdorim radiolidhje fikse sipas Planit Kombëtar të Frekuencave dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave të AKEP.

Monitorimi i Cilësisë së Shërbimit për Shërbimet GSM, UMTS dhe LTE ka për qëllim:


Monitorimin e cilësisë së shërbimit të telefonisë mobile me qëllim evidentimin e zonave problematike me cilësi të dobët shërbimi, dhe nxitjen e operatorëve për përmirësim të mëtejshëm në këto zona për shërbimet GSM, UMTS dhe LTE.

Përgjatë vitit 2021 janë realizuar matje me zgjedhje manuale të teknologjive GSM, UMTS dhe LTE, si dhe për herë të parë janë realizuar matje për shumë zona rurale dhe me densitet të ulët të popullsisë, për të treguar ofrimin e shërbimeve mobile në këto zona.


Më poshtë po ilustruam nivelet e sinjaleve 3G (UMTS) dhe 4G (LTE), si dhe shpejtësitë e data downloaded për teknologjitë LTE dhe UMTS nga rezultatet e monitorimit në akset rrugore të aksesueshme, për zonat rurale të bashkisë Tiranë, Durrës, Shijak, Elbasan, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh, si dhe për plazhet kryesore të vendit.




Grafiku në % për sinjalin 4G



Grafiku në % për Data Downloaded për teknologjinë 4G (LTE)



Grafiku në % për sinjalin 3G



Grafiku në % për Data Downloaded për teknologjinë 3G (UMTS)

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar monitorimit të akseve të reja rrugore të vëna në qarkullim përgjatë vitit 2021, të tilla si:



1. Bypass i Vlorës, për të cilin pas kërkesës së AKEP dhe bashkëpunimit të operatorëve me njëri-tjetrin, është rritur ndjeshëm përqindja e mbulimit me shërbim.
2. Rruga e Arbrit si dhe aksi rrugor Vlorë-Kuç-Gusmar-Tepelenë, për të cilat po priten komentet e operatorëve mbi konstatimet e raporteve për përmirësimin e shërbimit të telefonisë së lëvizshme.

Për matjet e kryera janë përpiluar raportet përkatëse dhe u janë dërguar operatorëve për t'u shprehur mbi konkluzionet dhe përfundimet e këtyre raporteve, për marrjen e masave për përmirësimin e treguesve të cilësisë KPI (Key Performance Indicator), si dhe mbulimin dhe përmirësimin me shërbime broadband.

AKEP ka kërkuar angazhimin e operatorëve²⁰ lidhur me:

- Shtimin e zonave të reja për ndërtimin e stacioneve me investim të përbashkët të sipërmarrësve;
- Shtimin e zonave të reja për përmirësimin e zonave me mbulim të dobët dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në pjesë të territorit, ku niveli i sinjalit dhe indikatorët e cilësisë (KPI) nuk janë në përputhje me përcaktimet e rregullores nr. l6, datë 16.4.2010 për *"Treguesit e Cilësisë së Shërbimit"*.

Çështja e mbulimit me shërbime broadband në zonat me densitet të ulët të popullsisë, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar në disa zona, ka qenë në qendër të vëmendjes së AKEP. Për

²⁰ Letër e Kryetarit të AKEP nr.1488/1 Prot, datë 01.06.2021 me lëndë "Mbi domosdoshmërin për mbulim me sinjal të telefonisë së lëvizshme në Aksin rrugor By –passi Vlorë" dërguar Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe 3 operatorëve celularë
Letër e Kryetarit të AKEP nr.1488/7 Prot, datë 08.07.2021 me lëndë "Mbi marrjen e masave për mbulim me sinjal të telefonisë së lëvizshme në Aksin By –passi Vlorë" dërguar MIE



këtë janë ndërmarrë masa që të bëhet e mundur futja e shërbimeve broadband në zonat rurale dhe ato turistike, si dhe ofrimi i shërbimeve bazë të telefonisë dhe internetit atje ku ato mungojnë ose janë në nivele të ulëta në raport me cilësinë e kërkuar.

Të gjitha ndërhyrjet për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara si në zonat e pambuluara ashtu edhe në ato me nivel të ulët cilësie që duhet të planifikohen për periudhën 2022-2023, do të koordinohen edhe me operatorët sipas parashikimeve buxhetore të parashikuara për investime nga ana e tyre.

Trajtim i ankesave për interferenca të dëmshme

Nga një analizë e rasteve të raportuara për interferencë nga sipërmarrësit vihet re se shumica e tyre lidhen me frekuencat e përdorura për transmetimet broadband GSM, UMTS dhe LTE në frekuencat që përdorin operatorët e rrjeteve të lëvizshëm.

Për këto tipe interferencash, stacionet monitoruese fikse nuk janë gjithmonë të përshtatshëm, meqenëse identifikimi i problemit në këto raste kërkon të identifikohet edhe burimi (drejtimi) i sinjalit interferues, që në përgjithësi operon me një fuqi të ulët dhe në një zonë të ngushtë veprimi.

Metoda e ndjekur nga AKEP në monitorimin e interferencave është kombinimi i stacioneve fikse me pajisjet e stacionit të lëvizshëm të monitorimit, për të rritur efikasitetin në hetimin e interferencës.



Figura 5: Monitorim në metodën Homing DF me anë të QLMF

Burimi: AKEP

Për të bërë të mundur identifikimin e plotë të burimit të interferencës në një ankesë specifike, shpesh është i nevojshëm të kryhet inspektimi i pajisjeve radio të stacionit që është identifikuar si përgjegjës për interferencë. Inspektimi i kryer si pjesë e një pune të programuar synon të sigurojë që instalimi është në përputhje me kushtet teknike për përdorimin e tij, dhe që pajisja radio operon në mënyrë të tillë që të mos ketë mundësi të shkaktojë interferencë të padëshiruar.

Monitorimi i spektrit të frekuencave për trajtimin e ankesave për interferencë realizohet në bazë të ankesave nga operatorët, të cilat administrohen nga AKEP.

Rastet e interferencave të trajtuara gjatë vitit 2021 paraqiten si më poshtë:

Nr.	Operatori	Numri i ankesave	Ankesa të trajtuara	Burime të identifikuara
1	ALBtelecom	9	7	2
2	One Telecommunications	13	12	1
3	Vodafone Albania	1	1	1
4	Operatorë të tjerë	0	0	0
	TOTALI	23	20 ²¹	4

Proceset inspektuese në AKEP

Gjatë vitit 2021 strukturat inspektuese të AKEP, në përmbushje të objektivave të planit vjetor të inspektimit, kanë realizuar inspektimin e një pjese të subjekteve të komunikimeve publike sipas këtij planit vjetor.

1. Inspektim i Programuar

Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve elektronike, të cilët u programuan për inspektim nga struktura përgjegjëse në terren gjatë vitit 2021, u përzgjedhën duke u bazuar në këto kategori.

- Subjekte që nuk ishin inspektuar dy vitet e fundit, pra në vitet 2019 - 2020;
- Subjekte që kategorizohen me nivel risku të lartë.

Në planin e inspektimit për vitin 2021 si edhe gjatë vitit të kaluar, vijuan të përfshihen në procedurën inspektuese edhe Regjistrarët e Domain-eve.

Në këtë plan u përcaktua në detaje veprimtaria e inspektimit që do ndërmerrej gjatë vitit ushtrimor 2021 nga AKEP tek Regjistrarët e Domain-eve, tematikat kryesore si dhe kontrolli i ligjshmërisë në zbatimin

21 Tre prej ankesave janë zgjidhur nga vetë operatorët duke mos patur nevojë për ndjekje të interferencës nga AKEP

e përcaktimeve të rregullores nr. 2, datë 21.2.2008, "Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën .AL dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al".

Gjatë vitit 2021 janë kryer gjithsej:

- 62 inspektime të programuara tek sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike sipas regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm;
- 235 subjekte të inspektuara në distancë;
- 6 inspektime tek Regjistrarët e Domain-eve.

Gjatë vitit 2021, në përfundim të inspektimeve të programuara, krahas rekomandimeve të lëna apo edhe masave administrative kryesore ndaj subjekteve tek të cilat u konstatuan shkelje të kërkesave ligjore, u vendos edhe masa administrative "Gjobë", gjithsej 15 të tilla.

Është dhënë masa administrative "Paralajmërim" për një Regjistrar, dhe dënim plotësues në formën e rekomandimit për një Regjistrar tjetër.

1.2 Inspektim në distancë

Krahas inspektimeve të programuara në terren, struktura përgjegjëse inspektuese e AKEP, në zbatim të rregullores nr. 46, datë 27.10.2016, "Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike" realizoi dy inspektime në distancë, duke verifikuar në bashkëpunim me strukturat e tjera të AKEP të gjithë subjektet që operojnë në treg.

Për subjektet të cilat në përfundim të procedurës inspektuese i përmbushën detyrimet rregullatore ndaj AKEP, nuk u morën masa administrative pasi u vlerësua situata jo e zakonshme me të cilën është përballur i gjithë vendi për shkak të pandemisë së Covid 19. Këtu u mor parasysh edhe shfaqja e vullnetit pozitiv të subjektit për përmbushjen e detyrimeve.

Në përfundim të procedurës inspektuese:

- për subjektet (kur shkelja konstatohet për herë të parë) janë dhënë dënime administrative plotësuese në formën e rekomandimeve, me qëllim përmbushjen e detyrimeve rregullatore në mënyrë të menjëhershme.
- për subjektet të cilat edhe në përfundim të procedurës inspektuese nuk i përmbushën detyrimet rregullatore ndaj AKEP, u mor masa administrative kryesore "Gjobë" (në rastet kur subjekti ishte përsëritës në shkeljen e konstatuar), si dhe "Paralajmërim" (kur shkelja konstatohet për herë të parë), shoqëruar me vendimin plotësues të përmbushjes së detyrimeve rregullatore në mënyrë të menjëhershme.
- për subjektet të cilat edhe në përfundim të procedurës inspektuese nuk i përmbushën detyrimet rregullatore ndaj AKEP, dhe referuar statistikave rezultojnë përsëritës në shkeljen e konstatuar,

të proceduar më parë edhe me dënime administrative kryesore ("Gjobë"), Grupi inspektimit propozoi:

- heqjen e të drejtës së përdorimit të frekuencave/numeracionit;
- heqjen e të drejtës së ofrimit të shërbimeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike.
- për subjektet të cilat rezultojnë në QKB me status jo aktiv apo të pezulluar, që nuk kanë përmbushur detyrimet mbi pagimin e shumave ndaj AKEP, apo kanë kërkuar vetë të çregjistrohen nga regjistri i sipërmarrësve, u rekomandua të procedohej menjëherë me çregjistrimin e tyre nga regjistri i përgjithshëm i sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, me marrjen e vendimit për përfundimin e Autorizimit Individual apo anulimin e caktimit të numeracionit.

Inspektimi lidhur me Portabilitetin e numrit

Gjatë vitit 2021 janë portuar:

121,331 numra për shërbimin celular ndërmjet të tre operatorëve celularë,
880 numra për shërbimin telefonik fiks.

Në AKEP janë paraqitur 1,903 ankesa nga pajtimtarët në lidhje me refuzimin e kërkesave për portim nga operatorët dhënës si dhe arsyet e paraqitura për mospërfundim të procesit të portimit.

Në lidhje me refuzimet e kërkesave për portim, arsyeja kryesore për pajtimtarët me parapagim ka qenë mospërputhja e të dhënave të pajtimtarëve (ID), ndërsa për pajtimtarët me kontratë/ paspagim arsyet kryesore të refuzimit të kërkesave për portim kanë qenë detyrimet e pashlyera apo penalitete të ndryshme referuar kushteve kontraktuale.

Duke marrë në konsideratë numrin e ankesave dhe problematikat e adresuara prej qytetarëve si dhe duke analizuar shifrat e rritura të kërkesave për portim, AKEP realizoi gjatë muajve të parë të vitit 2021 një proces inspektimi tek të tre operatorët.

Me Autorizimin e Inspektimit datë 23.12.2020 është urdhëruar kryerja e inspektimit tek të tre sipërmarrësit me tematikë si më poshtë:

- a. Verifikimi i zbatimit të Rregullores Nr. 43 "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit", Miratuar me VKD nr. 2689, datë 22.09.2016 (Ndryshuar me VKD nr.35, datë 15.05.2018);
- b. Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve nga inspektimi i mëparshëm (viti 2018).

Grupi i Inspektimit (GI) pasi ka administruar dokumentacionin e kërkuar sipas tematikës së përcaktuar në Autorizimin e Inspektimit, si dhe pasi ka inspektuar subjektin në vendin e ushtrimit të veprimtarisë,

analizoi raste të ndryshme të kërkesave për portim numri me qëllim verifikimin e procedurës së ndjekur si dhe kohën e përgjigjes dhe aktivizimit nga ana e operatorit dhënës, në përfundim të të cilave u konstatuan shkelje të përcaktimeve të Rregullores nr. 43 datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, tek të tre sipërmarrësit.

GI ka klasifikuar shkeljet si kundërvajtje administrative, për të cilat parashikohet në bazë të nenin 137, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masë administrative kryesore “Gjobë”.

Ndaj të tre subjekteve të inspektuar u mor masa kryesore administrative “gjobë”, si dhe dënim administrativ plotësues në formën e rekomandimeve si dhe korrigjim të shkeljeve të konstatuara brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Konkretisht ndaj sipërmarrësit të komunikimeve elektronike Albtelecom sh.a., për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore, në mbështetje të paragrafit VII, të nenit 137, të ligjit nr. Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, u vendos masa administrative gjobë në vlerën 300,000 (treqind mijë) lekë si dhe dënime plotësuese në formën e rekomandimeve. Kjo masë administrative është ekzekutuar në mënyrë vullnetare nga sipërmarrësi.

-
- a. *Sipërmarrësi “Albtelecom” sh.a., rekomandohet të kryejë analizimin dhe zgjidhjen e shkaqeve që kanë çuar në shkeljen e përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të procesit të portabilitetit të numrit, duke zgjatur procedurën në mënyre të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht.*
 - b. *Sipërmarrësi “Albtelecom” sh.a., rekomandohet të kryejë përditësimin e të dhënave që administrohen në databazën e tij. në mënyrë të veçantë përditësimin e të dhënave të abonentëve të regjistruar me pasaporta të vjetra apo me certifikatë, të cilat nuk e përmbajnë ID Numrin Personal të abonentit.*
 - c. *Sipërmarrësi “Albtelecom” sh.a., rekomandohet të kryejë kontroll/audit periodik të brendshëm, për të evidentuar dhe korrigjuar rastet e refuzimeve për mospërputhje ID të pajtimtarit, si pasojë e gabimeve njerëzore të hedhjes së të dhënave në databazën përkatëse (CRM).*
 - d. *Sipërmarrësi “Albtelecom” sh.a., rekomandohet të zhvillojë intensivisht trajnime me stafin e pikave të shitjeve për procedurat e ngritjes së kërkesave për bartjen e numrit si dhe për çdo ndryshim në rregullore dhe detyrimet që rrjedhin nga këto ndryshime.*
 - e. *Sipërmarrësi “Albtelecom” sh.a., të zbatojë menjëherë detyrimet mbi limitin kohor të përgjigjes për bartje T1 (pika 6 e Nenit 18 të Rregullores Nr. 43, Datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”).*
 - f. *Sipërmarrësi “Albtelecom” sh.a., të zbatojë menjëherë detyrimet në lidhje me përgjigje për bartje, në lidhje me % e rasteve të refuzuara dhe pranuara (pika 5 e nenit 18 të Rregullores Nr. 43 Datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”).*

- g. Sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a., duhet të kryejë korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojave të tyre brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar të inspektimit.
-

Ndaj sipërmarrësit të komunikimeve elektronike One Telecommunications sha, u vendos masa administrative gjobë në vlerën 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë si dhe dënime plotësuese në formën e rekomandimeve. Masa administrative gjobë është ankimuar gjyqësisht dhe vijon procedura e shqyrtimit nga gjykata administrative e apelit.

.....

- a. Sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., rekomandohet të kryejë analizimin dhe zgjidhjen e shkaqeve që kanë çuar në shkeljen e përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të procesit të portabilitetit të numrit, duke zgjatur procedurën në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht.
- b. Sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., rekomandohet të kryejë përditësimin e të dhënave që administrohen në databazën e tij në mënyrë të veçantë përditësimin e të dhënave të abonentëve të regjistruar me pasaporta të vjetra apo me certifikatë, të cilat nuk e përmbajnë ID Numrin Personal të abonentit.
- c. Sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., rekomandohet të kryejë vetëkontroll periodik të brendshëm, për të evidentuar dhe korrigjuar rastet e refuzimeve për mospërputhje ID të pajtimtarit, si pasojë e gabimeve njerëzore të hedhjes së të dhënave në data bazën përkatëse (CRM).
- d. Sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., rekomandohet të zhvillojë intensivisht trajnime me stafin e pikave të shitjeve për procedurat e ngritjes së kërkesave për bartjen e numrit si dhe për çdo ndryshim në rregullore dhe detyrimet që rrjedhin nga këto ndryshime.
- e. Sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., rekomandohet të ndalojë menjëherë praktikën tregtare çorientuese dhe agresive, që ndikojnë në procesin e portimit dhe mund të rezultojnë në oferta të individualizuara në kundërshtim me aktet rregullatore përkatëse.
- f. Sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., të zbatojë menjëherë detyrimet mbi limitin kohor të përgjigjes për bartje T1 (pika 6 e Nenit 18 të Rregullores Nr. 43 Datë 22.09.2016 "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit").
- g. Sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., rekomandohet të zbatojë menjëherë detyrimet në lidhje me përgjigje për bartje, në lidhje me % e rasteve të refuzuara dhe të pranuara (pika 5 e nenit 18 të Rregullores Nr. 43 Datë 22.09.2016 "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit").
- h. Sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., rekomandohet se duhet të zbatojë sipas legjislacionit në fuqi, formën, afatet dhe procedurën e ankesave që lidhen me procesin e portimit.

- i. Sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., duhet të kryejë korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojave të tyre brenda 60 (gjashtë dhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar të inspektimit.

.....

Ndaj sipërmarrësit të komunikimeve elektronike "Vodafone Albania" sha, u vendos masa administrative gjombë në vlerën 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë si dhe dënime plotësuese në formën e rekomandimeve.

Kjo masë administrative është ekzekutuar në mënyre vullnetare nga sipërmarrësi.

- a. Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., rekomandohet të kryejë analizimin dhe zgjidhjen e shkaqeve që kanë çuar në shkeljen e përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të procesit të portabilitetit të numrit, duke zgjatur procedurën në mënyre të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht.
- b. Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., rekomandohet të kryejë përditësimin e të dhënave që administrohen në databazën e tij në mënyrë të veçantë përditësimin e të dhënave të abonentëve të regjistruar me pasaporta të vjetra apo me certifikatë, të cilat nuk e përmbajnë ID Numrin Personal të abonentit.
- c. Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., rekomandohet të kryejë vetëkontroll periodik të brendshëm, për të evidentuar dhe korrigjuar rastet e refuzimeve për mospërputhje ID të pajtimtarit, si pasojë e gabimeve njerëzore të hedhjes së të dhënave në databazën përkatëse (CRM).
- d. Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., rekomandohet të zhvillojë intensivisht trajnime me stafin e pikave të shitjeve për procedurat e ngritjes së kërkesave për bartjen e numrit si dhe për çdo ndryshim në rregullore dhe detyrimet që rrjedhin nga këto ndryshime.
- e. Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., rekomandohet të ndalojë menjëherë praktikën tregtare çorientuese dhe agresive që ndikojnë në procesin e portimit dhe mund të rezultojnë në oferta të individualizuara në kundërshtim me aktet rregullatorë përkatëse.
- f. Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., të zbatojë menjëherë detyrimet mbi limitin kohor të përgjigjes për bartje T1 (pika 6 e Nenit 18 të Rregullores Nr. 43 Datë 22.09.2016 "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit").
- g. Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., rekomandohet të zbatojë menjëherë detyrimet në lidhje me përgjigje për bartje, në lidhje me % e rasteve të refuzuara dhe pranuar (pika 5 e nenit 18 të Rregullores Nr. 43 Datë 22.09.2016 "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit").
- h. Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., duhet të kryejë korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojave të tyre brenda 60 (gjashtë dhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar të inspektimit.

Strukturat inspektuese të AKEP vijuan monitorimin dhe kontrollin mbi plotësimin e detyrave të lëna ndaj sipërmarrësve të mësipërm.

Në zbatim edhe të Planit Vjetor të Inspektimit për vitin 2021, si dhe në referencë të problematikave të konstatuara nga inspektimi i mëparshëm me qëllim verifikimin e përmbushjes së rekomandimeve të lëna, AKEP gjatë fundit të vitit 2021 realizoi edhe njëherë inspektimin e tre sipërmarrësve të mëdhenj, me ndikim në treg.

Objekti i inspektimit ishte verifikimi i zbatimit të Rregullores Nr. 43 "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit", si dhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm.

One Telecommunications sh.a

Në bazë të dokumentacionit të administruar gjatë procedurës inspektuese, dhe materializuar në procesverbalin e inspektimit datë 21.12.2021, Grupi Inspektimit (G.I) konstatoi se subjekti i inspektimit ka shfaqur vullnet pozitiv në përmbushjen e detyrime dhe rekomandimeve të lëna nga strukturat e AKEP në inspektimin e mëparshëm .

Sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., është urdhëruar:

1. *Të vijojë fushatën me qëllim përditësimin e të dhënave për pajtimtarët në mënyrë të veçantë përditësimin e të dhënave të abonentëve të regjistruar me pasaporta të vjetra apo me certifikatë, të cilat nuk e përmbajnë ID Numrin Personal të abonentit.*
2. *Të vijojë kryerjen e kontrolleve/audit periodik të brendshëm, për të evidentuar dhe korrigjuar rastet e refuzimeve për mospërputhje ID të pajtimtarit, si pasojë e gabimeve njerëzore të punonjësve të tij gjatë hedhjes / regjistrimit të të dhënave në databazën përkatëse (CRM).*
3. *Të vijojë kryerjen e trajnimeve me stafin e pikave të shitjeve për procedurat e ngritjes së kërkesave për bartjen e numrit, si dhe për çdo ndryshim në rregullore dhe detyrimet që rrjedhin nga këto ndryshime.*
4. *Sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., të vijojë dorëzimin e raportimeve periodike mujore (çdo datë 30 të muajit), deri në përmbushjen e afatit përfundimtar, duke përcaktuar se çfarë progresi është bërë përsa i përket zbatimit të detyrave për korrigjimin e shkeljeve.*
5. *Gjithashtu rekomandohet që sipërmarrësi "One Telecommunications" sh.a., në rolin e Operatorit Marrës të kryejë kërkesa të individualizuara për çdo rast portimi.*

Albtelecom sh.a

Në bazë të dokumentacionit të administruar gjatë procedurës inspektuese, dhe materializuar në procesverbalin e inspektimit, datë 21.12.2021, G.I konstatoi se subjekti i inspektimit ka shfaqur vullnet pozitiv në përmbushjen e detyrime dhe rekomandimeve të lëna nga strukturat e AKEP, përgjatë inspektimeve të mëparshme.

Sipërmarrësi "Albtelecom" sh.a., është urdhëruar:

1. *Të vijojë fushatën me qëllim përditësimin e të dhënave për pajtimtarët në mënyrë të veçantë përditësimin e të dhënave të abonentëve të regjistruar me pasaporta të vjetra apo me certifikatë, të cilat nuk e përmbajnë ID Numrin Personal të abonentit.*
2. *Të vijojë kryerjen e kontrolleve/audit periodik të brendshëm, për të evidentuar dhe korrigjuar rastet e refuzimeve për mospërputhje ID të pajtimtarit, si pasojë e gabimeve njerëzore të punonjësve të tij gjatë hedhjes / regjistrimit të të dhënave në databazën përkatëse (CRM).*
3. *Të vijojë kryerjen e trajnimeve me stafin e pikave të shitjeve për procedurat e ngritjes së kërkesave për bartjen e numrit, si dhe për çdo ndryshim në rregullore dhe detyrimet që rrjedhin nga këto ndryshime.*
4. *Të vijojë dorëzimin e raportimeve periodike mujore (çdo datë 30 të muajit), deri në përmbushjen e afatit përfundimtar, duke përcaktuar se çfarë progresi është bërë përse i përket zbatimit të detyrave për korrigjimin e shkeljeve.*

Vodafone Albania sh.a

Në bazë të dokumentacionit të administruar gjatë procedurës inspektuese, G.I. konstatoi se në veprimtarinë e sipërmarrësit objekt inspektimi rezultojnë shkelje të përcaktimeve të Rregullores Nr.43, datë 22.09.2016 "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit".

Gjithashtu GI, pasi ka administruar dokumentacionin ka konstatuar se sipërmarrësi nuk ka korrigjuar plotësisht rekomandimet e lëna nga inspektimi i mëparshëm i kryer në harkun kohor 2020-2021.

GI në respektim të afateve kohore ka vijuar me marrjen e Vendimit Përfundimtar të Inspektimit në datë 19.01.2022.

Sipërmarrësi bazuar në nenit 136 të ligjit Nr.9918/2008, ka paraqitur ankim administrativ pranë Këshillit Drejtues të AKEP, lidhur me Vendimin Përfundimtar të Inspektimit. Brenda afateve ligjore KD i AKEP, edhe pas zhvillimit të seancës dëgjimore, ka lënë në fuqi vendim përfundimtar të inspektimit.

Ndaj sipërmarrësit të komunikimeve elektronike "Vodafone Albania" Sh.a., për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore, në mbështetje të nenit 137, të ligjit nr. Nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, u vendos masa administrative gjobë në vlerën 2,000,000 (dy milionë) lekë si dhe dënime plotësuese në formën e rekomandimeve.

Masa administrative është ekzekutuar në mënyrë vullnetare nga sipërmarrësi si dhe ndërkohë është ushtruar e drejta e ankimimit në gjykatën administrative të shkallës së parë.

Kundrejt sipërmarrësit janë lënë rekomandimet si më poshtë:

1. *Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., rekomandohet të realizojë menjëherë përditësimin e të dhënave të pajtimtarëve të tij përfshirë këtu edhe numrat e Policisë së Shtetit duke mos penguar procesin e portabilitetit.*
2. *Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., rekomandohet të vijojë fushatën me qëllim përditësimin e të dhënave për pajtimtarët në mënyrë të veçantë përditësimin e të dhënave të abonentëve të regjistruar me pasaporta të vjetra apo me certifikatë, të cilat nuk e përmbajnë ID Numrin Personal të abonentit.*
3. *Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., rekomandohet të vijojë kryerjen e kontrolleve/audit periodik të brendshëm, për të evidentuar dhe korrigjuar rastet e refuzimeve për mospërputhje ID të pajtimtarit, si pasojë e gabimeve njerëzore të punonjësve të tij gjatë të hedhjes / regjistrimit të të dhënave në databazën përkatëse (CRM).*
4. *Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., rekomandohet të vijojë kryerjen e trajnimeve me stafin e pikave të shitjeve për procedurat e ngritjes së kërkesave për bartjen e numrit si dhe për çdo ndryshim në rregullore dhe detyrimet që rrjedhin nga këto ndryshime.*
5. *Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., duhet të kryejë korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojave të tyre brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga vendimi përfundimtar i inspektimit.*
6. *Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., duhet të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar më sipër dhe të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.*
7. *Sipërmarrësi "Vodafone Albania" sh.a., të vijojë dorëzimin e raportimeve periodike mujore (çdo datë 30 të muajit), deri në përbushjen e afatit përfundimtar, duke përcaktuar se çfarë progresi është bërë përsa i përket zbatimit të detyrave për korrigjimin e shkeljeve.*

AKEP monitoron në vijimësi dhe përgatit raporte periodike me të dhënat statistikore të gjeneruara nga sistemi CRDB mbi performancën e operatorëve në lidhje me zbatimin e afateve dhe rregullave të portimit.

2. Perspektiva strategjike e rrjeteve dhe teknologjive të brezit të ri: vlerësimi kombëtar për ardhmërinë e 5G në Shqipëri

2.1 Procesi i konsultimit ndërkombëtar dhe këshillimi me sipërmarrësit e sektorit

Një nga detyrat e caktuara nga Kuvendi i Shqipërisë në rezolutën e AKEP për vitin 2021 ishte kryerja e një vlerësimi afatgjatë brenda vitit 2021 të parametrave, kapaciteteve dhe strategjive për implementimin e rrjeteve dhe teknologjive të brezit të ri (5G).

AKEP, në cilësinë e organit të vetëm rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, në përputhje me objektivat rregullatorë të përcaktuar në ligjin nr. 9918/2008, në përmbushje të detyrës së Kuvendit dhe të kuadrit ligjor e nënligjor, ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik në lidhje me marrjen e një konsulence për kryerjen e një studimi/analize të thelluar për teknologjitë e reja të *mobile broadband* në Shqipëri.



Figura 6: Kryetari i AKEP, Z. Tomi Frashëri, së bashku me Gjeneralin James L. Jones pas dorëzimit të dokumentit mbi rrjetet dhe teknologjitë e brezit të ri në Shqipëri

Burimi: Fotografia AKEP 2022

Në përfundim të kësaj procedure prokurimi në muajin prill 2021, AKEP ka nënshkruar kontratën me operatorin ekonomik fitues, bashkimin e operatorëve "Jones Group International" & "Dynology Corporation" (JGI&DC), shoqëri amerikane me eksperiencë të gjatë në fushat e sigurisë kombëtare, çështjeve ndërkombëtare dhe politikave të jashtme, sigurisë kibernetike dhe zhvillimeve teknologjike. Vlen të nënvizohet se së fundmi, kjo shoqëri ka filluar bashkëpunimin me qeverinë shqiptare, duke nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Këshillin e Ministrave për forcimin e sigurisë kibernetike të infrastrukturës kritike për Shqipërinë.

Gjatë bashkëpunimit me AKEP dhe gjatë fazës së hartimit të dokumentit janë zhvilluar 12 workshop-e dhe takime midis konsulentit, specialistëve të AKEP dhe operatorëve celularë, ku janë diskutuar çështje të rëndësishme për të cilat u morën në konsideratë edhe pikëpamjet, mendimet dhe sugjerimet e operatorëve.

Në përmbushje të detyrimeve të kontratës së konsulencës, konsulenti fillimisht ka hartuar dokumentin "Plani Strategjik për teknologjitë 5G në Shqipëri", cili i është paraqitur Këshillit Drejtues të AKEP.

AKEP, me vendim të Këshillit Drejtues nr.19, datë 4.11.2021, ka miratuar fillimin e procesit të këshillimit publik të dokumentit "Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri", për një periudhë 30 ditore, duke e publikuar edhe në faqen web të AKEP. Dokumenti i është dërguar edhe palëve të interesit për të mbledhur mendime, sugjerime si dhe komente nga ana e tyre.

Gjatë fazës së këshillimit publik kanë dhënë mendime, vlerësime e sugjerime të tre operatorët celularë si edhe MIE. Sa më sipër janë vlerësuar dhe i janë përcjellë konsulentit për hartimin e dokumentit final.

Ndër të tjera ky dokument përfshin edhe procesin për dhënien e të drejtave të përdorimit sa më objektiv dhe sa më transparent, për përfitimin e konsumatorëve dhe ekonomisë shqiptare, krijimin e një tregu konkurrues në Shqipëri, si dhe përdorimin efektiv të spektrit të frekuencave, në përmbushje të objektivave rregullatorë.

Studimi dhe vlerësimi kombëtar i ndërmarrë nga AKEP është në përputhje me disa nga politikave të Qeverisë Shqiptare, siç janë:

- Programi shumëvjeçar për politikën spektrale;
- Plani kombëtar për zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës digjitale *broadband*;
- Marrëveshja e mirëkuptimit të lidhur midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Amerikane, për çështjet e sigurisë së rrjeteve 4G/5G.

Studimi vjen në kohën e duhur dhe shërben si udhërrëfyes/shtrat provë (test bed), për AKEP, për Ministrinë e përfshira në proces, për vetë Qeverinë Shqiptare, si edhe për operatorët celularë.

Në përfundim të afatit të konsultimit publik, AKEP ka zhvilluar takime individuale me secilin operator celular dhe konsulentin, duke trajtuar në detaje komentet dhe qëndrimin e tyre për dokumentin e konsultimit publik.

Në fund të muajit dhjetor 2021, konsulenti ka paraqitur dokumentin final, i cili është miratuar nga Këshilli Drejtues i AKEP në datën 31.03.2022, me vendimin nr.7.²²

2.2 4 Fokuset e reflektimit strategjik për një politikë zhvillimore koherente të sektorit

Dokumenti “Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri” përmban katër fusha kryesore fokusimi:

Si Fokus i Parë, është paraqitur nevoja për lehtësimin e procedurave të Tenderit ose të Ankandit të Spektrit 5G të Shqipërisë. Konsulenti ka paraqitur disa shembuj dhe disa mënyra të lehtësimit të procedurave dhe afateve të tenderimit/ankandeve, në mënyrë që të zvogëlohet koha mesatare e dhënies së autorizimeve për frekuencat 5G. Sipas analizës së kryer, kjo do të ishte edhe në interes të vendit, por edhe të operatorëve celularë, në mënyrë që operatorët të kenë kohën e nevojshme, të sigurojnë financimin e investimeve të nevojshme, për të përmirësuar/përgatitur infrastrukturën e telekomunikacionit të Shqipërisë, për një zbatim të sigurt të 5G.

Si Fokus i Dytë, janë paraqitur rekomandime për veprime legjislative të cilat duhen ndërmarrë për të mbështetur përhapjen e rrjeteve 5G. Theksi kryesisht vihet tek planifikimi dhe zbatimi i teknologjisë së re 5G, gjë që kërkon strategji të reja operative për Qeverinë dhe industrinë e telekomit, rregullore dhe mjete të reja për monitorimin e performancës, matjen e suksesit dhe një proces transparent, që inkurajon investimet për të ardhmen. Konsulenti rekomandon që ligjet, rregulloret dhe proceset e tjera administrative, duhet të rishikohen, për të mbështetur qëllimin e një implementimi të suksesshëm të 5G, në të gjithë Shqipërinë. Konsulenti ka paraqitur edhe disa rekomandime konkrete për veprimet legjislative që duhen ndërmarrë për lehtësimin e përhapjes së rrjeteve 5G.

Si Fokus të Tretë, konsulenti paraqet nevojën e promovimit të rrjeteve 5G, në dy prioritet kryesore:

1. vëzhgimet dhe rekomandimet e operatorëve kur ata konsiderojnë të bëjnë investime në 5G;
2. roli që duhet të luajë Qeveria në inkurajimin e këtyre investimeve dhe në informimin e publikut në lidhje me përfitimet e 5G, përmes një fushate ndërgjegjëse.

Si Fokus të Katërt, konsulenti paraqet nevojën e vlerësimit dhe adresimit të disa rreziqeve dhe disa konsiderata të tjera siç janë:

- rezultatet e ankandit të spektrit jo të plota ose jo të kënaqshme;
- disponueshmëria e sistemeve/komponentëve ose zinxhirëve të besuar të furnizimit me pajisje të rrjeteve 5G;
- dobësitë në rrjetet 5G nga furnizuesit e rrjeteve jo të besueshëm;
- kufizimet financiare apo teknike të operatorëve për të zbatuar 5G, etj.

22 Dokumenti i detajuar dhe VKD ndodhen në linkun: <https://akep.al/vendime-te-keshillit-drejtues/>

2.3 Rekomandimet për vënien në eficiencë të plotë të brezave relevantë të frekuencave

Dokumenti “Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri”, ka përshkruar vlerat dhe përfitimet nga 5G, ku disa prej tyre janë:

- Përfitimet e konsiderueshme ekonomike;
- Qeverisje Digjitale për shërbimet publike, përfshirë arsimin, shëndetësinë, menaxhimin e objekteve qeveritare, mbrojtjen, nismat e qytetit inteligjent (smart cities);
- Përfitimet në fushën e shëndetit dhe të mjekësisë;
- Përfitimet në fusha të ndryshme të industrisë dhe bujqësisë;
- Përfitimet në transportin publik;

Dokumenti përmban disa rekomandime shumë të rëndësishme të tilla si:

- Strukturimin e caktimit të brezave të frekuencave për teknologjinë 5G në funksion të zhdërvjelltësimit të konkurrencës.
- Zbatimin e një procesi për dhënie të drejtash përdorimi sa më objektiv dhe transparent, në përfitim të konsumatorëve shqiptarë, ekonomisë shqiptare dhe me qëllim krijimin e një tregu gjithmonë e më konkurrues në Shqipëri.
- Vlerësimin e efikasitetit të përdorimit aktual të spektrit për të identifikuar sesi përdoret aktualisht spektri.
- Promovimin e teknologjive të reja që ndikojnë në përdorimin eficient të brezit.
- Dhënien e zgjidhjeve në favor të tregut nëpërmjet mekanizmave të duhura të alokimit të spektrit.

Ky plan sjell edhe disa ide të reja novative në aspektin e trajtimit të spektrit të rrjeteve të reja 5G, mënyrën e trajtimit të teknologjive 2G dhe 3G, lejinin e përdorimit të teknologjive bashkëkohore në mënyrë të kombinuar (OpenRAN), nevojën e krijimit të një laboratorit kombëtar të telekomit për certifikimin e pajisjeve të telekomunikacioneve, aplikimin e “network slicing” ku e njëjta sasi spektri mund të përdoret në zona të ndryshme, konceptin e lejitimit të përdorimit të një sasi spektri për rrjete private 5G, adresimin e çështjeve të sigurisë së rrjeteve 4G/5G, etj.

2.4 Pasqyrë e përmbledhur e rezultateve të vlerësimit kombëtar për ardhmërinë e rrjeteve dhe teknologjive 5G në Shqipëri

Studimi i shoqëruar nga vlerësimi kombëtar mbart disa përfundime me interes të veçantë për sektorin të cilat përmbledhen si vijon:


- Zhvillimi i ri i teknologjisë 5G në Shqipëri do të kapërcejë aftësitë ekzistuese të rrjeteve wireless për të zhvilluar shërbimet e komunikimit të disponueshme nga kudo, në çdo kohë, dhe në nivele dukshëm më të shpejta të të dhënave që pritet të jenë të përhapura globalisht dhe zhvillimi i tij do të përafrohet me nevojat e tregut.
- Rrjetet 5G do të mundësojnë zgjerimin e Qeverisjes Digjitale për shërbimet publike, përfshirë arsimin, menaxhimin e objekteve qeveritare, mbrojtjen, nismat e "Smart City" (Qytetit të Zgjuar) të pushtetit vendor, etj.
- Implementimi i teknologjive 5G do të sjellë përfitime të konsiderueshme ekonomike për vendin.
- Rrjetet 5G do të sjellin përfitime në fushën e shëndetit dhe mjekësisë, në fusha të ndryshme të industrisë dhe bujqësisë, në transportin publik e shumë fusha të tjera. 5G do të sjellë përmirësime të rëndësishme në realitetin virtual, realitetin e shtuar dhe inteligjencën artificiale, duke krijuar mundësi për të lidhur njerëzit shumë përtej asaj që lejon teknologjia aktuale telefonike.
- Shpejtësitë e komunikimit në rrjetet 5G do të jenë shumë më të larta se shpejtësitë në rrjetet aktuale. Kjo do të thotë akses më i shpejtë i popullatës në internet, në sisteme dhe platforma teknologjike shtetërore apo private, si dhe shërbim më i mirë dhe më cilësor për përdoruesit e rrjeteve 5G.
- Spektri i frekuencave të rrjeteve 5G ofron mundësinë e një mbulimi me sinjal më të mirë të territorit dhe popullsisë, gjë që do të sjellë shërbim më cilësor nga këto rrjete.
- Për herë të parë do të krijohet mundësia e implementimit të rrjeteve private 5G, pra rrjete vetëm për përdorim privat nga kompani të ndryshme, por jo për përdorim nga publiku i gjerë. Kjo, sepse një pjesë e spektrit 5G, do të dedikohet për këto rrjete private. Kjo do të jetë një ndihmë e madhe për industrinë, bujqësinë, turizmin, etj.

Studimi jep rekomandime për trajtimin dhe adresimin sa më të saktë të shumë çështjeve që lidhen me rrjetet 5G, të tilla si:

- Mënyrën e trajtimit të spektrit të frekuencave 5G;
- Çështjet teknike dhe teknologjike të rrjeteve 5G;
- Nevojën për sigurinë e rrjeteve 5G;
- Promovimin e 5G përmes fushatave sqaruese dhe ndërgjegjësuere, etj;
- Nevojën e ndryshimeve në legjislacionin parësor dhe rregullator, ndër të cilat përfshihet edhe lehtësimi i procesit të tenderimit/ankandit;
- Nevojën e përcaktimit të kriterëve për furnizuesit e besueshëm të teknologjive 5G;
- Promovimi i ndërgjegjësimit dhe mundësive për përfitimet e 5G;
- Nevoja e Fushatave të Marketingut dhe Reklamimi Mbarëkombëtar;
- Krijimi i një Laboratori Kombëtar të Telekomit;
- Nevoja e një Rrjeti Kombëtar të Infrastrukturës Optike Giga-Backhaul (NBON) dhe domosdoshmëria e vendosjes së instalimeve kabllore, gjatë ndërtimit ose rindërtimit të rrugëve;

- Krijimi i mundësive për një treg të larmishëm dhe të besueshëm të furnizimit të telekomit;
- Zhvillimi i Kriteve për Furnizuesit e Besuar (Trusted Vendors);
- Aplikimi i Open RAN (vendorë të shumtë) për të nxitur konkurrencën, inovacionin dhe diversitetin e prodhuesve teknologjikë të rrjeteve celulare;
- Ekspozimi i njerëzve ndaj fushave elektromagnetike të radiofrekuencave etj.





III

BASHKËPUNIMI INSTITUCIONAL
NË NIVEL KOMBËTAR, RAJONAL
DHE EVROPIAN



Figura 7-8 Kryetari i AKEP, Z. Tomi Frashëri, në takim me drejtuesve të autoriteteve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj dhe Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë, dhjetor 2021

Burimi: Fotografia kortezi e zyrës së shtypit të Kuvendit, 2021



1. Bashkëpunimi institucional në nivel kombëtar

1.1 Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Autoritetin e Mediave Audiovizive



Figura 9-10: Kryetari i AKEP, Z. Tomi Frashëri dhe Kryetarja e AMA, Znj. Armela Krasniqi dakordësojnë dhe nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy autoriteteve rregullatore në zbatim të detyrimeve të përbashkëta të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë

Burimi: Fotografitë AKEP dhe AMA, 2021

Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në datën 3.11.2021 nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit me qëllim garantimin dhe mbështetjen operacionale, teknike dhe ligjore në fushat me interes të përbashkët për të dyja palët.

Ky memorandum është shprehje e vullnetit të përbashkët të të dy institucioneve, për të diskutuar dhe adresuar të gjitha problematikat me të cilat hasen dy institucionet në funksion të interesit më të lartë publik.

Përmes këtij memorandumi, institucionet angazhohen të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e tij, në një mënyrë sa më të shpejtë dhe efikase, por edhe për realizimin sa më cilësor të qëllimit të tij.

Të dy institucionet do të bashkëpunojnë gjithashtu për:

- lirim e brezit 700 MHz (të ashtuquajtur DD2) nga AMA, dhe marrjen në administrim të këtij brezi nga AKEP, duke shkuar drejt respektimit të afateve të vendosura nga BE dhe ITU;
- ngritjen e një TASK-FORCE me përfaqësues të përbashkët nga të dy institucionet me qëllim luftën kundër paligjshmërisë në transmetimet pa të drejta autori përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe zhvillimin e veprimtarisë vetëm nga subjekte të licencuara/autorizuara nga autoritetet rregullatore;
- ngritjen e një grupi të përbashkët që do të ndjekë në vijueshmëri problemet e interferencave të shkaktuara nga subjekte, veprimtaria e të cilëve përfshihet në fushën e veprimit të këtyre institucioneve si dhe interferencave që raportohen nga autoritetet rregullatore të vendeve fqinje;
- krijimin e një inventari të unifikuar të frekuencave, bazuar në detyrimet ligjore të përcaktuara për të dy institucionet lidhur me "Miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit" si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të saj.

Pas nënshkrimit të memorandumit, të dy palët vijuan me ngritjen e një grupi të përbashkët pune, me ekspertë të sektorëve të monitormit të frekuencave të të dy institucioneve, të cilët do të ndjekin rregullisht problemet e interferencave që raportohen nga rregullatorët e vendeve fqinje, në zonat kufitare dhe jo vetëm, si dhe ngritjen e TASK-FORCËS me qëllim luftën kundër paligjshmërisë në transmetimet pa të drejta autori.

AMA dhe AKEP janë duke bashkëpunuar ndër të tjera edhe për lirim e brezit 700 MHz (të ashtuquajtur DD2) nga AMA dhe marrjen në administrim të këtij brezi nga AKEP, duke shkuar drejt respektimit të afateve të vendosura nga BE dhe ITU.

1.2 Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës

AKEP në vijimësi ka bashkëpunuar me Autoritetin e Konkurrencës duke e informuar AK lidhur me marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të këtij të fundit mbi adresimin e shqetësimeve për aplikimin e praktikave tregtare çorientuese dhe agresive.

Konkretisht, gjatë vitit 2021, AKEP ka përcjellë herë pas here informacione të plota mbi paketat dhe

tarifat e shërbimeve celulare të njoftuara nga operatorët celularë. Gjithashtu, ka informuar Autoritetin e Konkurrencës edhe mbi masat e ndërmarra nga AKEP për zgjidhjen e problematikave teknike në procedurën e portabilitetit të numrave, me qëllim sigurimin e konkurrencës efektive mes operatorëve në treg.

AKEP, si organ rregullator i pavarur në fushën e komunikimeve elektronike, ka ofruar dhe do të vazhdojë të ofrojë bashkëpunimin e tij për çështjet e interesit të përbashkët, si edhe do të vijojë të ndjekë me prioritet këto çështje, me qëllim mbrojtjen e përdoruesve dhe konsumatorëve si edhe zhvillimin e një konkurrence të ndershme në tregun e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

AKEP në vijimësi monitoron dhe analizon sjelljen e ofruesve të shërbimeve celulare, mbi bazën e të cilave në përputhje edhe me praktikën ndërkombëtare ushtron detyrat e tij për analizat e tregjeve në nivel shumice, duke përcaktuar dhe shpallur operatorët me Fuqi të Ndjeshme në tregjet përkatëse dhe vendosur masa rregullatore proporcionale dhe jo-diskriminuese. Në këtë kuadër AKEP bashkëpunon edhe me Autoritetin e Konkurrencës për shmangien e sjelljeve antikonkurruese dhe marrjen e masave përkatëse rregullatore, në vijim të praktikave të mëparshme, si dhe Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve për këtë qëllim. AKEP i ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet në tregun e telefonisë celulare, veçanërisht njoftimet e planeve tarifore të ofruara në tregun e pakicës dhe ka informuar Autoritetin e Konkurrencës mbi çmimet dhe përmbajtjen e këtyre planeve, dhe në vijimësi ka informuar Autoritetin e Konkurrencës mbi marrjen e masave për zbatimin edhe të rekomandimeve të këtij të fundit mbi adresimin e shqetësimeve për aplikimin e praktikave tregtare çorientuese dhe agresive. Gjatë vitit 2021, janë zhvilluar korrespondenca zyrtare dhe përcjellë informacion mbi paketat dhe tarifat e shërbimeve celulare të njoftuara nga operatorët celularë, përfshirë edhe shkëmbimin e informacionit me Autoritetin e Konkurrencës mbi masat e ndërmarra nga AKEP për zgjidhjen e problematikave teknike në procedurën e portabilitetit të numrave, me qëllim sigurimin e konkurrencës efektive mes operatorëve në treg.

2. Perspektivat e bashkëpunimit me autoritetet rregullatore të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Maqedonisë së Veriut

AKEP gjatë vitit 2021 ka pasur një rritje të bashkëpunimit me Autoritetet Rregullatore të Republikës së Kosovës (ARKEP) dhe të Republikës së Maqedonisë së Veriut (AEK), në fushën e administrimit dhe alokimit të spektrit të frekuencave, koordinimeve ndërkufitare dhe zbatimin projekteve të përbashkëta ndërshtetërore.

Në një takim ndërministror dhe rregullator të zhvilluar në datën 28.10.2021, me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës dhe përfaqësues të MIE, është rënë dakord për një agjendë të përbashkët veprimesh për lehtësimin e krijimit të korridorit digjital 5G²³ si dhe lehtësimin e lëvizjes në të ardhmen, midis dy vendeve. Bashkëpunimi në këtë fushë bazohet në zhvillimet teknologjike bashkëkohore dhe në angazhimet e marra me miratimin e Planit Rajonal të Ballkanit Perëndimor, në deklaratën e përbashkët të Kryeministrave të Ballkanit Perëndimor, në Samitin e Sofjes më 17 maj 2018, si dhe në iniciativat e Bashkimit Evropian për “5G Corridors dhe Automated Driving Cars”. Bashkëpunimi midis dy rregullatorëve AKEP dhe ARKEP, synon hartimin e politikave dhe programeve të zhvillimit të rrjeteve 5G, në përcaktimin e standardeve për rrjete të sigurta dhe lëvizshmërinë, bazuar në praktikën e mira të BE dhe angazhimet ndërkombëtare për rrjetet e pastra.

AKEP dhe ARKEP kanë rënë dakord për një qasje të koordinuar dhe për harmonizimin e spektrit të frekuencave për 5G si dhe do të bashkëpunojnë në caktimin e brezave pionierë për 5G, sipas praktikave evropiane në fuqi.



Figura 11: Kryetarët e autoriteteve rregullatore të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, Tomi Frashëri, Jeton Akiku dhe Nazim Rahmani, në takimin plenar të BEREC në Dubrovnik të Kroacisë, shtator 2021

Burimi: Fotografia AKEP, 2021

23 Korridori digjital përfshin mbulimin me rrjet 5G të rrugës dhe autostradës Tiranë-Prishtinë.



Figura 12: Takim i përbashkët pune në Prishtinë mes përfaqësuesve të Ministrive përgjegjëse për komunikimet elektronike dhe të autoriteteve rregullatore shqiptare dhe kosovare
Burimi: Fotografia AKEP, 2021



Figura 13: Vizita zyrtare e Kryetarit të AEK, Z. Jeton Akiku, në Tiranë, maj 2021
Burimi: Fotografia AKEP, 2021

Gjatë vitit 2021, AKEP ka rritur gjithashtu bashkëpunimin me Autoritetin Rregullator të Republikës së Maqedonisë së Veriut (AEK) të kryesuar prej shkurtit 2021 nga Z. Jeton Akiku.

Në muajin maj të vitit 2021 është zhvilluar një takim zyrtar në Tiranë, me përfaqësues të dy autoriteteve, ku fokusi kryesor ishte trajtimi i brezave 5G në të dy shtetet, lirimi i brezit 700 MHz në Shqipëri, koha e alokimit të brezave 5G në të dy

shtetet, koordinimet ndërkufitare për shmangien e interferencave, rishikimi i marrëveshjeve aktuale dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të reja mes dy autoriteteve rregullatore.

Nënshkrimi i një Memorandumi të ri bashkëpunimi që për synim do të ketë koordinimin teknik dhe institucional afatgjatë mes dy autoriteteve rregullatore, është një nga pikësynimet strategjike të AKEP përgjatë vitit 2022.



Figura 14: Vizita zyrtare e përfaqësuesve të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Tiranë, maj 2021
Burimi: Fotografia AKEP, 2021

3. Pjesëmarrja e AKEP në përpunimin e instrumentave rregullatore në instancat evropiane (BEREC) dhe ndërkombëtare (ITU)



Informacion mbi veprimtarinë me BEREC gjatë vitit 2021

Gjatë vitit 2021, AKEP ka vijuar pjesëmarrjen aktive në nivelet më të larta përfaqësuese dhe teknike në gjirin e trupës europiane të rregullatorëve (BEREC) dhe është përfshirë gjithashtu në reflektimin global mbi të ardhmen e kësaj instance të rëndësishme koordinuese në planet në vijim. Përveç veprimit të bashkërenduar me RCC dhe Komisionin European për ta bërë BEREC gjithmonë e më shumë pjesë të procesit të reduktimit të tarifave roaming mes BE dhe BP, AKEP ka bashkëndarë me rregullatorët e tjerë, anëtarë të BEREC, vizonin dhe qasjet e tij posaçërisht mbi çështje si varësia digjitale, edukimi digjital dhe vetërregullimi i tregjeve.

Gjithashtu, AKEP militon në BEREC për një ndërgjegjësim në rritje në lidhje me nevojën për rrjete të pastra dhe një zinxhir solid, solidar dhe të besueshëm të ndërveprueshmërisë dhe sigurisë teknologjike në Europë.

Informacion mbi veprimtarinë e FRATEL gjatë vitit 2021

Gjatë vitit 2021 AKEP ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm me anëtarët e rrjetit Fratel.²⁴ Fratel synon të krijojë dhe forcojë bashkëpunimin dhe shkëmbimet ndërmjet anëtarëve të tij. Aktualisht rrjeti Fratel numëron 50 anëtarë, midis tyre edhe AKEP.



Figura 15: Pamje nga takimi i parë plenar me pjesëmarrje fizike i BEREC që prej fillimit të pandemisë COVID-19, në Dubrovnik të Kroacisë, shtator 2021
Burimi: Fotografia AKEP, 2021

Misioni i rrjetit është të promovojë shkëmbimin e informacionit, të kontribuojë, sa më shumë që të jetë

²⁴ Fratel është rrjeti rregullator i telekomunikacionit francez-folës. Rrjeti u krijua më 28 tetor 2003 në Bamako nga rregullatorët e telekomunikacionit që ndajnë gjuhën frënge. Krijimi i Fratel u vendos gjatë një simpoziumi të rregullatorëve frëngjisht-folës në takimin e mbajtur në Paris në qershor 2002.

e mundur, në trajnimin, koordinimin dhe bashkëpunimin teknik ndërmjet anëtarëve të tij, si dhe të kontribuojë në studimin e çdo çështjeje që lidhet me rregullimin e telekomunikacionit.

Përfaqësues të AKEP ishin pjesëmarrës në dy takime të organizuar nga rrjeti Fratel gjatë vitit 2021, takime të organizuara nga Autoriteti Rregullator për Telekomunikacionin dhe Postat i Senegalit (ARTP), të cilët kryesuan edhe presidencën e rrjetit Fratel për vitin 2021.

Në muajin korrik 2021 përfaqësues të AKEP ishin pjesë e seminarit të organizuar online me temë *«Shërbimi universal dhe akses, si t'i financoni, zbatoni dhe kontrolloni ato»*.

Në këtë seminar ishin rreth 170 pjesëmarrës, përfshirë 33 autoritete rregullatore që janë anëtare të rrjetit Fratel, por edhe institucione ndërkombëtare (ITU, Komisioni Evropian, OECD, UEMOA, AFD, Banka Botërore, BEI), ministri, shoqata të konsumatorëve, anëtarë nga bota akademike dhe përfaqësues të industrisë.

Në këtë seminar u trajtuan tema rreth kornizave legislative, burimeve të mundshme të financimit të shërbimit universal si dhe metodologjitë e kostos. Diskutimet u përqendruan edhe mbi procesin e përcaktimit të operatorëve të ngarkuar me shërbimin ose aksesin universal dhe metodat e kontrollit të detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

Seminari ishte edhe një mundësi për të prezantuar një raport progres nga anëtarët e rrjetit mbi mbulim celular si dhe cilësinë e këtij shërbimi për secilin vend përkatës.

Për më shumë informacion, prezantimet si dhe dokumentimi i seminarit janë për të interesuarit në faqen e internetit të Frate.²⁵

Në muajin nëntor 2021 përfaqësues të AKEP ndoqën në Dakar, Senegal, takimin me temë *«Shërbimi dhe akses universal: Një e përbashkët e aksesueshme për të gjithë»*.

Diskutimet në këtë takim u fokusuan rreth politikave publike për nxitjen dhe evolucionin e shërbimit universal, përfshirjen digjitale, bazuar në zhvillimet më të fundit teknologjike.

Me hapjen e tregut të komunikimeve elektronike, pas krizës së shëndetësisë të shkaktuar nga pandemia, disponueshmëria e shërbimeve të njohura si thelbësore mbetet një problem madhor, në nivelin e cilësisë së tyre, por edhe atë të normave financiare të përballueshme nga publiku i gjerë. Në vendet anëtare të rrjetit Fratel janë miratuar korniza rregullatore për të caktuar sipërmarrësit përgjegjës për përmbushjen e një shërbimi universal, për të përcaktuar kostot e këtij shërbimi si dhe financimin e mundshëm në rast të një ngarkese të tepruar për operatorë të caktuar.

Duke konsideruar si shumë të vlefshëm bashkëpunimin me të gjithë anëtarët e rrjetit, AKEP vlerëson se edhe në të ardhmen, pjesëmarrja në takimet e përbashkëta do të çojë në nivele më të larta shkëmbimin

25 <https://www.fratel.org/18e-seminaire-fratel-7-et-8-juillet-2021/>.

e informacionit, si dhe përvetësimin e praktikave më të mira në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

Informacion mbi veprimtarinë e ITU gjatë vitit 2021

Gjatë vitit 2021 ka vijuar bashkëpunimi me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), lidhur me pjesëmarrjen në aktivitetet e organizuara nga ITU si dhe dhënia e kontributit për plotësimin ose përditësimin e pyetësorëve dhe publikimeve të ndryshme, ku ndër më kryesoret mund të përmendim:



Figura 16: Pjesëmarrësit në takimin e 19-të plenar të rrejtit të autoriteteve rregullatore frankofone (FRATEL) në Dakar, Senegal, nëntor 2021
Burimi: Fotografia kortezi e FRATEL

AKEP në koordinim dhe bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ka përditësuar të dhënat për Shqipërinë në :

- Plotësimin e pyetësorit *“Regional Assessment on Electromagnetic field (EMF) levels and risk communication challenges in the Europe Region”*;
- Plotësimin e *“BACKGROUND PAPER - Broadband Mapping Systems in Europe and Regional Harmonization Initiatives”*;

Kryetari i AKEP Z.Frashëri ka marrë pjesë në forumin e organizuar nga ITU dhe Ekip (rregullatori i Republikës së Malit të Zi) me temë : *“Regional Regulatory Forum for Europe on “Universal Connectivity for*



Figura 17-18: Forumi i organizuar nga ITU dhe EKIP (rregullatori i Republikës së Malit të Zi) me temë: "Regional Regulatory Forum for Europe on "Universal Connectivity for a Post-Pandemic Digital Europe"

Burimi: AKEP

a Post-Pandemic Digital Europe".

Forum i mbajtur në formatin online në datat 27 dhe 28 shtator 2021, në kuadrin e Iniciativës Rajonale të ITU-së për Evropën dhe zhvillimin e infrastrukturës broadband.

Forum i ofroi një mundësi unike për dialog të nivelit të lartë midis palëve të interesuara mbi strategjitë dhe politikat e drejtuara drejt zhvillimit të broadband në rajon, duke i kushtuar vëmendje të veçantë tregjeve fikse dhe celulare si dhe mjeteve në dispozicion të Autoriteteve Kombëtare Rregulatore për të siguruar rezultate efektive konkrete. Diskutimet u mbajtën duke pasur parasysh edhe situatën e veçantë

të krijuar nga COVID-19 dhe skenarët e pas-pandemisë dhe rimëkëmbjes.

Në këtë Forum virtual morën pjesë përfaqësues të Agjencive Rregulatore Evropiane, përfaqësues nga Ministrinë përgjegjëse të vendeve, Operatorët e Komunikimeve Elektronike, Akademikët si dhe të gjithë aktorët e tjerë të përfshirë në politikat rregulatore të TIK-ut.

Kryetari i AKEP Z. Frashëri gjatë fjalës së tij nënvizoi se prioriteti i inovacionit dhe procesit të digjitalizimit e ndihmoi Shqipërinë të mos gjendej e papërgatitur para pandemisë duke bërë që Shqipëria të njihet si një nga vendet me rritjen më të shpejtë të internetit nga rrjetet fikse për 100 banorë referuar raportit të fundit të ITU.

Në përputhje me udhëzimet e praktikave më të mira, AKEP ka finalizuar një sërë analizash të tregjeve të shitjes me shumicë të telefonisë celulare, ka miratuar dokumente rregulatore dhe ka zhvilluar planin strategjik 5G për Shqipërinë. Z. Frashëri theksoi gjithashtu se siguri i 5G mbetet një nga sfidat kryesore të AKEP në të ardhmen.



IV

PERFORMANCA E BREND SHME
DHE MIRADMINISTRIMI
FINANCIAR PËRGJATË
VITIT 2021

1. Automatizimi dhe digjitalizimi tërësor i proceseve në AKEP

Duke vlerësuar rëndësinë e institucionit dhe kompleksitetin e funksioneve që realizon, si dhe duke marrë në konsideratë që sistemet aktuale kanë nevojë për modernizim dhe funksionojnë të veçuar nga njëri-tjetri, u pa i domosdoshëm informatizimi i plotë i të gjithë aktivitetit të institucionit brenda një sistemi të qendëruar ku e gjithë ecuria e punës do të mbulohet nga ky sistem.

Nëpërmjet këtij projekti u synua të digjitalizohet dhe automatizohet i gjithë aktiviteti operacional i institucionit duke i ndërthurur dhe integruar të gjitha proceset brenda një sistemi të vetëm, ku të dhënat janë të sinkronizuara në kohë reale dhe funksionet tërësisht të integruara.

Platforma e implementuar përbëhet nga komponenti ERP- Enterprise Resource Planning software dhe komponenti iBPMS (platformë Inteligjente për Menaxhimin e Proceseve të Biznesit).

Të dy komponentët software janë të gatshëm për t'u përdorur, pa qenë e nevojshme apo domosdoshme aftësi kodimi. Gjithashtu, të dy komponentët mbështesin nevojat eventuale të institucionit për të përshtatur proceset e veta dhe duke ofruar mundësinë për ndërfaqësim apo integrim me anë të mjeteve/paketave të zhvillimit, në formë librarish apo konektore, API për të mbështetur personalizimin dhe përmirësimin.

Sistemi përbëhet nga modulet e mëposhtme:

.....

1. Moduli i menaxhimit të kontratave;
2. Moduli i ndërtimit të proceseve;
3. Moduli i menaxhimit të çështjeve (Case Management);
4. Moduli i menaxhimit të komunikimeve zyrtare;
5. Moduli raportimi Business Intelligence.

.....

Funksionet janë të integruara me njëra-tjetrën dhe sinkronizimi i të dhënave kryhet në kohë reale, duke minimizuar ndërhyrjet e përdoruesit.

Prej implementimit të këtij sistemi u përftua:

- Reduktim i kohës së shpenzuar për realizimin e proceseve të punës;
- Rritje e saktësisë së punonjësve, duke shmangur gabimet e mundshme;
- Rritje e siguri së informacionit, duke eliminuar mundësinë për humbje të dhënash.

Rezultatet e arritura nga realizimi me sukses i këtij sistemi janë:

- Zhvillim i proceseve të punës në sistem sipas kërkesave funksionale të AKEP;
- Automatizim i proceseve të punës së Institucionit, përmes implementimit të një aplikacioni për menaxhimin e rrjedhës së punës në institucion;
- Menaxhim i proceseve të brendshme, referuar autorizimeve, aplikimeve, raportimeve e inspektimeve/monitorimeve duke përfshirë përdorues të jashtëm dhe përdorues të brendshëm në menaxhimin e plotë të një procesi pune;
- Menaxhim i kontratave me palët e treta dhe ndjekje e ecurisë së realizimit të tyre në mënyrë elektronike;
- Digjitalizim e menaxhim i komunikimeve zyrtare në formë elektronike për çdo dokument hyrës apo dalës nga institucioni;
- Integrimi përmes platformës iBPMS dhe ERP, me qëllim sigurimin e rrjedhës së punës në mënyrë të automatizuar, gjatë krijimit të çështjeve për regjistrimin dhe administrimin e kontratave të institucionit;
- Menaxhimi i të gjitha çështjeve (cases) të reklamuar në institucion dhe gjurmimi i tyre nga momenti i regjistrimit deri në zgjidhjen e tyre;
- Implementimi i një platforme raportimi që të mundësojë gjenerim në kohë reale të raporteve dinamike, menaxheriale për të gjithë sistemin, në bazë të nevojës së përdoruesit.

Pas implementimit dhe konfigurimit të proceseve, janë zhvilluar seanca trajnimi për të gjithë punonjësit e institucionit që do të punojnë përmes kësaj platforme. Këto trajnime përfshijnë prezantimin e sistemit, moduleve, funksionet, proceset dhe testimin funksional me shembuj konkret të proceseve me rolet përbërëse. Përdoruesit e sistemit janë trajnuar për të gjithë ato funksionalitete, të cilat janë të nevojshme për të kryer punën e tyre të përditshme. Në përfundim të implementimit të sistemit, përdoruesit kanë mundësinë e aksesit të një Manuali Përdorimi me të gjithë komponentët e sistemit.

2. Performanca në mbledhjen e të ardhurave nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare


Në zbatim të VKM nr. 1096, datë 24.12.2020, pavarësisht situatës së vijueshme të pandemisë AKEP u angazhua në faturimin dhe mbledhjen në kohë të të ardhurave dhe përdorimin e tyre sipas kriterëve të përcaktuar për këtë qëllim.

Nga pagesat për AKEP gjatë vitit 2021:

janë faturuar rreth 381.24 milionë lekë, ose rreth 97.26 % e buxhetit;
janë arkëtuar rreth 379.92 milionë lekë, ose rreth 99.65 % e faturimit.

Krahasuar me një vit me parë, janë faturuar edhe arkëtuar rreth 2.7 % më pak fonde. Shkak për këtë janë ndryshimet teknologjike të operatorëve, investimet në sistemet e tyre, të cilat lidhen me kërkesën në ulje për pajisje me frekuenca të lidhjeve fikse dhe të radiokomunikimit.

Pagesat për AKEP



► Pagesat nga mbikëqyrja e tregjeve

Lidhur me procesin e kësaj pagese, u faturuan dhe u arkëtuan:

- 168.2 milionë lekë nga mbikëqyrja e tregut të komunikimeve elektronike dhe arkëtuan 168.1 milionë lekë.
- 9 milionë lekë nga mbikëqyrja për tregun postar dhe u arkëtuan 9 milionë lekë.

► Pagesat nga përdorimi i spektrit të frekuencave

Gjatë vitit 2021 janë:

- faturuar rreth 120.9 milionë lekë nga caktimi dhe përdorimi i frekuencave dhe arkëtuar rreth 120.5 milionë lekë.

Referuar sa më lart janë faturuar rreth 92% e pagesave për frekuenca dhe nga këto faturime janë arkëtuar rreth 99.6 %.

► Pagesat për numeracion dhe kosto të shërbimit të portabilitetit

- faturuar rreth 46.5 milionë lekë nga caktimi dhe përdorimi i numeracionit dhe kosto të shërbimit të portabilitetit dhe janë arkëtuar rreth 46.3 milionë lekë.

Në lidhje pagesat për numeracion dhe kosto të shërbimit të portabilitetit janë faturuar rreth 101% e vlerës së programuar dhe nga këto faturime janë arkëtuar rreth 99.57 %.

► Pagesa për Domain dhe të tjera

Nga pagesat për Domain janë faturuar rreth 12 milionë lekë dhe janë arkëtuar 11.5 milionë lekë ose 95.8%.

► Komision si agjent tatimor

Në programin e vitit 2021 ky zë u parashikua të ishte rreth 25 milionë lekë.

Nisur nga kërkesa e sipërmarrësve për breza të ndryshëm frekuencash dhe brezat që kanë në përdorim, janë faturuar **rreth 490.89 milionë lekë** nga tarifat për përdorimin e spektrit të frekuencave.

Nga këto faturime, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë janë derdhur rreth **466.35 milionë lekë**.

Si rezultat i faturimit, arkëtimit dhe derdhjes në Buxhetin e Shtetit të këtyre tarifave, janë arkëtuar në AKEP nga komisioni si agjent rreth 24.54 milionë lekë, ose rreth 98.2% e programit.

3. | Përgatitja dhe zbatimi i buxhetit të institucionit

AKEP, në zbatim të VKM nr. 1096, datë 24.12.2020, administroi dhe menaxhoi fondet publike për vitin 2021, sipas zërave të mëposhtëm:

Paga dhe shtesa të tjera	Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore	Materiale	Shërbime	Investime
109.800.000 L	15,000,000 L	8,850,000 L	150,967,400 L	107,382,600 L

Gjatë vitit 2021 janë realizuar në total rreth 89% e fondit të shpenzimeve administrative të AKEP, ose rreth **350.24 milionë lekë, nga 392 milionë lekë të planifikuara dhe të miratuara. Realizimi ka pësuar një rritje 22.97 milionë lekë ose 7 % krahasuar me një vit më parë.**

Pavarësisht vështirësive që solli situata e zgjatur e pandemisë, procedurat e prokurimit janë zhvilluar rregullisht, dhe në shumicën e rasteve impakt në diferencën midis faktit dhe programit ka pasur çmimi më i ulët si rrjedhim i prokurimit nëpërmjet procedurave të prokurimit. Për të menaxhuar me eficiencë këto teprica janë kryer edhe rishikime të buxhetit brenda limiteve të lejuar.

1. Pagat

Gjatë vitit 2021 shpenzimet për paga dhe shtesa janë realizuar në masën 87% ose 13% më pak se programi. Për këtë kanë ndikuar vakancat në strukturën e miratuar, lëvizjet e stafit përgjatë vitit si dhe mosrritja të pagave për administratën.

Kjo diferencë me planin e miratuar është **rreth 14.54 milionë lekë.**

2. Sigurime shoqërore

Për të njëjtat arsye si edhe pagat, niveli i sigurimeve shoqërore ka një realizim në masën 90% ose 10% më pak se planifikimi dhe rezulton me një diferencë në **vlerën rreth 1.54 milionë lekë.**

3. **Materialet**

Në lidhje me shpenzime materiale janë krijuar diferenca rreth 4.15 milionë lekë, kjo si pasojë e disa faktorëve si më poshtë :

- ulja e konsumit për disa artikuj si p.sh., karburant, dhe rritja për dezinfektues dhe sanitare, etj

4. **Shërbime**

Nga zëri shërbime nuk u arritën të përdoren rreth **13.25 milion lekë**, duke qenë se disa shërbime varen nga konsumi i utilitareve si: energjia elektrike, shërbimet postare, pezullimi i disa aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare apo edhe kufizimet e lëvizjeve gjatë vitit 2021.

Në disa raste, diferenat kanë ardhur edhe si pasojë e vlerës së përlogaritur dhe ofertave të paraqitura gjatë procedurave të prokurimit edhe lidhjes së kontratave të shërbimit në vlera shumë më të vogla se fondi i planifikuar.

5. **Investimet**

Si procedura të prokurimi publik, programi fillestar i shpenzimeve për investime u krye 100%.

Duke u bazuar në fondin e miratuar për t'u investuar, zëri i investimeve u realizua me rreth 92.3 %. Pra u përdorën rreth 99.11 milionë lekë, nga rreth 107.38 milionë lekë të planifikuar.

Diferencat e krijuara nga ndryshimi i fondit limit me ofertat fituese u përdorën për blerje emergjente pajisjesh për zgjerim rrjeti të AKEP.

Lidhur me zërin e investimeve sqarojmë se:

- Janë kryer të gjitha investimet e programuara për vitit 2021.
- Janë kryer me sukses të gjitha procedurat e prokurimit, duke u lidhur kontrata me operatorët ekonomik fitues.
- Ka pasur miradministrim dhe transparencë në menaxhimin e fondeve, duke kryer rishpërndarje brenda limiteve ligjore.

Gjatë vitit 2021, ka vijuar të zhvillohet infrastruktura e teknologjisë së informacionit si dhe përmirësime të aplikacioneve ekzistuese. AKEP ka aplikuar metodat më bashkëkohore në ndërtimin e sistemeve të informacionit, mbështetur edhe në detyrat e caktuara në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë dhe aktet nënligjore të dala.

Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit 2021 përfshijnë investime shumë të rëndësishme, për të cilat është folur përgjatë këtij raporti:

- Ndërtimi i sistemit të monitorimit të cilësisë së shërbimit «Nett test for QOS»;
- Automatizimi i proceseve të AKEP;
- Infrastrukturë IT Redundant e Sistemeve dhe upgrade i rrjetit;
- Studim/analizë për teknologjitë e reja mobile broadband në Shqipëri;
- Fiskalizimi i faturës së shitjes dhe blerjes.

Teprica e të ardhurave

Teprica e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara në fund të vitit 2021 rezultojnë në shumën **34.81 milion lekë**, si rezultat i diferencave nga pagesat e sipërmarrësve dhe mos realizimit/kursimit të disa zërave të miratuara në fondin e shpenzimeve të AKEP.

Në krahasim me një vit më parë, **kjo vlerë ka pësuar rënie me rreth 35 %**, duke evidentuar kështu një tregues pozitiv në menaxhimin e fondeve me efektivitet, pavarësisht sfidave që u shfaqën gjatë kësaj periudhe.

Teprica e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara për vitet 2019-2021 paraqitet si më poshtë:

viti	2019	2020	2021
Tepricë në lekë	60,767,384	53,613,913	34,817,270
Teprica në milionë lekë	60.77	53.61	34.82




Tabela e mëposhtme tregon realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2021 kundrejt programit në vlerë absolute dhe në përqindje.

Vlerat në milionë lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2021		Diferenca Fakt-Program	% e realizimit vjetor
I	Të ardhura gjithsej:	392.00	381.23	-10.77	97%
II	Shpenzime gjithsej:	392.00	350.24	-41.76	89%
1	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera	109.80	95.25	-14.55	87%
2	Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	15.00	13.46	-1.54	90%
3	Shpenzime për materiale	8.85	4.70	-4.15	53%
4	Shpenzime për shërbime	150.97	137.72	-13.25	91%
5	Shpenzime për investime	107.38	99.11	-8.27	92%
III	Tarifa e shërbimit të radiokomunikacionit				
1	Arkëtuar tarifa radiokomunikacionit		490.89		
2	Derdhur tarife radiokomunikacioni në buxhetin e Shtetit		466.35		
3	Të ardhura si agjent tatimor nga arkëtimi dhe derdhja e tarifës së shërbimit të radiokomunikacionit	25.00	24.54		98%

4. Procesi i mbledhjes së të ardhurave të prapambetura dhe procedurat gjyqësore

Edhe përgjatë vitit 2021 janë ndjekur dhe janë bërë të gjitha përpjekjet e nevojshme për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe vërtetimi i pamundësisë së arkëtimit të detyrimeve të tyre nga institucioni, nëpërmjet dokumentacionit shoqëruar. Janë revokuar të gjithë autorizimet individuale të subjekteve debitorë dhe po publikohen në faqen zyrtare të internetit të AKEP.

Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesë padive për çështje gjyqësore dhe në shumicën e rasteve debitorët kanë kryer pagesat, pa e çuar procesin në zyrat përmbarimore.

Problematikat e konstatuara gjatë ndjekjes së këtyre proceseve janë adresat jo të sakta, dhe pjesa

dërrmuese e tyre rezultojnë në ekstraktin tregtar me status jo aktiv, duke bërë që njoftimet e tyre të bëhen përmes procedurës së shpalljes publike e duke zgjatur afatet gjyqësore.

Në vitin 2021, debitorët për të cilët u konfirmuan marrjet e njoftimeve, u hartuan kërkesë paditë dhe u iniciuan 8 procese gjyqësore.

Gjykata vendosi pranimin e kërkesë padisë për 2 çështje gjyqësore, 6 proceset e tjera gjyqësore janë ende në gjykim.

Gjatë vitit 2021, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është investuar si palë ndërgjyqëse në total në:

- Cilësinë e palës së paditur, në 6 procese gjyqësore;
- Cilësinë e palës paditëse, në 8 procese gjyqësore;
- Cilësinë e personit të tretë, në 2 procese gjyqësore;
- Në proces gjykimi, 6 çështje gjyqësore.

Në cilësinë e palës së paditur, Gjykata ka disponuar në favor të AKEP, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së palës së paditur në 3 procese gjyqësore.

Në cilësinë e palës paditëse, Gjykata ka disponuar në favor të AKEP, duke vendosur pranimin e kërkesëpadisë, në 2 procese gjyqësore.



V

SHTOJCA

1. Struktura dhe Organigrama e Akep

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare organizohet dhe funksionon referuar strukturës organizative të miratuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 56/2018, “Për miratimin e strukturës, organikës, dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)”.

Punonjësit e rekrutuar në Institucion trajtohen sipas dispozitave të ligjit “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, dhe Kodit të Punës.

Struktura organizative dhe organika e AKEP përbëhet nga 85 punonjës, të organizuar në 8 Drejtori dhe 14 Sektorë.

Gjatë vitit 2021, bazuar në planin vjetor të pranimit si dhe vendeve vakante të krijuara rast pas rasti, janë realizuar gjithsej 17 procedura rekrutimi në shërbimin civil, duke ndjekur fazat e rekrutimit me lëvizje paralele, ngritje në detyrë apo pranim në shërbimin civil.

Në fund të vitit 2021 rezultonin për t’u plotësuar 10 pozicione të lira pune, respektivisht 8 pozicione në Shërbim Civil në nivel ekzekutiv dhe në nivelin e ulët drejtues, si dhe 2 pozicione me Kod Pune në funksionin e Këshilltarit të Kryetarit të Këshillit Drejtues dhe Sekretares së Këshillit Drejtues të AKEP.

Gjatë vitit 2021 përfaqësimi gjinor në totalin e punonjësve aktivë u paraqit në raportin 53% për gjininë femërore edhe 47% për gjininë mashkullore, ndërkohë që ky raport në nivelet drejtuese është 43% femra dhe 57% meshkuj.

2. Raport Lidhur me Nivelin e Zbatimit të Rezolutës dhe Rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë për Vitin 2021

1. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, pas inspektimit të kryer për subjektin «Posta Shqiptare» sh.a., të vijojë me monitorimin e rekomandimeve të lëna për heqjen e plotë të tarifës së dorëzimit të objekteve postare (pakot e vogla ose kolipostat që vijnë nga jashtë vendit për individët), si dhe përmbushjen e detyrimeve për dorëzimin e pakove në adresën e individit nga Posta Shqiptare sh.a., si një kërkesë ligjore dhe e drejtë e konsumatorit.

Realizuar

Lidhur me këtë rekomandim sqarojmë se, përgjatë vitit 2020, AKEP ka realizuar inspektimin e ofruesit të shërbimit postar universal, Posta Shqiptare sh.a.

Gjatë procedurës inspektuese, u konstatua se subjekti Posta Shqiptare sh.a., në veprimtarinë e saj shfaqte problematika, dhe përveç masës administrative “Gjobë” ju lanë edhe rekomandimet e mëposhtme:

- Të marrë masa organizative dhe teknike për shpërndarjen e të gjithë objekteve postare (pako/ kolipostë) në adresën e marrësit, në përputhje me nenin 40, të ligjit 46/2015.
- Të marrë masa për rishikimin e vendimi nr. 5, datë 30.1.2017, të Këshillit Mbikëqyrës të Postës Shqiptare, si dhe rishikimin e vendimit nr. 24, datë 17.6.2014, “Mbi miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimeve postare të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a.” (shërbimi i lajmërimit për tërheqjen e pakove postare), me qëllim rregullimin e problematikës së konstatuar mbi tarifimin e marrësit për tërheqjen e pakove postare.
- Të marrë masa për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore dhe teknike me qëllim plotësimin e kërkesave të nenit 31, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” dhe rregullores nr. 41, datë 3.3.2016, “Për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostove të shërbimit universal postar”.

Në vijim të rekomandimeve të lëna, AKEP vazhdon të monitorojë në vijimësi procesin e përmbushjes së tyre, duke vlerësuar shfaqjen e vullnetit pozitiv të subjektit “Posta Shqiptare” sh.a., dhe përpjekjeve të vazhdueshme për plotësimin e rekomandimeve.

Nga raportimet e kryera në funksion të përmbushjes së shërbimit për shpërndarjen e objekteve postare në adresën e marrësit, Posta Shqiptare sh.a., ka kryer investime me kosto të konsiderueshme, duke krijuar një flotë transportit të dedikuar vetëm për dorëzimin e paketave/kolipostave.

Gjithashtu, subjekti "Posta Shqiptare" sh.a., deklaroi se, prej datës 1 janar 2021, nuk aplikoi vjeljen e tarifës së dorëzimit për objektet postare, pakot e vogla apo kolipostat që vijnë nga jashtë vendit. Mbetet ende shqetësuese problematika mbi ndarjen e shpenzimeve (kostos), sipas shërbimeve të evidentuara në sistemin financiar (ETERNA), pasi ky sistem nuk ka të identifikuar në njësi bazë Shërbimin Universal Postar.

Për t'u informuar më tej lidhur me realizimet e detyrave, në datën 15.12.2021 është kryer edhe një takim i përbashkët midis përfaqësuesve të AKEP dhe Postës Shqiptare sh.a., me qëllim informimin mbi përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga inspektimi, planet për vitin 2022, edhe hapat që do të ndiqen nga Posta për realizimin e detyrave të caktuara.

Përgjatë muajve dhjetor 2021 dhe janar 2022, strukturat e AKEP po realizojnë një inspektim pranë subjektit Posta Shqiptare sh.a., objekt i të cilit, ndër të tjera, është edhe verifikimi mbi përmbushjen e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit.

.....

2. Pas inspektimit të kryer nga AKEP-i për tre sipërmarrësit e rrjeteve celulare, të vijoje monitorimin për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna dhe korrigjimin e shkeljeve të konstatuara nga këta sipërmarrës në funksion të zbatimit të rregullores të portabilitetit të numrit, duke bërë të mundur që pajtimtarët të ushtrojnë të drejtën e tyre të portimit të numrit celular sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në aktet rregullatore.

Realizuar

Lidhur me këtë rekomandim sqarojmë se, pas inspektimit të kryer nga strukturat e AKEP gjatë vitit 2020, në veprimtarinë e sipërmarrësve të rrjeteve celulare u konstatuan problematika lidhur me procesin e portimit.

Pas inspektimit të 3 sipërmarrësve të rrjeteve publike celulare "One Telecommunications" sh.a., "Vodafone Albania" sh.a., dhe "Albtelecom" sh.a., struktura inspektuese e AKEP konstatoi tek të 3 sipërmarrësit shkelje të përcaktimeve të rregullores nr. 43, datë 22.9.2016, "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit", shkelje të cilat klasifikohen si kundërvajtje administrative për të cilat parashikohen dënime administrative "Gjobë" dhe dënime administrative plotësuese në formën e rekomandimeve sipas nenit 137, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Gjithashtu, konkretisht, ndaj të tre sipërmarrësve strukturat inspektuese të AKEP kanë dhënë masa administrative plotësuese në formën e rekomandimeve, si më poshtë:

- të kryejë analizimin dhe zgjidhjen e shkaqeve që kanë çuar në shkeljen e përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të procesit të portabilitetit të numrit, duke zgjatur procedurën në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërisht;
- të kryejë përditësimin e të dhënave që administrohen në database-n e tij, në mënyrë të veçantë përditësimin e të dhënave të abonentëve të regjistruar me pasaporta të vjetra apo me certifikatë, të cilat nuk e përmbajnë ID numrin personal të abonentit;
- të kryejë kontroll/audit periodik të brendshëm, për të evidentuar dhe korrigjuar rastet e refuzimeve për mospërputhje ID të pajtimtarit, si pasojë e gabimeve njerëzore të hedhjes së të dhënave në database-n përkatëse (CRM);
- të zhvillojë intensivisht trajnime me stafin e pikave të shitjeve për procedurat e ngritjes së kërkesave për bartjen e numrit si dhe për çdo ndryshim në rregullore dhe detyrimet që rrjedhin nga këto ndryshime;
- të ndalojë menjëherë praktikatat tregtare çorientuese dhe agresive, ofertat të individualizuara që ndikojnë në procesin e portimit;
- të zbatojë menjëherë detyrimet mbi limitin kohor të përgjigjes për bartje T1 (pika 6 e nenit 18, të rregullores nr. 43, datë 22.9.2016, "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit");
- të zbatojnë menjëherë detyrimet në lidhje me përgjigjen për bartje, në lidhje me % e rasteve të refuzuara dhe pranuar (pika 5, e nenit 18, të rregullores nr. 43, datë 22.9.2016, "Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit");
- të zbatojnë sipas legjislacionit në fuqi, formën, afatet dhe procedurën e ankesave që lidhen me procesin e portimit;
- të kryejnë korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojave të tyre brenda 60 (gjatëdhjetë) ditëve nga vendimi përfundimtar i inspektimit;
- të njoftojnë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar me sipër dhe të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt;
- të dorëzojnë raportime periodike mujore (çdo datë 30 të muajit), deri në përmbushjen e afatit përfundimtar, duke përcaktuar se çfarë progresi është bërë për sa i përket zbatimit të detyrave për korrigjimin e shkeljeve.

Në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga inspektimi, sipërmarrësit monitorohen në vijimësi për procesin e portimit, duke dorëzuar në AKEP raportime periodike mujore (çdo datë 30 të muajit).

Gjithashtu, një grup pune i ngritur në AKEP, ka monitoruar dhe përgatitur raporte periodike me të dhënat statistikore të gjeneruara edhe nga sistemi CRDB mbi performancën e operatorëve në lidhje me zbatimin e afateve dhe rregullave të portimit.

Referuar këtyre raporteve, është vënë re se nivelet e portimit kanë vijuar të jenë ende të larta.

Në këto kushte, me qëllim verifikimin e përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, si dhe për kryerjen e një vlerësimi më të plotë të situatës së portimit, strukturat e AKEP kanë iniciuar së fundmi një inspektim tek të tre sipërmarrësit e rrjeteve celulare, i cili ka përfunduar në muajin dhjetor. Lidhur me rezultatet e inspektimit do t'ju informojmë në raportimin vjetor.

.....

3. *Të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës për të shmangur praktikat tregtare çorientuese dhe agresive, si dhe ofertat nën kosto të operatorëve që çojnë në deformim të tregut.*

Realizuar

Lidhur me këtë rekomandim AKEP në vijimësi ka bashkëpunuar me Autoritetin e Konkurrencës, duke e informuar AK lidhur me marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të këtij të fundit mbi adresimin e shqetësimeve për aplikimin e praktikave tregtare çorientuese dhe agresive.

Konkretisht, gjatë vitit 2021, AKEP ka përcjellë informacione të plota mbi paketat dhe tarifat e shërbimeve celulare të njoftuara nga operatorët celularë. Gjithashtu, ka informuar Autoritetin e Konkurrencës edhe mbi masat e ndërmarra nga AKEP për zgjidhjen e problematikave teknike në procedurën e portabilitetit të numrave, me qëllim sigurimin e konkurrencës efektive mes operatorëve në treg.

AKEP, si organ rregullator i pavarur në fushën e komunikimeve elektronike, ka ofruar dhe do të vazhdojë të ofrojë bashkëpunimin e tij për çështjet e interesit të përbashkët, si edhe do të vijojë të ndjekë me prioritet këto çështje, me qëllim mbrojtjen e përdoruesve dhe konsumatorëve si edhe zhvillimin e një konkurrence të ndershme në tregun e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë.

.....

4. *Pas miratimit të rregullores për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Përdoruesve të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike dhe Publike, të punojë për zbatimin e kësaj rregulloreje nga operatorët e shërbimeve të komunikimeve elektronike, veçanërisht sa u takon shërbimeve të reja për përdoruesit me aftësi ndryshe, siç është shërbimi Text Relay (shërbim i konvertimit të tekstit), i cili i lejon personat që kanë vështirësi në dëgjim dhe/ose në të folur për të kryer/marrë thirrje telefonike, ose opsioneve të propozuara që u vijnë në ndihmë pajtimtarëve me të ardhura të ulëta, siç është zgjatja e afatit të vlefshmërisë së rimbushjeve në 12+3 muaj dhe të drejtën e pajtimtarit për kompensim për shumat e papërdorura.*

Realizuar

Dokumenti "Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike" është një akt rregullator i rëndësishëm për përmbushjen e objektivave të ligjit 9918/2008, strategjisë dhe politikave të sektorit të komunikimeve elektronike, plotësimin e rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe procesit të integritetit në BE.

Dokumenti u miratua nga Këshilli Drejtues i AKEP, në datën 11.3.2021, pas përfundimit të procesit të këshillimit publik të nisur më datë 30.9.2020. Rregullorja do të hyjë në fuqi në datën 1 shkurt 2022. Ndërkohë sipërmarrësit kanë kryer njoftimet në AKEP lidhur me draft kontratat e pajtimit si dhe kanë njoftuar pajtimtarët në respektim të afateve ligjore.

Rregullorja e miratuar synon një mbrojtje më të mirë të të drejtave të konsumatorit dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike nëpërmjet përcaktimit të rregullave më të qarta për të drejtat tyre në marrëdhëniet me sipërmarrësit, duke përfshirë:

- detyrime më të qarta për termat dhe kushtet të cilat duhet të përfshihen dhe të jenë pjesë përbërëse në kontratat e pajtimit për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;
- rregulla të qarta për aksesin në shërbimet e emergjencës dhe përcjelljen e informacionit të vendndodhjes së pajtimtarit për këto thirrje, përfshirë thirrjet drejt numrit unik të emergjencave 112;
- saktësime për kohëzgjatjen, rinovimin dhe përfundimin e kontratave;
- rregulla më të qarta për trajtimin e ankesave nga operatorët dhe mbajtjen e rekordeve të tyre si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pajtimtarë - sipërmarrës;
- kushtet për transparencën dhe publikimin e informacionit nga ofruesit e rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike publike;
- masa për garantimin e aksesit të barabartë për personat me aftësi të kufizuar.

“Rregullorja për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” përmban:

- përcaktimet e AKEP për rregullimin e marrëdhënieve të sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike me pajtimtarët;
- harmonizim me rekomandimet dhe direktivat e BE, dokumentet e BEREC dhe praktika në disa vende të BE në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit/përdoruesit fundor të shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- përshtatje me kushtet aktuale të tregut shqiptar të komunikimeve elektronike dhe problemet e hasura në marrëdhëniet sipërmarrës-pajtimtar;
- marrjen në konsideratë të komenteve të palëve të interesuara, si sipërmarrësit, shoqatat e personave me aftësi të kufizuar;
- konsolidimin e disa akteve të AKEP në lidhje me të drejtat e pajtimtarëve në një akt të vetëm.

AKEP ka bashkëpunuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me shoqatat e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, lidhur me hartimin e kontratave për këta persona, si edhe janë organizuar takime me operatorët celularë për të kryer zhvillime teknologjike në sistemet e tyre për bërjen të mundur të përfitimeve për këtë grup të caktuar.

.....

5. Të kryejë një vlerësim afatgjatë të parametrave, kapaciteteve dhe strategjive për implementimin e rrjeteve dhe teknologjive të brezit të ri (5G) brenda vitit 2021.

Realizuar

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), në cilësinë e organit rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me objektivat rregullatorë të përcaktuar në nenin 7, të ligjit nr. 9918/2008, të tilla si:

- Drejtimin e investimeve të fokusuara në zhvillimin e qëndrueshëm digjital, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe garantimin e të drejtave të konsumatorit.
- Administrimin e sektorit të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare përmes konkurrencës së drejtë dhe të arritshme në treg.
- Promovimin e aseteve kombëtare, brezave të frekuencave dhe përdorimin efikas të tyre në kuadrin e teknologjive të gjeneratës së ardhshme.
- Standardizimin e sigurisë së rrjetit dhe besueshmërinë e shërbimeve të komunikimit elektronik

përmes ofruesve dhe teknologjive të sigurta.

- Harmonizimin gjithnjë e më të ngushtë me kërkesat rregullatore dhe të pavarësisë funksionale, duke ndjekur standardet e BE.

AKEP në cilësinë e Autoritetit Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit publik me objekt *“Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri”* dhe në përfundim të saj, ka nënshkruar kontratën me operatorin ekonomik fitues, bashkimin e operatorëve ekonomikë *“Jones Group International” & “Dynology Corporation”* (JGI & DC).

Në përputhje me detyrimet kontraktore, kontraktori së bashku me AKEP ka hartuar dokumentin *“Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri”*, dokument të cilin AKEP e ka pranuar. AKEP ka iniciuar zhvillimin e këtij studimi, duke përfshirë një vlerësim të gjithanshëm ku u morën parasysh aspektet e teknologjisë, sigurisë, përballueshmërisë dhe aftësive. Një rëndësi të veçantë gjatë hartimit të dokumentit patën edhe takimet me operatorët celularë dhe u morën në konsideratë edhe pikëpamjet e tyre mbi masat që duhen marrë për të inkurajuar investimet në rrjetin 5G për të ardhmen. Operatorët e telekomit në Shqipëri kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në këtë studim dhe do të jenë pjesë kryesore e zbatimit të 5G në Shqipëri.

Ky studim përfshin ndër të tjera edhe procesin për dhënien e të drejtave të përdorimit sa më objektiv dhe sa më transparent, me qëllim përfitimin e konsumatorëve dhe ekonomisë shqiptare, krijimin e një tregu konkurrues në Shqipëri, si dhe përdorimin efektiv të spektrit në përmbushje të objektivave rregullatorë.

AKEP, në procesin e përgatitjes së dokumenteve rregullatore për tregun e komunikimeve elektronike dhe përpara marrjes së vendimeve, të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike, është i detyruar të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet Këshillimit Publik, dhe për këtë arsye ka vlerësuar nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit.

Dokumenti i nxjerrë në Këshillim Publik përmban katër fusha kryesore fokusimi, siç përshkruhen më poshtë:

- I. Fokusi i Parë: Lehtësimi i Tenderit/Ankandit të Spektrit 5G në Shqipëri.
- II. Dokumenti është fokusuar tek mënyrat e lehtësimit të procedurave dhe afateve të tenderimit/ ankandëve, në mënyrë që të zvogëlohet koha mesatare e dhënies së autorizimeve për frekuencat 5G. Kjo do të ishte në interes të vendit, por edhe të operatorëve celularë, në mënyrë që operatorët të kenë kohën e nevojshme, të sigurojnë financimin e investimeve të nevojshëm për të përmirësuar/ përgatitur infrastrukturën e telekomunikacionit në Shqipëri për një zbatim të sigurt 5G.
- III. Fokusi i Dytë: Rekomandime për veprime legjislative për të mbështetur përhapjen e rrjeteve 5G.

Planifikimi dhe zbatimi i teknologjisë së re 5G kërkon strategji të reja operative për qeverinë dhe industrinë e telekomit, akte rregullatore dhe mjete të reja për monitorimin e performancës dhe

matjen e suksesit, dhe një proces transparent që inkurajon investimet për të ardhmen. Kjo do të thotë që ligjet, rregulloret dhe proceset duhet të rishikohen për të mbështetur qëllimin e një përhapjeje të suksesshme të 5G në të gjithë Shqipërinë. Në dokument përfshihen disa rekomandime për veprimet legjislative që do të ndihmojnë në lehtësimin e përhapjes së rrjeteve 5G.

IV. Fokusi i Tretë: Promovimi i 5G.

Ky fokus do të trajtojë dy kërkesa kryesore: (1) mendimet dhe rekomandimet e operatorëve të telekomit, kur ata konsiderojnë të kryejnë investime në 5G; dhe (2) roli që Qeveria duhet të luajë në inkurajimin e këtyre investimeve dhe në informimin e publikut shqiptar në lidhje me përfitimet e 5G.

V. Fokusi i Katërt: Vlerësimi dhe adresimi i rreziqeve dhe konsiderata të tjera për 5G.

Në këtë pjesë të dokumentit përfshihen rreziqet që mund të vijnë në shumë forma, siç janë p.sh.: rezultatet e ankandit të spektrit jo të plotë ose të pakënaqshëm; disponueshmëria e sistemeve/komponentëve ose zinxhirëve të besuar të furnizimit me rrjet; dobësitë në rrjetet e sigurta 5G nga furnizuesit e rrjetit jo të pastër dhe kufizimet financiare/teknike të operatorëve të telekomit për të zbatuar 5G.

Në përfundim të procedurës, AKEP ka administruar mendime nga të tre sipërmarrësit e telefonisë së lëvizshme, si edhe MIE. Mendimet dhe komentet i janë përcjellë Konsulentit, i cili, së bashku me specialistët e AKEP, në fund të muajit dhjetor kanë hartuar dokumentin final.

.....

6. Të luajë një rol pro aktiv, nga njëra anë, në terma afatshkurtër, për të bërë të mundur marrjen e masave për sistemim të kabllave ekzistuese në bashkëpunim me të gjithë aktorët dhe, nga ana tjetër, në terma afatgjatë, për propozimin e ndryshimeve ligjore/nënligjore për zgjidhjen e këtij problemi.

Në proces realizimi

Në përmbushje të plotësimit të detyrimeve të ngarkuara nga Rezoluta e Kuvendit të RSH për AKEP, edhe gjatë vitit 2021 ka vijuar ndjekja e situatës së rrjeteve dhe infrastrukturës së sipërmarrësve në zonat e identifikuara si problematike si dhe vijon ndërhyrja në disa zona për eliminimin e infrastrukturës ajrore sipas planit vjetor të inspektimit, me qëllim plotësimin e kushteve teknike të përcaktuara në rregulloren nr. 22, datë 24.6.2011, "Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrbane të komunikimeve elektronike".

AKEP në vijimësi ka kërkuar prej sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, ofruesve të rrjeteve kabllore audiovizive, ashtu edhe prej njërive vendore të marrin masa me qëllim eliminimin e lidhjeve që

mbështeten në infrastrukturën e rrjetit elektrik dhe të ndriçimit.

Gjithsesi, për të shmangur apo minimizuar këtë dukuri, me qëllim përmbushjen dhe standardizimin e kërkuar në rrjetin inxhinierik të komunikimeve elektronike, një nga faktorët më kryesorë vlerësojmë se është plotësimi i kërkesave të operatorëve për pajisjen me lejet e duhura për vënien në dispozicion dhe shtrirjen e infrastrukturës së nevojshme për linjat nëntokësore të komunikimeve elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe vendosja nga ana e pushtetit lokal të tubacioneve në të gjitha infrastrukturat urbane (rrugë, trotuare) që po ndërtohen apo do të ndërtohen në të ardhmen.

Në vlerësimin tonë, problematika e kabllave ajrorë nuk mund të zgjidhet me masa drastike të cilat do të kolapsonin shërbimet e sipërmarrësve ndaj pajtimtarëve, por me veprime graduale, duke përdorur shtyllat e OSHEE nga operatorët dhe kryerjen e zëvendësimit të tyre në disa faza, në përputhje me planifikimet për zhvillimin e qytetit, si dhe duke marrë në konsideratë parashikimet dhe normat teknike që lidhen me sigurinë elektrike, shkallën e izolacionit, lartësinë e shtyllave etj. Në këtë aspekt, AKEP vijon të ndjekë me përparësi këtë problematikë duke e koordinuar punën edhe me aktorët e tjerë të këtij procesi, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet OSHEE dhe operatorëve të rrjeteve fikse mbi rregullimin e përdorimit të infrastrukturës pasive, mbështetur në aktmarrëveshje ndërmjet palëve.

Në këtë pikë, ashtu si edhe disa pika të tjera të rezolutës, realizimi i detyrës varet nga disa aktorë, ku AKEP ka luajtur një rol proaktiv dhe ka dhënë ndihmesën dhe bashkëpunimin e tij maksimal, por, për realizimin e plotë të detyrës, duhet kryerja me sukses dhe koordinimi i veprimeve nga të gjithë palët e përfshira në proces, të tilla si, OSHEE, Bashkitë, sipërmarrësit, etj.

.....

7. Të bashkëpunojë me operatorët celularë dhe të koordinojë punën për rritjen e mbulimit dhe cilësisë së shërbimeve në brezat e frekuencave GSM, UMTS dhe LTE në qytetet kryesore të Republikës së Shqipërisë, rrugët kryesore kombëtare, zonat urbane dhe rurale dhe veçanërisht në pikat turistike, ku konstatohen probleme mbulimi me shërbim.

Realizuar

Edhe përgjatë vitit 2021, AKEP ka vazhduar kontrollin mbi rritjen e mbulimit dhe cilësinë e shërbimeve për teknologjitë GSM, UMTS dhe LTE në qytetet kryesore të Republikës së Shqipërisë, rrugët kryesore kombëtare, zonat urbane dhe rurale dhe veçanërisht në pikat turistike.

Gjatë vitit 2021 është konstatuar përmirësim i shërbimit, përkatësisht:

- Për teknologjinë LTE, e cila ka rritur ndjeshëm shpejtësinë e transmetimit të të dhënave në zonat me densitet të lartë të përdoruesve si në qytetet Durrës, Shijak, Elbasan, Peqin, Cërrik, Peshkopi, Klos, Burrel.

- Përmirësim me mbulim dhe cilësinë e shërbimit në zonën turistike të Gërmenjit dhe zonave rurale rreth tij, si dhe në plazhet e vendit. Gjithashtu, u është kërkuar operatorëve marrja e masave për përmirësimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në zonën turistike të Butrintit, si një prej zonave më të frekuentuara gjatë vitit 2021.
- Është arritur të bëhet mbulimi dhe përmirësimi i shërbimit të telefonisë së lëvizshme në koordinim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë në akset e reja rrugore të cilat janë përfunduar ose janë në proces dhe do të jenë në shërbim. Në pjesën më të madhe të aksit rrugor të By-Pass të Vlorës, i cili është në përfundim të punimeve, janë marrë masat gjatë sezonit turistik të vitit 2021, për përmirësimin e mbulimit dhe ofrimin e një shërbimi në kushte teknike të pranueshme. Nga AKEP u është kërkuar operatorëve mbulimi dhe përmirësimi i plotë i këtij aksi të ri rrugor me shërbime përpara fillimit të sezonit të ri veror për vitin 2022. Gjithashtu, në aksin rrugor Rruga e Arbrit, janë kryer monitorime duke evidentuar problematikat në zona të caktuara, për të cilat u është kërkuar operatorëve të planifikojnë masat që do të ndërmarrin për ofrimin e shërbimit në momentin e vendosjes në funksionim të këtij aksi rrugor.
- Për mbulimin dhe përmirësimin me shërbime të telefonisë së lëvizshme për zonat urbane dhe rurale të konstatuara nga AKEP, operatorët, sipas plan-buxheteve të tyre, kanë aplikuar për leje për ndërtimin e stacioneve sipas legjislacionit në fuqi.

.....

8. Të bëjë të gjitha përpjekjet për dhënien e lotit të mbetur të brezit të frekuencave 800 MHz, brenda këtij viti, si dhe të luajë një rol proaktiv, duke bashkëpunuar me të gjithë aktorët në procesin e lirimit të brezit 700 MHz. (brezi DD2).

Realizuar

Lidhur me spektrin e paalokuar të brezit 800 MHz (1x10 MHz, i çiftuar), edhe pas përfundimit të konsulencës përkatëse në fund të vitit 2020, nuk ka pasur shprehje interesi nga operatorët celularë për këtë spektër. Megjithatë, ky spektër do të kihet parasysh edhe pas rezultateve të konsulencës që po zhvillohet si studim analize për teknologjitë e reja mobile broadband në Shqipëri.

Nga ana e AKEP janë kryer të gjitha hapat për brezin e mbetur, ku në bashkëpunim me konsulentin janë dhënë edhe variantet përkatëse për secilin rast, por nga ana e operatorëve nuk është treguar interes për marrjen në përdorim të këtij brezi.

Kjo detyrë është e lidhur edhe me rekomandimin 5 (më sipër), sepse brezi 700 MHz është një nga brezat kryesorë të rrjeteve 5G, por është e lidhur gjithashtu edhe me Strategjinë 5G në Shqipëri, strategji e cila po hartohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në bashkëpunim edhe me AKEP.

Për lirimin e brezit 700 MHz, MIE ka përfutur një konsulencë nga ITU, e cila, në bashkëpunim me AMA

dhe AKEP, hartoi disa zgjidhje teknike për lirim e këtij brezi.

Gjithashtu, në VKM nr. 636, datë 29.7.2020, "Për miratimin e programit shumëvjeçarë të politikës spektrale dhe të planit të veprimit", u përcaktua edhe data e lirit të këtij brezi, që është 30.6.2022.

Përpjekje për koordinime midis vendeve të rajonit janë bërë edhe nga RCC (Regional Cooperation Council) e cila organizoi në datën 8.11.2021 një takim për zhvillimet e broadband dhe 5G në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në takim u ra dakord që të kryhet një workshop online me pjesëmarrjen e AMA, AKEP, EKIP dhe AEK, në lidhje me lirim e brezit 700 MHz.

Gjatë këtij takimi AMA prezantoi njërin nga zgjidhjet teknike më të mundshme të lirit të brezit 700 MHz, në mënyrë që autoritetet rregullatore fqinje të dinë paraprakisht sa preken nga kjo zgjidhje teknike, në mënyrë që edhe procesi i koordinimit ndërkufitar të realizohet sa më shpejt.

Në vijim edhe të bashkëpunimit për lirim e brezit 700 MHz Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare nënshkruan në datën 3.11.2021 Memorandumin e Bashkëpunimit me qëllim garantimin dhe mbështetjen operacionale, teknike dhe ligjore, në fushat me interes të përbashkët për të dyja palët.

Të dy institucionet do të bashkëpunojnë ndër të tjera për lirim e brezit 700 MHz (të ashtuquajtur DD2), nga AMA dhe marrjen në administrim të këtij brezi nga AKEP, duke shkuar drejt respektimit të afateve të vendosura nga BE dhe ITU.

AKEP ka shfaqur gatishmërinë e tij për marrjen në administrim të këtij spektri pas lirit të tij nga AMA.

.....

9. Të bashkëpunojë me MIE për harmonizimin e legjislacionit të fushës së komunikimeve elektronike në përputhje me Kodin e ri Evropian të Komunikimeve Elektronike, kërkesë e cila theksohet edhe në progres raportin e KE-së.

Realizuar

Duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e madhe të këtij sektori në zhvillimin e ekonomisë digjitale, si dhe evoluimin e jashtëzakonshëm brenda një periudhë shumë të shkurtër, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare e konsideron si tejet të nevojshëm pasjen e një kuadri ligjor normues, i cili i përshtatet dinamikës së tij. Tregu i komunikimeve elektronike po ndryshon shumë shpejt përballë kërkesës gjithnjë e në rritje për zhvillimin e infrastrukturës së shpejtësisë së lartë, si dhe përdorimit në masë të madhe të aplikacioneve të telefonisë së lëvizshme në jetën moderne, ndaj, dhe në këtë kontekst, vlerësohet mjaft e rëndësishme ndërhyrja legjislative në kuadrin ligjor ekzistues në fuqi.

Sa më sipër, për të siguruar ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike për qytetarët shqiptar me të njëjtat standarde si ato të vendeve të BE, AKEP është në proces bashkëpunimi të vazhdueshëm me MIE për harmonizimin e legjislacionit të fushës së komunikimeve elektronike me kuadrin e ri rregullator të BE (formësuar me Kodin e Evropian të Komunikimeve Elektronike (EECC).

Ndërkohë, AKEP është pjesë e grupit të punës të ngritur nga MIE, të cilët do të punojnë ngushtësisht me konsulentin e përzgjedhur nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në kuadër të asistencës teknike IPA, për transpozimin në legjislacionin kombëtar të direktivës 2018/1972/EU Kodi i Komunikimeve Elektronike, përgjatë vitit 2022.

10. Në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025, të punojë për përmbushjen e detyrave që kanë lidhje drejtpërdrejt me AKEP-in, siç janë: përmirësimi i Atlasit Broadband, përmirësimi i bashkë-përdorimit të infrastrukturës ekzistuese.

Realizuar

Në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillimin e qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025, AKEP është duke punuar në përmirësimin e Atlasit Broadband.

AKEP, gjithashtu, është duke punuar me të gjithë operatorët e komunikimeve elektronike mbi regjistrimin dhe përditësimin e rrjetit të sipërmarrëseve në sistemin Atlas, sipas përcaktimeve të rregullores nr.26, "Për Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë".

Ashtu siç u sqarua edhe në pika të tjera të Rezolutës, kemi të bëjmë me një detyrë e cila duhet të koordinohet edhe me aktorë të tjerë, siç janë pushteti vendor, FSHZH, ARSH të cilët duhet të përditësojnë rrjetin e tyre në sistemin ATLAS. Nga ana e AKEP janë kryer njoftimet përkatëse dhe janë organizuar takime me përfaqësues të Bashkive për përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave.

Gjithashtu, MIE dhe AKEP kanë bashkëpunuar në lidhje me projektin për "Zhvillimin e Atlasit të Broadband të Shqipërisë dhe përdorimin e tij në sektorin publik dhe privat", projekt të cilin Shqipëria e ka përfituar në kuadër të thirrjes së 23-të, të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF).

Ky projekt ka për qëllim zhvillimin e sistemit Atlas, përditësimin e këtij sistemi me informacionin deri në përdoruesin fundor, informacionin mbi përdorimin e internetit me brez të gjerë në Shqipëri, ofruesit e rrjetit në një zonë të caktuar, informacionin mbi zonat e bardha si edhe mbulimin e shërbimeve celulare, bazuar në praktikat dhe modelet më të mira ndërkombëtare.

Ky projekt, përveç zhvillimit të sektorit privat, do të ketë impakt edhe në shtrirjen e rrjeteve të internetit me shpejtësi të lartë në institucione shtetërore si shkolla, qendra shëndetësore, njësi administrative etj.

Gjithashtu, ky projekt ka për qëllim përmirësimin e Sistemit Atlas të infrastrukturës së komunikimeve elektronike, duke përfshirë informacionin deri në pikën fundore të rrjetit, informacionin për rrjetet ekzistuese pasive që mund të përdoren për Broadband.

MIE dhe AKEP po punojnë me konsulentët e përzgjedhur për realizimin në kohë të projektit.

.....

11. Në kuadër të planit të veprimit për politikën spektrale, të krijojë së bashku me AMA-n një inventar të unifikuar, të përbashkët për spektrin radio të përdorur për qëllime komerciale dhe publike, si dhe të hartojnë së bashku me MIE-n dhe AMA-n një metodologji dhe të kryejnë një analizë për tendencat teknologjike bazuar në praktikën e Bashkimit Evropian të nevojave të ardhshme dhe të kërkesës për spektër radio në sektorët përkatës.

Realizuar

Në zbatim të VKM-së nr. 636, datë 29.07.2020, "Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit", Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka miratuar udhëzimin nr.3, datë 7.6.2021, "Për procedurat praktike të krijimit dhe administrimit të inventarit të unifikuar, të përbashkët për spektrin radio të përdorur për qëllime komerciale dhe publike". AKEP përgjatë vitit 2021, ka implementuar edhe sistemin e avancuar të frekuencave, për një përdorim më të automatizuar edhe modern të frekuencave të cilat administrohen nga AKEP.

Në përmbushje të plotësimit të detyrimeve të ngarkuar edhe nga Rezoluta e Kuvendit të RSH, AKEP dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive kanë koordinuar jetësimin e një inventari të unifikuar të frekuencave, bazuar në dispozitat e Politikës Spektrale i cili shërben për:

- Identifikimin e brezave të frekuencave ku ka hapësirë për përmirësimin e efikasitetit të përdorimit aktual të spektrit radio, duke konsideruar edhe mundësinë e caktimit/ricaktimit të frekuencave.
- Identifikimin e brezave të lirë të frekuencave që do të garantojnë një përdorim më efikas, për të promovuar inovacionin dhe për të rritur konkurrencën e tregut brenda vendit.
- Identifikimin e brezave të frekuencave ku ka mundësi për përdorim të përbashkët të spektrit radio dhe duke mbajtur parasysh në të njëjtën kohë edhe kërkesën për shërbime të reja.
- Analizimin e llojeve të ndryshme të përdorimit të spektrit radio nga ana e përdoruesve si nga sektori publik ashtu edhe ai privat.

12. Të rrisë përpjekjet për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi me AMA-n, e cila do t'i japë një dimension të ri bashkëpunimit në fusha të përbashkëta, që kanë lidhje me punën e 2 autoriteteve, veçanërisht në kuadër të programit për politikën spektrale dhe planit të veprimit, miratuar nga qeveria, por edhe në drejtim të parandalimit të piraterisë audiovizive online.

Realizuar

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) kanë realizuar takime dypalëshe gjatë të cilave është vlerësuar bashkëpunimi i deritanishëm dhe është vënë theksi në intensifikimin e marrëdhënieve të dy institucioneve dhe rritjen e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët.

Në vijim të takimeve, të dy autoritetet, në datën 3.11.2021 nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit me qëllim garantimin dhe mbështetjen operacionale, teknike dhe ligjore në fushat me interes të përbashkët për të dyja palët.

Përmes këtij memorandumi, institucionet angazhohen të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e tij, në një mënyrë sa më të shpejtë dhe efikase, por edhe për realizimin sa më cilësor të qëllimit të tij. Të dy institucionet gjithashtu do të bashkëpunojnë për:

- lirim të brezit 700 MHz (të ashtuquajtur DD2), nga AMA dhe marrjen në administrim të këtij brezi nga AKEP, duke shkuar drejt respektimit të afateve të vendosura nga BE dhe ITU;
- ngritjen e një TASK-FORCE me përfaqësues të përbashkët nga të dy institucionet me qëllim luftën kundër paligjshmërisë në transmetimet pa të drejta autori përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, dhe zhvillimin e veprimtarisë vetëm nga subjekte të licencuara/autorizuara nga autoritetet rregullatore;
- ngritjen e një grupi të përbashkët, i cili do të ndjekë në vijueshmëri problemet e interferencave të shkaktuara nga subjekte, veprimtaria e të cilëve përfshihet në fushën e veprimit të këtyre institucioneve si dhe interferencave që raportohen nga autoritetet rregullatore të vendeve fqinjë;
- krijimin e një inventari të unifikuar të frekuencave, bazuar në detyrimet ligjore të përcaktuara për të dy institucionet lidhur me "Miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit" si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të saj.

.....

13. Të zbatojë platformën e aksesueshme online të matjes së cilësisë së shërbimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë nga përdoruesit, si dhe për të gjithë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike që operojnë në të.

Realizuar

AKEP në zbatim të detyrimeve të parashikuara në “Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025” ka siguruar për qytetarët mundësinë e kryerjes së ankesave në lidhje me shërbimin e Internetit, p.sh., cilësinë e tij, duke zhvilluar një platformë (Measuring tool).

Platforma është e aksesueshme në faqen elektronike <https://nettest.akep.al/sq/test>, dhe çdo përdorues fundor mund ta përdorë për matjen e shpejtësisë aktuale të Internetit, duke bërë krahasimin me shpejtësinë e rënë dakord në kontratë. Pas kësaj, rezultatet mund të dorëzohen automatikisht në AKEP dhe mund të përdoren për të adresuar ankesat e përdoruesve fundorë.

Për realizimin e këtij projekti AKEP është mbështetur në rregulloren (EU) 2015/2120 të miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Evropës në 25 nëntor 2015, “Përcaktimi i masave në lidhje me aksesin e hapur në Internet dhe ndryshimin e Direktivës”, si dhe bazuar në parimin e “Open Internet” të miratuar nga BEREC (Body of European Regulators for Electronic Communications) në qershor 2020.

Kjo platformë lejon çdo përdorues të masë lidhjen fikse, mobile dhe Wi-Fi në Internet, në çdo moment dhe kudo, duke pasqyruar të dhënat e rezultateve të përdoruesit në një hartë. Për më tepër, do të mundësojë një test më të gjerë, duke përfshirë parametra të tjerë si forcën e sinjalit, ose parametrat e cilësisë. Kjo metodë është mbështetur në ekspertizën e Autoriteteve Rregullatore në të gjithë Evropën dhe kontributet e mijëra përdoruesve dhe matjeve të mbledhura. Nëpërmjet kësaj platforme AKEP e ka të mundur të analizojë dhe publikojë të dhënat mbi cilësinë e ofruar të shërbimit të operatorëve të Internetit, duke shfaqur të dhëna mbi cilësinë e shërbimit (QoS), rankimin e operatorëve dhe trajtimin e ankesave të përdoruesit, duke nxitur ofrimin e shërbimit me cilësi të lartë.

14. Të dakordësojë dhe të miratojë marrëveshje ndërkufitare për parandalimin e interferencave në përdorimin e frekuencave

Në proces realizimi

Në kuadër të procesit të Koordinimit të Spektrit të Frekuencave, në zonat kufitare dhe jo vetëm, AKEP ka kryer disa takime dhe është në procesin e finalizimit të marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe. Konkretisht, takimi i parë me përfaqësues të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut u zhvillua

në Tiranë më 8 tetor 2021, në kuadër të takimit rajonal të organizuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal për zhvillimin e brezit të gjerë dhe 5G në Ballkanin Perëndimor.

Në 20 tetor 2021 u zhvillua Takimi koordinues i Spektrit, ku nga Shqipëria merrnin pjesë përfaqësues nga MIE si dhe dy organet rregullatore AKEP dhe AMA, së bashku me përfaqësues të organeve rregullatore nga Mali i Zi (EKIP) dhe nga Maqedonia e Veriut (AEK).

Qëllimi i takimit ishte diskutimi i procesit të koordinimit të spektrit midis Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut lidhur me lirimimin e brezit 700 MHz.

AKEP është duke punuar edhe mbi një draft marrëveshje shumëpalëshe, e cila do të rinovojë marrëveshjen e nënshkruar në vitin 2019 ndërmjet MNE, MKD, Bosnje Hercegovinës dhe Serbisë.

AKEP gjithashtu ka dakordësuar me rregullatorët fqinjë mundësinë për t'iu bashkuar marrëveshjeve rajonale për brezat 4G dhe brezat 5G: 700 MHz, 3.6 GHz, 26 GHz.

AKEP ka kryer takime edhe me përfaqësues të agjencisë së komunikimeve elektronike (AEC) të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë takimit u ra dakord për rishikim e Memorandumit të bashkëpunimit dhe marrëveshjeve ndërkufitare nën dritën ndryshimeve të reja të menaxhimit të spektrit.

Ashtu si edhe në pikat të tjera të Rezolutës, në realizimin e rekomandimit janë përfshirë disa aktorë si AMA dhe Rregullatorët e vendeve fqinjë, të cilët duhet të bashkërendojnë veprimet e tyre për spektrin të cilin ata kanë në menaxhim, për realizimin me sukses të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

.....

15. Të miratojë brenda këtij viti modelin e kostos që duhet të zbatohet në tregjet e komunikimeve elektronike në rregullim nga AKEP-i.

Realizuar

Përgjatë vitit 2020 dhe 2021 AKEP ka mundësuar vijimin e procesit deri në miratimin dokumentit përfundimtar të "Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare".

AKEP, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka zhvilluar procedurat e prokurimit publik me objekt "Shërbim Konsulencë Ndërkombëtare", dhe në përfundim ka nënshkruar me operatorin ekonomik fitues, bashkimin e operatorëve "AIR Communications Shpk" dhe "Tera Consultants Sha".

Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 24, datë 26.11.2020, miratoi për Këshillim Publik dokumentin "Modeli i referencës së dokumentit për ndërtimin e modelit të kostove për shërbimet mobile", i cili ju nënshtrua procedurave të këshillimit publik gjatë periudhës 26.11.2020 – 26.12.2020.

Në përfundim të kësaj procedure të Këshillimit Publik, AKEP administroi komentet e palëve të interesuara dhe ia përcolli konsulentëve për t'i sintetizuar në dokumentin final që do të përdoret si model për llogaritjen e kostove të shërbimeve celulare.

Në vijim të këtij procesi, AKEP, me vendimin e Këshillit Drejtues nr.3, datë 1.4.2021, miratoi dokumentin "Modeli i referencës së dokumentit për ndërtimin e modelit të kostove për shërbimet mobile" - Dokument Përfundimtar".

Në përputhje me detyrimet kontraktore, duke u mbështetur në Modelin final të Kostove të miratuar me VKD nr.3, datë 1.4.2021, dhe të dhënat e marra nga operatorët celularë në Shqipëri, bashkimi i shoqërive konsulte pas analizimit dhe përpunimit të të dhënave, duke u bazuar edhe në praktikën e vendeve të BE, kanë hartuar dokumentin "Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare – Dokument për Këshillim Publik".

AKEP, me vendimin nr. 8, datë 27.5.2021, miratoi për Këshillim Publik dokumentin "Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare – Dokument për Këshillim Publik", periudha e këshillimit publik 27.05.2021 – 25.06.2021.

Në vijim, Këshilli Drejtues i AKEP me vendim nr.10, datë 22.7.2021, miratoi dokumentin përfundimtar mbi "Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare". Ky dokument përshkruan dhe shpjegon parimet kryesore të modelimit dhe parametrat kryesorë mbi të cilët janë llogaritur kostot e shërbimeve celulare, duke marrë parasysh maksimalisht rekomandimin e KE dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Ai adreson gjithashtu rezultatet e kostove të shërbimeve me shumicë të ofruara nga operatorët celularë në Shqipëri sipas metodologjisë LRIC+ dhe Pure LRIC.

.....

16. Të vijojë zbatimin e marrëveshjes Rajonale të Roaming-ut për të bërë të mundur "Roaming like at home» nga data 1 korrik 2021 në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Realizuar

Rregullimi i roaming-ut rajonal midis vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Serbi dhe Bosnje Hercegovinë) është pjesë e Planit Disavjeçar të Veprimit të Zonës Rajonale Ekonomike (Multi-annual Action Plan on Regional Economic Area - MAP REA), të nënshkruar nga liderët e BP në Samitin e Triestes, më 12 korrik 2017.

Në vijim të këtij procesi, më datë 4 prill 2019, në Beograd, Serbi, në kuadër të Samitit Digjital të Ballkanit

Perëndimor 2019, u nënshkrua Marrëveshja mbi Reduktimin e çmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimit celular në rajonin e Ballkanit Perëndimor” (në vijim RRA).

Ndër të tjera, në këtë marrëveshje u vendos, që duke filluar nga 1.7.2021 midis vendeve të BP6 do të fillojë të aplikohet modeli *‘Roam Like At Home’*, pra tarifat me pakicë roaming në vendet BP6 do të jenë sa tarifat përkatëse brenda vendit.

Në përputhje edhe me paragrafin e dytë të nenit 6 të RRA, AKEP me vendimin nr.1, datë 14.1.2021 miratoi nxjerrjen në Këshillim Publik të dokumentit draft-rregullore *“Mbi zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së Heqjes së Tarifave Roaming me Pakicë (RLAH) me Ballkanin Perëndimor”*.

Kështu AKEP, në përfundim të procedurës së këshillimit publik (VKD 1/2021), pas marrjes dhe analizimit të komenteve të palëve të interesuara, me anë të vendimit nr.9, datë 9.6.2021, ka miratuar dokumentin për zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë (FUP), si edhe Udhëzuesin për zbatimin e RLAH dhe FUP, si vijon:

- “Rregullore mbi zbatimin e Politikës së Përdorimit të Drejtë dhe Metodologjinë e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë së Heqjes së Tarifave Roaming me Pakicë (RLAH) me Ballkanin Perëndimor”;
- “Udhëzime për zbatimin e RLAH dhe FUP për roaming-un me Ballkanin Perëndimor”.

Procesi për reduktimin e tarifave të roaming në BP6, ka qenë një proces dinamik dhe ka zgjatur për një periudhë më shumë se dy vjeçare. Gjatë këtij procesi ka pasur takime dhe diskutime të vazhdueshme me strukturat e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) në cilësinë e koordinatorit të procesit të reduktimit të tarifave të roaming në BP6, BE, entet e tjera rregullatorë të rajonit, si edhe operatorët e vendeve të rajonit.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021 ka pasur takime dhe diskutime të vazhdueshme midis përfaqësuesve të BP6 dhe përfaqësuesve të strukturave të KE për fillimin e procesit të reduktimit të tarifave të shërbimeve roaming edhe midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian. Ky proces koordinohet nga RCC dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesve të KE, Ministrive të Linjës përgjegjëse për ICT dhe Autoriteteve Rregullatore të gjashtë vendeve të BP, si edhe pjesëmarrje të operatorëve nga vendet e BP6 dhe BE.

Lidhur me zbatimin e marrëveshjes Rajonale të Roaming-ut për të bërë të mundur *“Roaming like at home”* në Ballkanin Perëndimor, duke filluar nga korriku 2021, AKEP ka realizuar verifikimin e zbatimit të kësaj marrëveshje duke ngritur grupe pune ad hoc në mënyrë që të verifikohet zbatimi i marrëveshjes si dhe problematikat në hapat e para të implementimit të kësaj marrëveshje.

Verifikimi është realizuar përkatësisht në Republikën e Malit të Zi, në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut në përdorimin e të tri teknologjive GSM, UMTS, LTE.

Verifikimi i shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimit celular në Ballkanin Perëndimor të

operatorëve shqiptarë u orientua në tre drejtime:

- I. Ofrimi i shërbimit të thirrjeve dhe SMS hyrëse pa tarifa nga operatorët.
- II. Ofrimi i shërbimeve roaming bazuar në paketat aktive të përdoruesve.
- III. Ofrimi i shërbimeve roaming bazuar në tarifat e shërbimit.

Nga rezultatet e verifikimeve të realizuara që prej fillimit të muajit korrik 2021, për Republikën e Malit të Zi, Republikën së Kosovës dhe Republikën së Maqedoninë e Veriut në përdorimin e të tri teknologjive GSM, UMTS, LTE, konstatohet se:

- I. Ofrimi i shërbimit të thirrjeve dhe SMS hyrëse janë pa tarifa nga të tre operatorët.
- II. Ofrimi i shërbimeve roaming bazuar në paketat aktive të përdoruesve janë vetëm për paketat e deklaruara nga operatorët në faqet web respektivisht.
- III. Ofrimi i shërbimeve roaming bazuar në tarifat e shërbimit janë sipas deklarimeve të operatorëve në faqet web respektivisht.

Gjatë gjithë kësaj periudhe operatorët kanë raportuar të dhëna mbi numrin e pajtimtarëve dhe volumet e trafikut të shërbimeve celulare (voice, sms dhe data). Të dhënat e dërguara nga operatorët janë mbledhur dhe agreguar nga rregullatorët e vendeve të BP, dhe më pas janë dërguar pranë strukturave të BEREC, të cilët kanë përgatitur raporte periodike mbi ecurinë e treguesve të shërbimeve roaming në vendet e BP6, si edhe pjesës të vendeve të tjera EEA dhe 'Rest of the world'.

Nga të dhënat e raportuara nga operatorët e Shqipërisë gjatë këtyre periudhave rezulton se efektet e zbatimit të politikës së reduktimit të shërbimeve roaming në BP, dhe fillimi i regjimit RLAH ka pasur ecuri mjaft pozitive për përdoruesit fundorë.

Në vijim paraqiten disa të dhëna krahasuese për volumet e shërbimeve celulare dhe pajtimtarët që kanë përdorur roaming në BP.

Numri i pajtimtarëve që kanë përdorur roaming të paktën një herë gjatë periudhës tremujore në BP është rritur me disa herë, ku nga rreth 77 mijë pajtimtarë në tremujorin e dytë të vitit 2019, ky numër ka arritur në rreth 280 mijë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021 (që përket me periudhën e hyrjes në fuqi të politikës së tarifimit RLAH). Siç vërehet nga të dhënat, rritja ka qenë më e theksuar gjatë tremujorit të tretë 2021, i cili është rritur me rreth 400% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, dhe me rreth 300% krahasuar me tremujorin pararendës (T2-2021).

Efektet pozitive të reduktimit të tarifave të shërbimeve roaming janë pasqyruar edhe në rritjen e përdorimit të shërbimit të internetit gjatë qëndrimit në roaming në vendet e BP, konkretisht gjatë tremujorit të tretë 2021 volumi i internetit të përdorur në roaming e ka kaluar shifrën prej 103 mijë GB internet, që përbën një rritje me 11 herë krahasuar me periudhën T3-2019 dhe një rritje me rreth 14 herë krahasuar me periudhën T3 të vitit 2020.

3. Statistika të Zhvillimeve në Tregjet e Komunikimeve Elektronike dhe të Shërbimeve Postare

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020
Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:								
- Sipas kartave SIM	4,777,885	5,280,990	5,558,492	4,143,603	3,378,886	3,337,824	3,484,158	4.38%
- Përdorues aktivë	3,442,665	3,490,686	3,625,699	2,714,878	2,630,076	2,618,880	2,635,466	0.63%
Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:								
- Totali	2,049,072	2,739,550	3,345,045	2,657,015	2,462,057	2,469,850	2,789,023	12.92%
- Përdorues aktivë	1,297,281	1,686,354	2,030,978	1,809,996	1,789,158	1,998,579	2,056,444	2.90%
Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)	7,381,147,348	6,793,769,155	6,619,674,715	6,019,006,073	5,494,296,034	5,286,361,927	5,602,663,590	5.98%
Thirrje hyrëse kombëtare (minuta)	1,388,340,601	2,522,840,417	2,893,847,082	2,525,099,112	2,318,816,619	2,306,339,577	2,501,744,337	8.47%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare (minuta)	420,253,147	300,227,063	168,753,020	164,608,604	213,311,650	187,708,510	144,033,382	-23.27%
Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit	1,598,702,865	1,610,322,977	1,400,142,526	1,212,559,068	967,833,263	660,604,925	555,701,627	-15.88%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)	12,740,073	26,753,639	45,901,117	60,051,808	69,135,490	88,950,833	155,585,664	74.91%

Tabela 1 Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2015-2021

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020
Thirrje dalëse	182	166	155	158	171	168	178	5.78%
Thirrje të marra	171	169	156	161	177	174	182	4.60%
MOU	353	335	311	319	348	342	360	5.18%
SMS dalëse	39	39	33	31	30	21	18	-16.06%
Trafik Data (GB)	1.0	1.5	2.1	2.6	3.2	3.9	6.4	63.55%

Tabela 2: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve telefonike celulare 2015-2021

	Albtelecom	Vodafone Albania	One Telecommunications	Plus Communication	TOTALI	Norma e pentrimt për popullsi
2015	214,428	706,880	375,973	0	1,297,281	46.00%
2016	231,321	921,854	460,221	72,958	1,686,354	60.00%
2017	282,077	1,030,614	613,886	104,401	2,030,978	72.00%
2018	272,282	931,730	605,984	0	1,809,996	63.00%
2019	280,737	940,849	567,572	0	1,789,158	63.00%
2020	298,465	981,483	718,631	0	1,998,579	70.00%
2021	304,770	925,967	825,707		2,056,444	73.00%

Tabela 3 Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G ndër vite
Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.




Figura 1: Ecuria e thirrjeve (në minuta) dalëse dhe hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare
Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Struktura e thirrjeve dalëse celulare viti 2015-2021





Figura 2: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit
Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

On-Net vs Off-Net (ne %)






Figura 3 Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit broadband nga rrjete fikse 2015-2021
Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.




Figura 4 Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)
Burimi: Të dhëna të raportuara nga operatorët. Përpunimi AKEP

Në vitin 2021 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 54% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 30% e pajtimtarëve me paketa të integruara janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

SHËRBIMI POSTAR

Objekte postar	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshim 2021/2020
----------------	------	------	------	------	------	-----------------------

POSTA SHQIPTARE sh.a

1.	Shërbim Universal Postar						
1.1	Postë brenda vendit	18,599,662	18,298,143	20,348,070	17,487,538	20,219,877	15.6%
1.2	Postë ndërkombëtare	1,322,758	1,413,574	1,152,935	903,336	662,949	-26.6%
1.3	Totali 1.1+1.2	19,922,420	19,711,717	21,501,005	18,390,874	20,882,826	13.5%
2	Shërbim jouniversal postar						
2.1	Postë brenda vendit	2,603,017	2,819,601	656,177	873,512	301,052	-65.5%
2.2	Postë ndërkombëtare	9,702	6,616	5,624	2,344	2,762	17.8%
2.3	Totali 2.1+2.2	2,612,719	2,826,217	661,8018	75,856	303,814	-65.3%
3.	Shërbim ekspres						
3.1	Ekspres brenda vendit	724,794	699,731	644,049	486,531	669,874	37.7%
3.2	Ekspres ndërkombëtar	25,764	18,842	79,071	12,874	18,902	46.8%
3.3	Totali 3.1+3.2	750,558	718,573	723,120	499,405	688,776	37.9%

OFRUESIT E SHËRBIMEVE POSTARE

4.	Shërbim jouniversal Postar						
4.1	Postë brenda vendit	277,504	490,900	698,388	1,914,761	1,719,277	-10.2%
4.2	Postë ndërkombëtare	34,632	35,486	39,769	45,036	77,419	71.9%
4.3	Totali 4.1+4.2	312,136	526,386	738,157	1,959,797	1,796,696	-8.3%
5.	Shërbim ekspres						
5.1	Ekspres brenda vendit	1,050,783	1,408,298	2,010,034	2,796,387	3,192,279	14.2%
5.2	Ekspres ndërkombëtar	206,705	222,725	246,931	272,860	268,528	-1.6%
5.3	Totali 5.1+5.2	1,257,488	1,631,023	2,256,965	3,069,247	3,460,807	12.8%
6.	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	24,855,321	25,413,916	25,881,048	24,795,179	27,132,919	9.4%



Tabela 4: Të dhëna mbi kategoritë kryesore të objekteve postare (2017-2021)

Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP


4.

Statistika të Zhvillimeve në Sektorin e Autorizimeve dhe të Drejtave të Tjera të Përdorimit, Licencat, Certifikatat Ajrore, Detare, etj., si dhe Përdorimi i Domain.al


I. REGJISTRIMI I SIPËRMARRËSVE PËR OFRIMIN E RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE, SIPAS REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM




Sipërmarrës të rinj dhe të çregjistruar gjatë vitit 2021, për rrjete që mundësojnë shërbime audiovizive



Sipërmarrës që ofrojnë shërbime publike telefonike



Sipërmarrës që ofrojnë shërbime internet, transmetim të dhëna dhe linja me qera




Vlen të theksohet fakti që edhe gjatë vitit 2021, sipërmarrësit kanë njoftuar ndërtime rrjetesh bashkëkohore vetëm me fibra optike. Instalimi i rrjeteve me fibra optike, po ndodh si në zonat urbane ashtu edhe në zonat rurale.


II. REGJISTRIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE POSTARE, SIPAS REGJIMIT TË AUTORIZIMIT TË PËRGJITHSHËM

Gjatë vitit 2021 kanë ushtruar aktivitetet:

- 1 ofrues i shërbimit universal postar (Posta Shqiptare sh.a.).
- 36 ofrues të shërbimeve postare që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar.



Gjatë vitit 2021 janë regjistruar në AKEP 17 ofrues të rinj për ofrimin e shërbimeve postare, që nuk bëjnë pjesë në shërbimin universal postar dhe janë çregjistruar 8 ofrues të shërbimeve postare.



III. AUTORIZIMET INDIVIDUALE


1. *Autorizimet Individuale të sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të lëvizshme (celulare) për përdorimin e frekuencave:*

Gjatë vitit 2021 kanë ofruar shërbime telefonike të lëvizshme dhe shërbime broadband në rrjetet mobile 3 operatorë: Vodafone Albania sh.a., One Telecommunications sh.a., dhe Albtelecom sh.a., të pajisur nga AKEP me Autorizime Individuale për përdorim frekuencash në brezat GSM/UMTS/IMT/LTE (800/900/1800/2100/2600 MHz), të njohura si 2G/3G/4G.

2. *Autorizimet Individuale për përdorimin e frekuencave në lidhje fikse (pikë-pikë), sisteme PMR radiokomunikimi/radioalarmi, etj.*


Gjatë vitit 2021, për operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike janë lëshuar nga AKEP, Autorizime Individuale për përdorimin e frekuencave në 96 lidhje fikse të reja dhe 268 lidhje fikse të ndryshuara (në total 364 lidhje fikse). Janë revokuar Autorizimet Individuale për 170 lidhje fikse.

Autorizime Individuale - Lidhje fikse (2021)



Gjatë vitit 2021, për operatorët që përdorin frekuencave për sisteme PMR (radiokomunikimi dhe radioalarmi), janë konfirmuar 266 aplikime:

- 37 janë aplikime për sisteme të reja,
- 47 aplikime për ndryshime në autorizimin ekzistues,
- 182 aplikime për revokimin e frekuencave.




3. Autorizime Individuale numeracionesh:

Gjatë viti 2021, janë alokuar 47 Autorizime Individuale për numeracione fiks, numeracione mobile, kode të shkurtra, etj, ndërsa janë anuluar 61 numeracione nga të cilat 53 numeracione me kërkesë të vetë sipërmarrësve dhe 8 numeracione me nismën e AKEP për sipërmarrësit debitorë.

4. Autorizimet, licencat dhe certifikatat për shërbimet ajrore, detare, etj.

Në zbatim të ligjit 9918, i ndryshuar, dhe Rregulloreve të AKEP, bazuar në aplikimet e paraqitura, janë lëshuar Licenca, Certifikata dhe Autorizime për stacione radio bregdetare, si më poshtë:




IV. ADMINISTRIMI I DOMAIN-IT ".AL":


Numri i domaineve me ".al" dhe nëndomaineve të regjistruar për vitin 2021 është 5931.

Numri total i domaineve me ".al" dhe nëndomaineve, në fund të vitit 2021 është 25740.

Në terma statistikore vihet re se gjatë vitit 2021, ka sërish një rritje të numrit total të domaineve të regjistruar, krahasuar me vitin 2020, me 1711 domaine të regjistruar më tepër gjatë vitit 2021.




Numri i domain-eve me ".al" dhe nëndomain-eve me ".al", deri në fund të vitit 2021, paraqitet si më poshtë:



Numri i domaineve me ".al" dhe nëndomain-eve me ".al", në 5 vitet e fundit, paraqitet si më poshtë:

NUMRI TOTAL I DOMAINEVE .AL, NË 5 VITET E FUNDIT



Gjatë vitit 2021, janë regjistruar 25 domaine “gov.al” dhe janë rinovuar 97 të tillë. Deri në fund të vitit 2021, numri total i domaineve “gov.al”, rezulton të jetë 408.

V. Mbyllja e aksesit të disa faqeve të internetit/domaineve, me përmbajtje të paligjshme.

Gjatë vitit 2021 janë paraqitur disa kërkesa nga Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (AMLF), Autoriteti i Mediave Audiovizuale (AMA) dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave personale (KDIMDP), për mbylljen e aksesit nga ISP-të për 125 domaine me përmbajtje të paligjshme. Në zbatim të nenit 15, të ligjit 9918/2008 i ndryshuar, AKEP i ka përcjellë shkresat e këtyre institucioneve tek ISP-të.

Konkretisht, institucionet dhe numri i domaineve, për të cilat është kërkuar mbyllje aksesi, jepen më poshtë:

- AMLF: 76 domaine,
- AMA: 45 domaine,
- KDIMDP: 4 domaine.

Bazuar në listat e paraqitura nga këto institucione vërehet se në asnjë rast nuk ka pasur kërkesa për mbyllje aksesi domainesh me “.al”.

5. Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP për Vitin 2021

Vendimi	Data	Titulli i Vendimit
Nr.1	14.01.2021	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit: "Rregullore mbi zbatimin e politikës së përdorimit të drejtë dhe metodologjinë e vlerësimit të qëndrueshmërisë së heqjes së tarifave roaming me pakicë (RLAH) me Ballkanin Perëndimor".
Nr.2	11.03.2021	Për miratimin e dokumentit "Rregullore për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike".
Nr.3	01.04.2021	Për miratimin e dokumentit "Modeli i referencës së dokumentit për ndërtimin e modelit të kostove për shërbimet mobile".
Nr.4	28.04.2021	Për miratimin e Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2020.
Nr.5	28.04.2021	Mbi "Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike Albtelecom sh.a., kundër masës administrative të dënimit me gjobë".
Nr.6	28.04.2021	Mbi "Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike Vodafone Albania sh.a., kundër masës administrative të dënimit me gjobë".
Nr.7	28.04.2021	Mbi "Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike One Telecommunications sh.a., kundër masës administrative të dënimit me gjobë".
Nr.8	27.05.2021	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit "Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare".
Nr.9	09.06.2021	Për miratimin e dokumentit: "Rregullore mbi zbatimin e politikës së përdorimit të drejtë dhe metodologjinë e vlerësimit të qëndrueshmërisë së heqjes së tarifave roaming me pakicë (RLAH) me Ballkanin Perëndimor" dhe dokumentat plotësuese.
Nr.10	22.07.2021	Për miratimin e dokumentit "Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare".
Nr.11	22.07.2021	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit "Rregullore për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik".
Nr.12	31.08.2021	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit: Mbi disa shtesa e ndryshime të Aneksit 1, të Rregullores nr.12, datë 7.4.2010 "Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike", të ndryshuar.
Nr.13	31.08.2021	Për përdorimin e komisionit të përfituar si agjent tatimor nga AKEP, më formën e shpërbimit për vështirësi në punë, për vitin 2021.
Nr.14	21.09.2021	Për mënyrën e përdorimit nga AKEP të komisionit që do të përfitohet si agjent tatimor për vitin 2022.
Nr.15	21.09.2021	Për caktimin e fondit të shpenzimeve administrative dhe projektbuxhetin e vitit 2022 të AKEP.
Nr.16	04.10.2021	Për miratimin e Memorandumit të Bashkëpunimit midis Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

Nr.17	04.10.2021	Për shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të Rregullores nr.49, datë 11.3.2021 "Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike".
Nr.18	04.11.2021	Për miratimin e dokumentit: Mbi disa shtesa e ndryshime të Aneksit 1 të Rregullores nr.12, datë 7.4.2010 "Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike", të ndryshuar.
Nr.19	04.11.2021	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit "Studim/analizë për teknologjitë e reja të mobile broadband në Shqipëri".
Nr.20	07.12.2021	Mbi shtyrjen e afatit të hyrjes në fuqi të Rregullores nr.49, datë 11.3.2021 "Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike".
Nr.21	07.12.2021	Për miratimin e dokumentit "Rregullore për procedurat e njoftimit dhe këshillimit publik".
Nr.22	07.12.2021	Për përcaktimin e procedurave të dhënies së shpërblimit për rezultate të mira në punë gjatë vitit 2021 për punonjësit e AKEP.

Kontribuan në hartimin e këtij Raporti:

Eriola Mosko, Lorenc Bako, Bleron Dokle, Gazmir Mani, Altin Rrapaj, Vasil Mitezi, Jetmir Braha, Jonida Koçi, Bledar Kazia, Glorian Tusha.

Foto AKEP: Eduard Pagria

